

FGJH

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS



10/2024

Botohet për herë të parë në dhjetor 2019

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

E-mail: redaksia_fgjh@fgjh.edu.al; redaksia.fgjh@gmail.com

©Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ISSN 2664-7346

BORDI EDITORIAL

Drejtor i Përgjithshëm

Prof. Dr. Saverina PASHO (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Kryeredaktore

Dr. Viola ADHAMI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore shkencore

Prof. Asoc. Dr. Mirela PAPA (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore

Dr. Orges SELMANI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Dr. Viola BITI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

BORDI SHKENCOR

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Saverina PASHO

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Viktor RISTANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Lorena DEDJA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Klodeta Dibra

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Brikena KADZADEJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Jonida BUSHI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Irena LAMA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Adriatik DERJAJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Xhemile ABDIU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Anastasi PRODANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Sofia DELIJORGJI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Daniela HASA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Daniela TAMO

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Lindita SEJDIU RUGOVA

(Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Prof. Freiderikos VALETOPOULOS

(Université de Poitiers, Francë)

Prof. Enrico LUSO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Marco NOVARINO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Dr. Ahmet GÜNŞEN

(Fakulteti i Letërsisë, Universiteti Trakya, Turqi)

Prof. Dr. Giorgos KENTROTIS

(Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti Ionian, Greqi)

PËRMBAJTJA

5

Hartimi i teksteve në fushën e gjuhës së huaj për qëllime
specifike – problematika dhe sfida

Dr. Edlira Papavangjeli

Dr. Jola Bojaxhi

Prof. Dr. Silvana Shehu (Vishkurti)

17

Inovacioni në turizëm dhe sipërmarrja inovative
në gjuhë të huaj: realiteti dhe sfidat

Prof. Asoc. Dr. Albana Avrami

Doktorante Loris Hoxha

27

Zhvillimi i aftësive kyçe të nxëniet
gjatë gjithë jetës nëpërmjet mësimin të gjuhëve të huaja

Prof. Asoc. Dr. Elona Toro

38

Integrimi i inteligjencës artificiale në mësimin
hibrid të gjuhëve të huaja: sfida dhe përmirësime në vlerësim

Doktorante Lorena Kapxhiu

50

Struktura sintaksore dhe përzgjedhja
leksikore e gjuhës së gazetave

Dr. Elda Katorri

67

“Krim dhe ndëshkim” nën dritëhijet e skicave dhe
shënimeve në dorëshkrimet e Dostojevskit

Doktorante Elvira Xhamani

81

Karakteristika të terminologjisë mjekësore shqipe

Prof. Asoc. Dr. Mirela Papa

101

Botimi përfundimtar i Projektit:

Interpretimi/Përkthimi në realitetin virtual

107

AKTIVITETE SHKENCORE NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA

HARTIMI I TEKSTEVE NË FUSHËN E GJUHËS SË HUAJ PËR QËLLIME SPECIFIKE – PROBLEMATIKA DHE SFIDA

Dr. Edlira Papavangjeli

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

E-mail: edlira.papavangjeli@unitir.edu.al

Dr. Jola Bojaxhi

Qendra e Gjuhëve të Huaja,

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Fizike,

Universiteti Politeknik i Tiranës

E-mail: j.bojaxhi@fimif.edu.al

Prof. Dr. Silvana Shehu (Vishkurti)

Qendra e Gjuhëve të Huaja,

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Fizike,

Universiteti Politeknik i Tiranës

E-mail: s.vishkurti@fimif.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky punim synon të nxjerrë në pah rolin e pazëvendësueshëm dhe kompleks që luan mësuesi për një proces efikas të mësimdhënies/nxënies në gjuhë të huaj. Duhet theksuar se përmbajtja e teksteve të gjuhëve të huaja pasqyron kohën në të cilën ato janë hartuar. Për këtë arsye, ajo shpreh domosdoshmërinë e përditësimit të punimeve të tilla në mënyrë të vazhduar. Hipoteza që ne shtrojmë është se ndërthurja e teksteve të gatshme me ato të hartuara nga mësuesi krijon mundësinë e përditësimeve të përmbajtjes si dhe kombinimin e strategjive të mësimdhënies/të nxënies gjë që çon në një përvetësim më aktiv dhe dobiprurës të gjuhës.

Fokusi i këtij artikulli është që të sjellë, nëpërmjet një analizë krahasuese të metodave të para viteve '90, studimin e tyre si vlerë e shtuar për mësimdhënien në gjuhën profesionale, nëpërmjet ndërthurjes së aspekteve historike me ato bashkëkohore. Analiza është cilësore dhe fokusohet në analizën e përmbajtjes së teksteve shkollore që i drejtohen një publiku profesional.

Konkluzionet theksojnë ndërtimin e një kurrikule sipas qasjes aktive, duke kombinuar tekstet ekzistuese me ato të hartuara nga mësuesi. Ato nënvizojnë faktin se procesi mësimdhënies/nxënies ndërtohet në funksion të nevojave të studentëve, duke hartuar kështu një përmbajtje të kombinuar me strategji të ndryshme që edukojnë një përvetësim të pavarur të gjuhës së huaj.

Fjalët çelës: studim kurrikular, hartimi i teksteve shkollore, didaktika e gjuhës së huaj për qëllime profesionale, veprimtari gjuhësore.

ABSTRACT

This paper aims to emphasise the irreplaceable and complex role of the teacher in an efficient foreign language teaching and learning process. It is important to note that the content of foreign language textbooks reflects the time in which they were compiled. For this reason, such works must be updated continuously. Our hypothesis is that combining ready-made textbooks with those compiled by the teacher enables content to be updated and teaching/learning strategies to be combined, leading to more active and beneficial language acquisition.

This article focuses on the added value of studying pre-90s methods for teaching professional language, through a comparative analysis of historical and contemporary aspects. The qualitative analysis focuses on the content of textbooks aimed at a professional audience.

The study employs a qualitative analysis, concentrating on the content of textbooks. The conclusions emphasize the importance of an active approach to curriculum development - combining existing texts with teacher-created content – to foster a teaching/learning process tailored to students' needs. This approach promotes the use of varied strategies that support independent and effective foreign language acquisition.

Keywords: curriculum studies; textbook design; foreign language teaching for professional purposes; language activities.

Hyrje

Zhvillimet që ka përjetuar shoqëria shqiptare gjatë dy dekadave të fundit si edhe hapja e vendit ndaj botës, kanë pasur një ndikim të fortë në përmbajtjen dhe strukturën e përgjithshme të zhvillimit tëarsimit të lartë në Shqipëri. Mësimi i gjuhëve të huaja nuk mund t'i shpëtonte kësaj reforme globale. Ndikimi i zbatimit të procesit të Bolonjës, që prej shtatorit të vitit 2001, në rishikimin e kurrikulave me synimin për të siguruar një cilësi sa më të lartë si dhe një lëvizshmëri më të madhe të studentëve, u reflektua edhe në mënyrën e mësimdhënies/nxënies së gjuhëve të huaja.

Dobia e mësimi të gjuhëve të huaja në këtë periudhë, sidomos e gjuhës angleze, dëshmoi se mësimdhënia/nxënia e dijeve bashkëkohore dhe zotërimi konkret i tyre janë të një rëndësi thelbësore. Mësimi i dijeve në fushën profesionale do të paraprihej me zotërimin e gjuhës së huaj, e cila do t'i ndihmonte studentët që të arrinin të studionin dhe të merrnin informacionin e duhur gjatë cikleve të arsimimit të tyre. Ata do të mundeshin madje edhe të punonin e komunikonin në këtë gjuhë në fushën e tyre profesionale, si brenda dhe jashtë vendit.

Një rol i rëndësishëm, në këtë rast, i takonte mësuesit të gjuhës së huaj,

i cili duhet të realizonte këtë ndryshim madhor, i planifikuar si pjesë e zbatimit të kurrikulave të reja, përkatësisht përshtatjen e mësimdhënies/nxënies me nevojat aktuale dhe të mëtejshme të shoqërisë.

Për ta realizuar këtë qëllim, mësuesve u duhej që, në të njëjtën kohë, të trajnoheshin, të vinin në zbatim metoda të reja mësimore në auditore, por mbi të gjitha, t'i përshtasin ato ndaj një publiku gjithnjë e më heterogjen. Sfidë e misionit që kishin përpara i detyroi ata të përditësonin vazhdimisht njohuritë e tyre, të punonin për pasurimin dhe përdorimin e mjeteve që zotëronin në fushën pedagogjike, duke ia përshtatur ato specifikave që paraqiste grupklasa së cilës u duhej t'i jepnin mësim. Të gjitha këto ndryshime të menjëhershme nënvizonin rolin qendror që mësuesve u duhej të kryenin në realizimin me sukses të kësaj reforme.

Duke qenë se realitetet me të cilat ata përballeshin nuk ishin të njëjta, kontekstualizimi i mësimdhënies duket se ishte dhe synimi rreth të cilit u ndërtuan e vazhdojnë të ndërtohen edhe sot praktikatat e mësimdhënies/nxënies në klasë. Kështu, në praktikën e përditshme, mësuesit i duhet vazhdimisht të zgjedhë, t'i përshtasë dhe t'i krijojë e zhvillojë mjetet që i lejojnë të rrisë efektivitetin e nxënies së njohurive nga ana e studentëve. Kjo është arsyeja se përse analiza e këtij artikulli në kontekstin shqiptar përqendrohet veçanërisht në zgjidhjen e problematikave të krijuara gjatë këtyre ndryshimeve të kryera si dhe realizimin e kësaj përshtatjeje në mësimin e gjuhës së huaj me drejtim profesional.

Kontekstualizimi, si dukuri, nuk është një risi vetëm e ditëve të sotme, përkundrazi, ai përbën një qëndrueshmëri në tërë historinë e mësimdhënies/nxënies së gjuhëve të huaja në Shqipëri. Por, zbatimi i tij përballet me një valë reformash dhe i përket fushave të ndryshme të zbatimit, të cilat herë çojnë në krijimin dhe përdorimin e teksteve gjuhësore të hartuara nga mësuesit shqiptarë, e herë në marrjen e metodave gjuhësore të botuara jashtë vendit për një publik të huaj.

Për më tepër, edhe për sa i përket hartimit të teksteve mësimore, duhet theksuar se janë të paktë mësuesit që i përkushtohen një pune të tillë hulumtuese e krijuese, e cila i mobilizon njohuritë dhe aftësitë e tyre për të krijuar materiale konkrete për mësimin e gjuhës së huaj për cikle e nivele të ndryshme gjuhësore. Në fakt, duke mos pasur asnjë formim për të hartuar dokumente të tilla për klasën e tyre, shumica e mësuesve e gjejnë veten të pafuqishëm përballë një situatë të tillë. Për pasojë, ata

nuk arrijnë t'u përgjigjen në mënyrë konkrete këtyre sfidave, për sa i takon përmbajtjes së lëndës, problemeve të të nxëniet dhe pritshmërive që paraqesin studentët e tyre.

Hipoteza e sjellë në këtë artikull thekson se aftësia për të hartuar materiale mësimore për studentët është gjithmonë dobiprurëse dhe se duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e aftësisë mësimdhënëse të të gjithë mësuesve. Ajo duhet të jetë pjesë e kurrikulës së trajnimit të mësuesve të ardhshëm të gjuhës së huaj. Duke kaluar përmes një përvojë të tillë, mësuesi do të jetë në gjendje jo vetëm të hartojë mësimdhënien e tij sipas publikut të cilit i jep mësim, por edhe t'i kuptojë, përzgjedhë e zhvillojë më mirë aktivitetet e konceptuara nga ai vetë, duke u bazuar në materialet gjuhësore me të cilat ai punon në klasë. Si shembull ne kemi marrë përvojat e mësimdhënies/nxënies së gjuhës angleze e franceze të cilat, në një shkallë më të gjerë kanë një karakter referues dhe vlejnë si model për të gjitha gjuhët e huaja në përgjithësi dhe për ato me drejtim profesional në veçanti.

Pasi të japim një këndvështrim mbi historinë e mësimdhënies së gjuhës së huaj për qëllime profesionale në Shqipëri, do të paraqesim sfidat që janë hasur në hartimin e një cikli materialesh për studentë që ndjekin formimin e tyre në degët profesionale. Rezultatet e vjela nxjerrin në pah mangësitë që ekzistojnë në fushën e trajnimit të mësuesve të gjuhëve të huaja për sa i përket hartimit të dokumenteve të mirëfillta autentike si dhe përshtatjes së tyre të vazhdueshme në lidhje me klasat ku japim mësim.

Përvoja e punës në zhvillimin e një kursi gjuhe në fushën profesionale nxjerr në pah domosdoshmërinë për t'u formuar për të konceptuar materiale të tilla mësimore si dhe për të punuar në ekip për të sjellë produkte sa cilësore aq edhe të përditësuara në këtë fushë.

Konteksti i kërkimit

Mësimi i gjuhës së huaj në nivel universitar, që nga krijimi i katedrës së gjuhës angleze (1960) deri në hapjen e vendit ndaj botës (1990), i është nënshtruar një filtri ideologjik.¹ Të gjitha vendimet për programet

¹ Kromidha, E., Varfi, N., (2011), *L'enseignement des langues étrangères dans les*

e studimit dhe tekstet mësimore merreshin dhe ishin në përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit, ndërsa mësuesit ishin thjesht zbatues të këtyre vendimeve. Në të gjitha tekstet mësimore të kësaj epoke ndjehej fryma ideologjike e kohës, por sidomos në metodën “English for Law and Philosophy” (1983)² ky ndikim ishte edhe më i ndjeshëm.

Pavarësisht këtyre kushteve, edhe pse i njëjti tekst shkollor duhej të përdorej brenda të njëjtit institucion në të njëjtën mënyrë, mësuesit novatorë u përpoqën të përfshinin në mësimdhënie metoda të reja didaktike dhe mjete interesante që u ngjallnin dashurinë për gjuhën studentëve. Fakti i përpilimit të këtyre materialeve për studentët që i përkasin arsimit profesional përbën një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të përdorimit të gjuhës së huaj dhe përshtatjes së mësimdhënies së saj për një publik të caktuar, me nevoja e interesa krejt të ndryshme nga ai i gjuhës së përgjithshme. Mësuesit shqiptarë, të përfshirë në këtë punë kërkimore, dhanë kontributin e tyre mbi një sërë dokumentesh thellësisht profesionale për të përmbushur nevojat specifike të një auditori studentësh të fushave shkencore. Fjala ishte për një fushë aspak të lëvruar më parë dhe përpjekjet e tyre në këtë drejtim kanë qenë novatore.

Në ditët e sotme, puna për hartimin e teksteve për qëllime specifike, në dallim nga materialet mësimore të periudhës së para viteve 1990, është përqendruar në hartimin e metodave profesionale të një natyre shumëdimensionale, të cilat synojnë jo vetëm përvetësimin aktiv të gjuhës, por edhe aftësi pragmatike të tilla si shkrimi i një letre motivuese, shkrimi dhe prezantimi i një projekti kërkimor, hartimi i raportit teknik, etj. Të gjitha këto elemente krijojnë një tablo më të përgjithshme e të plotë të komunikimit në fushën profesionale.

Hartimi i një kurrikule të tillë që u përgjigjet nevojave të studentëve dhe fitimit të aftësive gjuhësore e komunikuese në fushën profesionale bëri të mundur që edhe përmbajtja e kësaj lënde të shihej në zhvillim të vazhdueshëm. Por, si paraqitet ajo në ditët e sotme, cilat janë sfidat me të cilat ajo duhet të përballet?

facultés de l'Université de Tirana: Un défi pour une meilleure formation professionnelle et culturelle des étudiants, in: Synergies Monde, Actes du IIème Forum Mondial HERACLES. Referred: <http://gerflint.fr/Base/Monde9/kromidha.pdf>

² Drenova, K., dhe Blushi, M., (1983), *English for Law and Philosophy students*.

Kuadri teorik i studimit

Qasja e përzgjedhur është ajo e një analize krahasuese në rrafshin diakronik me qëllim që të shohim se si mund të kombinohen tradita me teoritë e reja të mësimdhënies/nxënies në fushën e gjuhës së huaj për qëllime profesionale. Aftësia për ta kontekstualizuar mësimdhënien nëpërmjet botimit të një materiali didaktik për klasën nga ana e mësuesit është shndërruar në një domosdoshmëri në ditët e sotme. Kjo edhe për faktin se metodat e përgjithshme apo dhe ato profesionale të sjella nga jashtë, nuk mund të jenë plotësisht të përshtatshme për një auditor vendas që shfaq synime e objektiva të tjera. Për më tepër, nevojat e studentëve, objektivat dhe mënyrat e mësimit të gjuhëve të huaja janë në zhvillim të vazhdueshëm.

Përballë këtyre ndryshimeve, mësuesi duhet të ketë një qëndrim “krijues” dhe jo atë të nënshtruar ndaj metodave, nënvizon J. Montredon.³ Është shumë më e vështirë t’ia përshtatësh përmbajtjen orës së mësimit sesa ta transmetosh atë gjatë saj. Reflektimi mbi praktikën e përditshme sipas Ph. Blanchet⁴ do t’i ndihmojë mësuesit të gjejnë mënyra për të ndërhyrë konkretisht si dhe për të matur efikasitetin e ndryshimit që ata do të kryejnë. Këtë mënyrë konceptimi Ch. Puren⁵ e konsideron si “kalimin nga didaktika e gatshme në atë të gatshme për montim”.

Kufizimet e studimit

Në pamundësi për të arritur që të analizojmë të gjitha botimet e kryera në nivel kombëtar apo rajonal që kanë të bëjnë me sektorë të specializuar, ne zgjodhëm ta përqendronim studimin tonë në përshkrimin e përgjithshëm të botimeve të kryera në gjuhën angleze e frënge të përgatitur përkatësisht për studentët shqiptarë dhe bullgarë të inxhinierisë dhe degëve profesionale.

³ Montredon, J. (1995), *"Principes et exemples d'une pédagogie en contexte"*. In Coste, D. (dir.). *La didactique au quotidien. Collection "Le Français dans le monde - Recherches et applications"*. f. 94-99

⁴ Blanchet. Ph. (2000), *Linguistique de terrain, méthode et théorie (une approche ethno- sociolinguistique)*, Rennes, Presses universitaires de Rennes

⁵ Puren, CH. 1998a. *«Perspective sujet et perspective objet en didactique des langues»* në *ÉLA, revue de didactologie des langues-cultures* n° 109, janar - mars, f. 9-37. Botimet: Didier-Érudition

Kjo është arsyeja pse analiza e shkallës së kontekstualizimit të materialeve mësimore të studiuara në vend si dhe përgjithësimi i këtij studimi në rrafshin rajonal është i kufizuar për shkak të një qasjeje të kufizuar e të përgjithshme të materialeve të studiuara. Nga ana tjetër, këto botime paraqesin interes pasi hedhin dritë në ngjashmërinë e hartimit të teksteve të tilla në Evropën Qendrore e Lindore si dhe nxjerrin në pah veçoritë që shfaqin terrenet e ndryshme të studimit.

Metodologjia dhe struktura e punimit

Objekt i këtij studimi janë tekstet shkollore të gjuhës profesionale të nivelit universitar të hartuara para viteve '90. Për ta realizuar këtë studim ne kemi marrë si shembull kryesisht botime të teksteve të gjuhës angleze dhe frënge të konceptuara për një publik profesional. Duke bërë një krahasim midis këtyre teksteve në gjuhën angleze e frënge për studentët e inxhinierisë të botuara jo shumë larg prej njëri-tjetrit (1980 - 1986), del në pah fryma dhe metodologjia e kohës si dhe të përbashkëtat dhe dallimet që vihen re mes tyre.

Krahasimi në nivel rajonal, përqendrohet kryesisht në ndërtimin e teksteve që i drejtohen një publiku të specializuar të shkencave inxhinierike në gjuhën frënge. Ato shërbejnë si modele të metodave që u drejtohen studentëve që ndjekin kurset e gjuhës angleze e frënge sipas objektivave specifike dhe që, në përgjithësi, i kanë marrë bazat e kësaj gjuhe në nivelin parauniversitar. Në hyrje të njërit prej këtyre punimeve, autorët shqiptarë theksojnë se, për studentët, “qëllimi i këtij manuali është të mësojnë frëngjishten nga leximet teknike dhe një studim i aplikuar i gramatikës frënge”.⁶ Ky libër synon që t’i ndihmojë ata se si “të përmirësojnë njohuritë e tyre për gjuhën frënge në përgjithësi dhe gjuhën e specializuar në veçanti”. Nuk ka të dhëna për natyrën e dokumenteve, emrat e autorëve, titujt, datat e botimit, me përjashtim të dy teksteve të para në manualin shqip, ndërkohë që autorët bullgarë kanë zgjedhur të citojnë përgjithësisht duke dhënë burimet bibliografike në fund të librit.

Autorët shqiptarë u qasen teksteve nëpërmjet një kuptimi global të përmbajtjes së tyre: pyetje rreth tekstit, gramatikës, ushtrime për dukuritë gjuhësore. Autorët bullgarë, nga ana tjetër, fillojnë me një leksik

⁶ Çaçi, I. dhe Sinani, P. (1985) *Gjuha frënge për studentët e inxhinierisë*, f. 1

të specializuar në lidhje me temën e studiuar, ushtrime përkthimi dhe përkufizime të dukurive të studiara, dhe më pas, kalojnë në ushtrime që kanë të bëjnë me dukuritë gramatikore dhe leksikore dhe përfundojnë me një temë që do të zhvillohet. Për sa i përket gjuhës së përdorur, autorët shqiptarë japin gjithçka në frëngjisht e anglisht, ndërsa autorët bullgarë përdorin gjuhën e tyre amtare (bullgarishten), si në ushtrimet e përkthimit ashtu edhe në kërkesat e ushtrimeve.

Në këto botime shohim se mësimi i gjuhës jepet nëpërmjet teksteve të specializuara në disa fusha shkencore (elektronike, elektroteknike, mekanike, ndërtim, matematike, juridike, etj.).

Tekstet që mbizotërojnë janë ato të tipit informues -shpjegues. Mësuesit i takon të zgjedhë tekstin që i përshtatet profilin e studentëve dhe fushës së tyre të studimit. Detyrat që do të kryejë studenti kanë të bëjnë me praktika të gjuhës në rrafshin strukturor dhe komunikues të cilat nuk shkojnë përtej nivelit të fjalisë.

Ushtrimet leksikore të përdorura kanë të bëjnë kryesisht me termin dhe jepen me veprimtari të tilla ligjërimore si: shpjegoni kuptimin e fjalës, prejardhjen, përktheni fjalët, gjeni shprehjet që jepen në formë togfjalëshi, ndërtoni fjalitë. Në këto tekste mbizotëron metoda e gramatikë – përkthimit. Ndërsa, për sa i përket veprimtarive krijuese dhe riformuluese apo edhe e folura, ato janë të kufizuara në numër dhe shfaqen më shpesh në përdorimin e udhëzimeve të tilla si: “Jepeni në gjuhën frënge sipas përkufizimit”, “Jepeni këtë thënie me terma të tjerë”, “Zhvilloni temën”, etj. Veprimtaritë që kanë të bëjnë me terminologjinë e fushës përditësohen nëpërmjet ushtrimeve që ndalen në përcaktimin e veprimtarive gjuhësore si monosemi/polisemi, sinonimi/antonimi si dhe studimi i para/prapashtesimit.

Për sa i përket aftësive, vërejmë se ato që mbizotërojnë janë ushtrimet që bazohen në zhvillimin e aftësivepasive, pra marrëse, ndërsa aftësitë shprehëse janë më pak të zhvilluara. Si të tilla mund të përmendim dialogjet në metodën “English for geology and Mining”⁷ apo ritregimin në metodën “English for beginners”.⁸ Po kështu, duke qenë se objektivi

⁷ Kaba, S., (1985), *English for geology and mining students*

⁸ Çela, L., Osmani, Sh., Prodani, A., (1987), *English for beginners: for the students of the Higher Institute of Agriculture*

thelbësor është puna me dokumente të shkruara, veprimtaritë që lidhen më të shkruarin e teksteve profesionale dhe të shprehurin me gojë mbeten të kufizuara dhe nuk gjejnë pasqyrim të plotë në to.

Nga sa shihet, kjo epokë karakterizohet nga përpjekjet e pedagogëve shqiptarë për t'ia përshtatur mësimin e gjuhës së huaj fushës së formimit dhe auditorit të cilit i drejtoheshin. Ato mbajnë vulën e kohës kur janë krijuar dhe të rrymave teorike që mbizotëronin në atë kohë në fushën e mësimdhënies së gjuhës së huaj.

Gjuhët e huaja përmes optikës së një projekti ndërrajonal

Në ditët e sotme, metodat e gjuhëve të huaja të ndërtuara për një publik ndërkombëtar edhe në fushën profesionale, u lejojnë mësuesve të kenë materiale mbështetëse bazë mjaft të mira ku fjalori dhe gramatika jepen në kontekste në të cilat përfshihen e mbi të cilat ndërtohen edhe veprimtaritë përforcuese, zbatuese e krijuese. Por, në të gjitha këndvështrimet, këto tekste kanë nevojë për plotësime e përditësime, të cilat mund të kryhen vetëm nga mësuesit që japin gjuhën e huaj në degët përkatëse. Kjo pasi ato u drejtohen një publiku ndërkombëtar dhe njohuritë në këto fusha zhvillohen aq shpejt saqë dhe përditësimi i materialeve mësimore duhet të jetë i vazhdueshëm e i përhershëm.

Analiza e problemit që lind sot para mësuesve të gjuhëve të huaja të degëve profesionale lidhet me metodologjinë që ata duhet të kenë parasysh në hartimin e këtyre dokumenteve të reja në këtë fushë. Pa harruar faktin që publiku dhe shqetësimet mbeten të njëjta, duhet theksuar se shumë elemente kanë pësuar ndryshime të rëndësishme. Kështu, nga përparësia që i jepej shkrimit dhe teksteve të specializuara, është kaluar në zotërimin e një gjuhe duke e përdorur atësi mjet komunikimi në situata konkrete të jetës së përditshme dhe asaj profesionale, me gojë apo me shkrim.

Natyra e dokumenteve (të shkruara, dëgjimore, audiovizive), llojet e mediave (në formatin letër apo elektronike) si dhe tekstet e përdorura (të specializuara ose për një publik të gjerë) i referohen përdorimit të një gjuhe që është sa më afër situatave konkrete në të cilat studenti do të ndërveprojë në jetën personale dhe profesionale. Përfshirja e dy universiteteve shqiptare (Universitetit të Tiranës dhe atij Politeknik të Tiranës) në një projekt ndërrajonal të drejtuar nga Universiteti Shtetëror

i Moldavisë në kuadër të një projekti në fushën e gjuhës frënge për qëllime profesionale⁹ tregoi se përzgjedhja e dokumenteve autentike dhe didaktizimi i tyre kërkonin një përgatitje paraprake teorike sa më të lartë të mësuesve në këtë drejtim.

Së pari, hartimi i teksteve shkollore duhet t'u referohet kulturave gjuhësore që ekzistojnë në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Përveç kësaj, ndërveprimi me gjuhën kombëtare i jep një ngjyrë lokale këtij komunikimi në gjuhë të huaj dhe mund të konsiderohet si një burim pasurie dhe dialogu mes kulturave. Përkthimi mbetet si një element mjaft i rëndësishëm për aq kohë sa nuk abuzohet me të.

Së dyti, është e rëndësishme të theksohet se kjo përshtatje në kontekstin e mësimdhënies/mësimnxënies së gjuhës së huaj është shprehëse e pikëpamjeve dhe e ideologjive mbizotëruese të asaj kohe. Kështu që, nëse studimi i gjuhës në vitet 1980 u përqendrua në anën gjuhësore, sot ai është i lidhur ngushtë me situatat e komunikimit, mjedisin dhe rrethanat në të cilat përdoret gjuha. Nëse metodat dalloheshin nga pikëpamja e origjinës dhe ndaheshin në metoda vendase dhe/ose të huaja, aktualisht mund të flitet për metoda të kryera në bashkëpunim ndërmjet ekipeve të përbashkëta kombëtare e ndërkombëtare, të cilat konsiderohen si pjesë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve universitare e ndëruniversitare.

Së fundi, hartimi i teksteve profesionale në gjuhën e huaj mbërritëse, i parë nga perspektiva vepruese¹⁰, trajtimi e diskutimi i elementeve kulturore që shfaqen në temat e trajtuara në auditorë ose në distancë si dhe reflektimi metodologjik mbi këto tema, synojnë që mësuesit të dalin më të pasuruar dhe më të përgatitur nga këto përvoja bashkëpunuese në nivel ndërrajonal.

Gjithashtu, rritja e rolit të teknologjisë dhe përpunimi automatik i gjuhëve ka ndikuar dukshëm në cilësinë e mësimdhënies/nxënies si dhe në një rinkonfigurim ndryshe të rolit të mësuesit dhe ndërtimit të orës

⁹ Projekti "Bashkërendimi i formimeve në Frengjishten sipas objektivave specifike (FOS) në rrjetet ndëruniversitare në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë (2011-2014) u krye me mbështetjen financiare të Agjencisë Universitare të Frankofonisë (AUF) dhe u drejtua nga Universiteti Shtetëror i Moldavisë. Anëtarë të projektit: Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës (Shqipëri) si dhe Universitetet Paul Valery, Montpellier III dhe Blaise Pascal, Clermont-Ferrand II (Francë).

¹⁰ Këshilli i Evropës (2001) Kuadri evropian i përbashkët i referimit për gjuhët: të nxësh, mësosh, të vlerësosh. Botimet DIDIÉ. Burimi: http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/Source/Framework_FR.pdf

së mësimit nga ana didaktike. Për të gjitha këto arsye, metodat apo dhe materialet mësimore që do të mund të hartohen në fushën e mësimdhënies së gjuhës sipas objektivave specifike do të jenë të dobishme e të mirëpritura nga studentët. Ato do të synojnë fitimin e aftësive komunikuese të tyre në fushën e gjuhës së huaj dhe do të shtojnë interesimin për të punuar e ndërvepruar me të dhe nëpërmjet saj në marrëdhëniet e tyre me partnerët që janë jashtë, kur ndodhen në Shqipëri apo dhe kur punojnë me ta jashtë saj.

Përfundime

Vlera e teksteve të mëparshme profesionale në gjuhët angleze e frënge shërbeu si një model se si të veprohej për harmonizimin e përmbajtjeve mësimore me mjedisin socio-kulturor dhe gjuhësor si dhe me nevojat e studentit. Në këtë mënyrë, këto metoda vlejnë për të parë se si, në ditët e sotme, tekstet duhet të jenë të kuptueshme dhe të shfaqin interes për studentin, me qëllim që ky i fundit të jetë më i motivuar për ta mësuar gjuhën e huaj, sidomos atë me drejtim profesional.

Zhvillimi i orës së mësimit në gjuhët e huaja me drejtim profesional në ditët e sotme, përdorimi i mediave të shkruara dhe i atyre elektronike mbartin detyrime të karakteristikave të kohës. Nga ana tjetër, hartimi i tyre në funksion të pritshmërive të studentëve nxit të mësuarin aktiv dhe i përgatit ata për tregun e punës. Kjo është edhe arsyeja se përse hartimi dhe didaktizimi i dokumenteve profesionale për degët shkencore e profesionale si dhe nivelet e ndryshme gjuhësore duhet të përfshihet si pjesë e rrugëtimit dhe e vlerësimit të arritjeve profesionale të të gjithë mësuesve të gjuhës së huaj.

Këta të fundit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur dhe në ekip, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të ndarë përvojat më të mira në fushën e mësimdhënies/nxënies së gjuhës për qëllime profesionale. Kjo do të çojë edhe në pasurimin e materialeve të lëndës si dhe në përditësimin e përhershëm të tyre në përputhje me zhvillimet e reja të shoqërive në të cilat jetojmë e punojmë.

BIBLIOGRAFIA

BLANCHET. Ph. (2000), *Linguistique de terrain, méthode et théorie (une approche ethno - sociolinguistique)*, Rennes, Presses universitaires de Rennes.

Conseil de l'Europe (2001) Cadre européen commun de référence pour les langues: apprendre, enseigner, évaluer. Editions Didier.

ÇAÇI, I. dhe SINANI, P. (1985) *Gjuha frënge për studentët e inxhinierisë*, f. 1

ÇELA, L., OSMANI, Sh., PRODANI, A., (1987), *English for beginners: for the students of the Higher Institute of Agriculture*.

DRENOVA, K., dhe BLUSHI, M., (1983), *English for Law and Philosophy students*.

DUDLEY-EVANS, T., & St JOHN, M. (1998). *Developments in ESP: A Multi-Disciplinary Approach*. Cambridge: Cambridge University Press, f. 4-5

Këshilli i Evropës (2001) Kuadri evropian i përbashkët i referimit për gjuhët: të nxësh, mësoh, të vlerësoh. Botimet DIDIER. Burimi:http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/Source/Framework_FR.pdf

HUTCHINSON, T., & WATERS, A. (1987). *English for Specific Purposes: A learning-centred approach*. Cambridge: Cambridge University Press. f. 7

KABA, S., (1985), *English for geology and mining students*

KROMIDHA, E., VARFI, N., (2011), L'enseignement des langues étrangères dans les facultés de l'Université de Tirana: Un défi pour une meilleure formation professionnelle et culturelle des étudiants, in: Synergies Monde, Actes du IIème Forum Mondial HERACLES. Burimi: <http://gerflint.fr/Base/Monde9/kromidha.pdf>

MONTREDON, J. (1995). "Principes et exemples d'une pédagogie en contexte". In Coste, D. (dir.). *La didactique au quotidien*. Collection "Le Français dans le monde - Recherches et applications". f. 94-99.

PACI, M., (2016), Kurrikula dhe strategjitë e mësimdhënies/nxënies së gjuhës angleze në nivelin Bachelor në UPT, f. 9-15.

Burimi:<https://unitir.edu.al/kurrikula-dhe-strategjite-e-mesimdheniesnxenies-se-gjuhes-angleze-ne-nivelin-bachelor-lmd-ne-universitetin-politeknik-te-tiranes/>

PUREN, CH. 1998a. «Perspective sujet et perspective objet en didactique des langues» në ÉLA, revue de didactologie des langues-cultures n° 109, janar - mars, f. 9-37. Botimet : Didier-Érudition

STREVEVS, P. (1977). *Special-purpose language learning: A perspective*. *Language Teaching & Linguistics: Abstracts* 10, (3), f. 145-163.

VISHKURTI, S., (2009) «Quelques réflexions sur la didactique des langues en Albanie», Synergies Roumanie, Sciences du langage et didactique des langues. Frontières et rencontres, f. 103-109

INOVACIONI NË TURIZËM DHE SIPËRMARRJA INOVATIVE NË GJUHË TË HUAJ: REALITETI DHE SFIDAT

Prof. Asoc. Dr. Albana Avrami

Qendra e Gjuhëve të Huaja
Universiteti Politeknik i Tiranës
E-mail: a. avrami@fimif. edu. al

Doktorante Loris Hoxha

Fakulteti i Ekonomisë
Universiteti Mesdhetar i Tiranës
E-mail: loris. hoxha@umsh. edu. al

PËRMBLEDHJE

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin e zhvillimit të gjuhëve të huaja në procesin mësimor në arsimin e lartë dhe se si ky zhvillim mund të kontribuojë në forcimin e sektorit të turizmit në Shqipëri. Duke qenë një sektor që kërkon komunikim dhe bashkëpunim ndërkombëtar, forcimi i aftësive gjuhësore të studentëve si dhe pajisja e tyre me eksperiencë më të pasura ndaj turistëve është një domosdoshmëri. Ndaj dhe ky punim synon të argumentojë se trajnimi i mësuesve si dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre do t'u mundësonte studentëve një qasje më efikase ndaj dijes. Këndvështrimi socio-konstruktivist i këtij studimi synon të analizojë mësimdhënien si dhe mënyrën se si mund të ndërtohet një qasje e tillë me në qendër studentin. Duke u mbështetur në intervistat me pedagogët dhe vëzhgimet e klasës ai e vë theksin në faktin se trajnimi profesional i mësuesit me metoda bashkëkohore, ndërthurja e tij me kërkimin shkencor gjatë realizimit në klasë çon në përzgjedhjen e metodave më rezultative. Nisur nga fakti se cilësia në mësimdhënie/nxënie mbetet një domosdoshmëri, përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave, i mjeteve pedagogjike dhe përshtatja e tyre me tregun e punës, përbëjnë objektivat afatgjatë të një edukimi nëpërmjet shkencave dhe multikulturor.

Fjalët çelës: didaktikë e gjuhëve, komunikim turistik, metoda mësimore, mësimdhënie, sipërmarrje inovative.

ABSTRACT

This paper aims to examine the impact of developing the learning process in higher education and how this development can contribute to strengthening the tourism sector in Albania. As a sector that relies heavily on international communication and cooperation, the tourism industry necessitates the enhancement of students' language skills and their ability to interact effectively with tourists. Therefore, this paper argues that interaction with tourists can enable students to engage with knowledge more efficiently. This study explores how a student-centred approach can be developed through a socio-constructivist perspective, emphasizing learning as a socially mediated process. Based on interviews with instructors and classroom observations, the research

highlights the importance of professional teacher training using contemporary pedagogical methods, in combination with scientific research during instructional implementation. This integrated approach supports the identification and application of the most effective teaching methods. Given that quality teaching and learning remain essential in higher education, the continuous improvement of curricula, pedagogical tools, and their alignment with the labour market needs are identified as long-term objectives. In this context, the development of foreign language proficiency is shown to have a significant impact on both the learning and the tourism sector. Interaction with tourists not only fosters practical language use but also contributes to a scientific and multicultural education, preparing students for the demands of a globalized professional environment.

Key words: communication for tourism, innovative enterprise, language didactics, teaching, teaching methods.

Hyrje

Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, zhvillimi i aftësive gjuhësore, sidomos në gjuhët e huaja, është bërë një domosdoshmëri për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të gjithanshëm të shoqërive dhe ekonomive. Në Shqipëri, ku turizmi është një sektor me potencial të madh për rritje dhe zhvillim, domosdoshmëria për përmirësimin e aftësive gjuhësore është e lidhur ngushtë me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve turistike dhe rritjen e mundësive për të ndikuar pozitivisht në këtë industri. Gjuha është një urë lidhëse që mund të ndërtojë dhe fuqizojë marrëdhëniet ndërkombëtare, duke krijuar mundësi për krijimin e eksperiencave unike dhe të personalizuarra për turistët.

Në ditët e sotme, lëvizja e lirë dhe udhëtimet i kanë shndërruar sektorë të tillë si turizmin dhe sipërmarrjen, në mjete efikase për t'u sjellë udhëtarëve eksperiencë të reja dhe unike nëpërmjet bashkëpunimeve të frytshme që ata realizojnë mes tyre.

Përdorimi i teknologjisë edhe në këtë fushë (rezervimi, guidat në linjë, dhënia e informacionit orientues, zbulimi në linjë i vendeve turistike) bëjnë të mundur që eksperiencat e tyre në vendet që ata vizitojnë të jenë më të pasura, më të detajuara dhe më të plota pikërisht nëpërmjet këtij realiteti virtual të shtuar.

Nisur nga ky qëllim, ndërmarrjet inovuese synojnë të venë në jetë praktika të qëndrueshme, si qëndrime në mjedise ekologjike, vetura elektrike sisteme të menaxhimit të energjisë apo veprimtari të tjera në mbrojtje dhe respektim të ambientit. Në sajë të kësaj qasjeje

virtuale, ndërmarrjet mund të përmirësojnë ofertat e tyre në funksion të preferencave të klientëve, duke e përmirësuar ndjeshëm ofertën ndaj klientit. Kjo shfaqet edhe në personalizimin e itinerareve turistike të cilat bazohen në interesat specifike të klientëve.

Kjo qasje e re ndërvepruese ka sjellë modele të reja ekonomike. Kështu, platformat ndërvepruese si Airbnb apo dhe platforma të tjera të qiradhënies/marrjes e kanë transformuar plotësisht mënyrën se si njerëzit po udhëtojnë në ditët e sotme. Gjithashtu, një pjesë e projekteve turistike novatore po financohen nga bashkësitë, duke mundësuar zhvillimin e ofertave të reja e të personalizuar.

Për më tepër, shoqërimi i të gjithë këtyre ndryshimeve me zhvillimin e transporteve të qëndrueshme e efikase lehtëson arritjen si duhet në destinacionet turistike, madje kjo është arritur edhe për persona me aftësi të kufizuara. Marketingu në linjë është përhapur sidomos në rrjetet sociale duke rritur ndjeshëm prirjen për të udhëtuar si dhe komunikimin e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm me klientët. E gjithë kjo, falë informacionit e ndërveprimit, të cilat kanë bërë që shumë udhëtarë apo turistë të shprehin mendimin e tyre hapur dhe të jenë mjaft të kënaqur nga mundësitë e reja që u janë ofruar nga mjetet teknologjike në ditët e sotme.

Për këtë arsye ne mund të themi se mundësitë që jepen nëpërmjet inovacionit në sektorin e turizmit përfaqësojnë mundësi të panumërta për ndërmarrjet që të ekzistojnë e të zhvillohen si dhe t'u përgjigjen kërkesave gjithnjë e në rritje të konsumatorëve. Ky sektor, jo vetëm e ka zgjeruar ofertën ndaj klientit, por në sajë të teknologjive moderne dhe praktikave të qëndrueshme, po jep kontributin e tij, në zhvillimin e një turizmi më të përgjegjshëm dhe që vepron duke e respektuar ambientin. Vetëm ato ndërmarrje që do të dinë t'u përshtaten kohës dhe prirjeve të reja do të dinë që të ecin përpara në një treg në përparim të vazhdueshëm

Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe edukimi i të rinjve me metoda që nxisin të mësuarin aktiv gjatë gjithë jetës, marrjen e dijeve në mënyrë efikase dhe lidhjen e tyre me praktikën. Në një botë që ndryshon vazhdimisht dhe ku gjuhët e huaja janë kthyer në domosdoshmëri, fusha të tilla si turizmi dhe sipërmarrja janë pazgjidhshmërisht të lidhura me to. Qëllimi i këtij punimi është që të vërë në dukje këtë qasje ndërdisiplinore duke përshkruar edhe se si realizohet ndërveprimi mes tyre. Ai synon të hedhë dritë mbi disa dukuri pedagogjike, të cilat mund të kenë një

ndikim pozitiv në rritjen e cilësisë në përvetësimin e njohurive shkencore në institucionet e arsimit të lartë.

Kur studentët u pyetën se a ishin të motivuar në përvetësimin e dijes shkencore në fakultetin e ekonomisë, në Universitetin Mesdhetar të Tiranës, vetëm 1.24% prej tyre u përgjigjën negativisht gjë që tregon se ata janë të ndërgjegjshëm që shkencat dhe gjuhët e huaja zënë një vend të privilegjuar në shoqëri. Hapësirat e punësimit janë të përhershme në këto fusha dhe nëpërmjet këtyre dijeve ndërdisiplinore, ato jetësohen. Por, në momentin kur studentët u pyetën se si ata arrinin që t'i përvetësonin njohuritë e marra, një përqindje e lartë prej tyre, rreth 39.63%, nuk u janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Si mund të shpjegohet ky qëndrim? Cilat mund të jenë shkaqet e një reagimi të tillë që ndikon në një përvetësim jo efektiv të dijes dhe në një neglizhencë të rolit të saj në punësimin e tyre dhe në të mësuarin gjatë gjithë jetës në të ardhmen?

Kuadri teorik i punimit

Nëpërmjet këtij studimi që nuk pretendon të jetë shterues, synohet të analizohen vështirësitë që studentët ndeshin në marrjen e njohurive në fushën profesionale. Vëzhgimet në klasë, të cilat lejojnë analizën e perceptimeve të tyre për procesin mësimor do të ndihmonin në identifikimin dhe gjetjen e mënyrave për të kapërcyer disa nga këto vështirësi që ata hasin në marrjen e dijeve. Nga pikëpamja teorike, ky studim mbështetet kryesisht në analizën e boshtit psikologjik të sistemit didaktik (Chevallard, 1985)¹, pra, në marrëdhënien që studentët vendosin me njohuritë, përmirësimi i të cilave varet pashmangshmërisht nga strategjitë pedagogjike të përdorura nga mësuesi në klasë (Reboul, 2001).²

Njohja dhe kapërcimi i vështirësive me të cilat ata përballen gjatë procesit të përvetësimit të dijes bazohet në tërësi në një sistem mjetesësh që lidhen me hartimin e një kurrikulumi që merr parasysh interesat e tyre ndaj lëndës dhe perspektiven e tyre të punësimit. Gjithashtu, ai bazohet në një qasje integrale, e thënë ndryshe, në një mësimdhënie të bazuar

¹ CHEVALLARD, Y. (1985). La transposition didactique: du savoir savant au savoir enseigné, La pensée sauvage. Grenoble. Burimi: https://www.persee.fr/doc/rfp_0556-7807_1986_num_76_1_2401_t1_0089_0000_1

² REBOUL, O. (2001). Qu'est-ce qu'apprendre? Paris. Botimet PUF, f. 111

në nevojat e tyre. Nga ana tjetër, krijimi i një metodologjie mësimore të orientuar drejt studentëve nënkupton një përqendrim në procesin e të mësuarit. Njohuria nuk transmetohet; ajo ndërtohet nga studentët (Jonaert, 2002; Johsua, 1993)³ të cilët duhet të dinë edhe se si ta përdorin atë dhe zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre në situata të ndryshme (Brousseau, 1998).⁴ Duke u mbështetur në këto parime të përgjithshme, ne kemi formuluar dhe hipotezat, të cilat do të diskutohen në këtë punim:

- Mësimdhënia/nxënia konsiderohen si një proces ndërveprues me një rezultat të vetëm në fund. Ato synojnë që të rrisin aftësitë nxënës të studentëve në lidhje me përvetësimin e dijes dhe përdorimin e saj në praktikë. Për këtë arsye edhe metodat e mësimdhënies/nxënies në mënyrë të natyrshme synojnë në ndryshimin e mënyrës se si studentët i perceptojnë njohuritë. Pra, ato duhet të konsiderohen jo thjesht si një detyrim shkollor apo si dije pa vlerë, por si koncepte të rëndësishme, me karakter veprues të cilat do i shoqërojnë ata gjatë gjithë punës e jetës.

- Për pasojë, trajnimi i vazhduar i pedagogëve jo vetëm për sa i përket anës profesionale, por edhe asaj didaktike ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e përvetësimit të njohurive nga ana e studentëve në shkollë.

Kuadri metodologjik

Për të analizuar më konkretisht ndikimin e anës didaktike e gjuhësore në përvetësimin e dijes, ne studiuam dy korpuse. I pari, ka të bëjë me një grup studentësh që ndjekin lëndën “Etika dhe Komunikimi në Biznes”, viti i 2 dhe i 3, në Universitetin Mesdhetar të Tiranës. Grupi i dytë, ndjek lëndën e gjuhës së huaj në nivelin bachelor, viti i parë, dega Telekomunikacion, në Universitetin Politeknik të Tiranës. Viti shkollor që ndjekin është 2023-2024. Numri i studentëve e kapërcen numrin 60, pra, është një numër i konsiderueshëm i cili na ndihmon që rezultatet e nxjerra të jenë të besueshme. Mjetet e përdorura janë vëzhgimi dhe mbajtja e shënimeve nga ana e pedagogut. Vëzhgimi në klasë u bazua

³ JOHSUA, S. DUPIN, Jean-Jacques. (1993). Initiation à la didactique des sciences et des mathématiques, PUF: Paris. Burimi: https://www.persee.fr/doc/rfp_0556-7807_1994_num_109_1_2533_t1_0155_0000_2

⁴ BROUSSEAU, G. (1998). Théorie des situations didactiques, revista e shkencavetëdukimit, Grenoble. Burimi: <https://www.erudit.org/fr/revues/rse/2000-v26-n2-rse367/000137ar.pdf>

në mësimin e terminologjinë shkencore dhe përvetësimin aktiv të saj. Studenti e ka përvetësuar terminologjinë në momentin kur ai është në gjendje që ta riformulojë atë me fjalët e veta. Gjithashtu, një element tjetër që tregon shkallën e përvetësimit të saj është edhe përdorimi i kësaj terminologjie në ligjërimin e tij profesional.

Mbajtja e shënimeve është një mënyrë tjetër e cila na ndihmon që të mos përqendrohemi vetëm te rezultati, por sidomos te procesi i të mësuarit, pra, i mënyrës se si studentët i kuptojnë e i brendësojnë njohuritë e marra gjatë procesit mësimor. Për më tepër, mjetet e ndryshme të përdorura gjatë këtij procesi, duke kaluar në sitën e nxënies, tregojnë se cila nga metodat është efektive dhe cila duhet të rikonceptohet.

Në këtë mënyrë, këto qasje cilësore na ndihmojnë që ta kuptojmë më thellë procesin e nxënies dhe, në funksion të saj, ta ndërtojmë apo përmirësojmë mësimdhënien. Për t'i bërë studentët të aftë, duhet që ata, aftësitë e fituara t'i vënë në praktikë në situata të përafërta me ato të jetës reale. Ne duhet t'i përgatisim studentët se si t'ia dalin mbanë në një botë komplekse. Njohuritë dhe aftësitë, janë elementet kryesore për të ndërtuar lidhje të reja dhe për t'iu përshtatur një bote në ndryshim të vazhdueshëm.

Ndërkohë, edhe intervista me pedagogët pati rëndësinë e saj, për dy arsye. Së pari, për sa i përket rrafshit të përmbajtjes, ajo hodhi dritë në lidhjen e vazhdueshme që ekziston ndërmjet lëndëve. Së dyti, arritëm të kemi një këndvështrim të tyre mbi formimin e vazhdueshëm të mësuesve si dhe problematikat që ai shfaq në terren.

Rezultate dhe interpretime

Studimi i orëve të mësimin, në të dyja rastet e në të dy universitetet, vuri në dukje se studentët hasin vështirësi në kuptimin e nocioneve të fushës së specialitetit dhe sidomos në vënien e tyre në praktikë. Një pjesë të shkaqeve ata e gjejnë në *mungesën e një koherence*, për sa i përket nivelit të njohurive, në kalimin nga shkolla e mesme në atë të lartë. Një element tjetër që ata përmendin është edhe *lidhja ndërmjet koncepteve* gjatë shtjellimit të lëndës. Një shkak tjetër është edhe niveli i njohjes së gjuhës së huaj, pasi jo të gjithë e zotërojnë në mënyrë të përkryer.

Inovacioni në mësimdhënie

Eksperimentimi i një *mësimdhënieje ndryshe*, ishte lajtmotivi i dëshirave të tyre përkundrejt orës së mësimi. Por, në momentin kur pedagogu përdorte një mënyrë mësimdhënieje ndryshe, reagimi i studentëve vazhdonte të ishte pasiv. Kjo tregon se ndryshimi i mënyrës së marrjes së dijes është një proces që zgjat në kohë, ndaj dhe duhet menduar me kujdes.

Kështu, hapi i parë që ne ndërmorëm ishte *kalimi koherent* nga një temë në tjetrën dhe konceptimi i pyetjeve që i nxisin studentët të reflektojnë mbi temën e trajtuar gjë që i shtyn që të japin dhe mendimin e tyre personal mbi të.

Së dyti, *ndryshimi i metodave të mësimdhënies*. Mënyra e dhënies së mësimi me Power Point, e njëjtë në të gjitha lëndët, është bërë e bezdisshme për ta. Për më tepër, me që slajdet kalojnë shpejt, ata nuk arrijnë t'i kuptojnë dhe t'i brendësojnë si duhet konceptet e reja, të shtjelluara në to. Hapi që ne ndërmorëm lidhej me kombinimin e shpjegimit me Power Point me atë në tabelë, apo përfshirjen e studentëve në shpjegim për të bërë lidhjen e asaj që dinë me atë që do u duhet të mësojnë.

Për sa i përket fjalorit të fushës, u vu re se një metodë e mirë është edhe përfshirja e studentëve në hartimin e projekteve. Kështu, realizimi i tyre ngjalli mjaft interes pasi duke u mbështetur në përdorimet e tyre të teknologjisë (motorë kërkimi, forume, faqe web-i apo Tik-tok) ata gjenin tekste e video që moshatarë të tyre kishin hedhur në linjë e që lidheshin me fushën e tyre të specialitetit. Sipas tyre, kjo ishte një mënyrë tjetër se si ata i qaseshin dijes. Kjo i që koncepte teorike të vështira t'i merrnin në mënyrë më të thjeshtëzuar e t'i përvetësonin më lehtë.

Roli i mësuesit, në këtë rast, ishte ai i mbështetjes së tyre në mënyrën e paraqitjes së projektit. Gjithashtu, ai i udhëzonte se si mund t'i përdornin këto materiale duke i lidhur me leksionet e marra në shkollë. Kjo mënyre e re e shikimit të lëndës ndihmoi në përforcimin e dijeve të marra në shkollë si dhe ngulitjen më mirë të koncepteve themelore mbi to. Por, problematika më e madhe, në këtë rast, qëndron në vlerësimin e punës në grup, pasi jo të gjithë anëtarët e ekipit janë përfshirë në këtë projekt në mënyrë të plotë. Mënyrat e vlerësimit të kësaj pune edhe individualisht,

mbetet një nga vështirësitë e këtij investimi.

Nga ana tjetër, jo të gjithë studentët janë të interesuar për të punuar në projekte dhe në grup, ndaj puna e mësuesit është edhe një punë komunikuese për kalimin e këtyre vështirësive dhe mobilizimin e të tërë klasës për t'u përfshirë së bashku në këto projekte. Ndonjëherë, studentët parapëlqejnë të punojnë më mirë vetëm sesa në grup pasi i druhen një mosreagimi nga ana e të tjerëve. Por, puna e mësuesit qëndron në bindjen e tyre për gjetur urat e përbashkëta e për të bashkëvepruar mes tyre. Përvoja tregon se, në ditët e sotme, puna në ekip është një domosdoshmëri për të kryer detyrat në afate të shkurtra e me cilësi. Ndaj dhe inkurajimi i tyre u lejon jo vetëm të kursejnë kohë, por edhe të mësojnë nga njëri-tjetri se si punohet se si mund të bashkëveprojnë e ndajnë detyrat duke marrë secili përsipër atë që mund të bëjë më mirë.

Formimi i vazhduar i mësuesve dhe problematikat e tij

Pedagogët që morën pjesë në intervistë u përkasin fushave shkencore dhe u përfshinë në punën tonë studimore me qëllim që të na ndihmonin për të realizuar sa më mirë projektin tonë. Kështu ata u shfaqën të gatshëm që të na ndihmonin për të dhënë sa më shqip termat e huaj të dokumenteve shkencore. Ata na ndihmuan edhe me dokumente të fushës së tyre që ngjallnin interes për studentët të cilat mund t'i përdornim në mësimdhënien tonë.

Për sa i përket anës shkencore, ndihma e tyre ishte me vlerë pasi studentët ishin më të interesuar për të lexuar e punuar me dokumente që i përkisnin fushës së tyre të specialitetit. Por, edhe në këtë fushë, bashkëpunimi ndërmjet pedagogëve ishte mjaft i frytshëm. Kështu, pedagoget e gjuhëve të huaja dhanë kontributin e tyre nga ana didaktike në didaktizimin e videove që pedagogët e shkencave përdornin në orën e mësimit.

Nëse ata më parë thjesht i shfaqnin ato për studentët, nëpërmjet përpunimit që i bënë më pedagogët e gjuhëve të huaja që janë më të formuar në këtë fushë nga ana didaktike, ata kanë arritur që t'i përpunonin didaktikisht materialet e videove duke dhënë një orë mësimi ndryshe, por me objektiva të njëjta e për më tepër me një interes më të madh në ndjekjen e tyre nga ana e studentëve.

Ata u ndërgjegjësuam për faktin që formimi i tyre shkencor dhe

përditësimi i vazhdueshëm i dijes shkencore duhet të ndërthuret edhe me dije nga fusha e didaktikës së mësimdhënies, gjë për të cilën ata nuk kanë marrë një formim në shkollimin e tyre. Por edhe projekte të tilla bashkëpunuese mund të jenë një nga mënyrat indirekte të qasjes ndaj një mënyre të tillë mësimdhënieje. Bashkëpunime të tilla bëjnë të mundur nxjerrjen në pah të problematikave të tilla dhe krijojnë mundësi për një ndihmë të ndërsjellë dhe mjaft të frytshme në këtë drejtim.

Sigurisht, edhe në bashkëpunimin ndërmjet kolegëve, mirëkuptimi nuk është gjithmonë dhe në çdo kohë i mundshëm, ka edhe mosmarrëveshje apo moskuptime të vlerës që paraqet një qasje didaktike në mësimdhënie. Vetëm se një përvojë e tillë tregoi se kur kolegë të fushave të ndryshme veprojnë në sinergji ndërmjet tyre, rezultatet janë mjaft të prekshme dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e mësimdhënies, pra në të mirë të studentit.

Ndërdisiplinariteti dhe bashkëpunimi ndërdisiplinor arrihen me përpjekje dhe me dëshirën e mirë për t'i përmirësuar fushat ku shtrihet mësimdhënia. Përshtatja e kësaj të fundit ndaj mësimnxënies dhe matja e punës së kryer nëpërmjet aftësive që ata kanë krijuar te studenti është realizimi më i përkryer i punës së një pedagogu.

Përfundime

Ky punim synonte të propozonte disa mënyra se si mund të përmirësohet raporti ndërmjet mësimdhënies në gjuhë të huaj dhe shkencave në mësimin e koncepteve profesionale në universitete.

Një ndër objektivat e reformës në Arsimin e Lartë në Shqipëri, sidomos pas procesit të Bolonjës është dhe edukimi i të rinjve nëpërmjet shkencës. Në një botë që është në ndryshim të vazhdueshëm, integrimi i dijeve mund të konsiderohet si një metodë mjaft e mirë në rritjen e aftësive personale e profesionale të studentëve.

Në këtë vazhdë ndryshimesh, formimi i vazhduar i mësuesve dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre edhe kur janë të formimeve të ndryshme, brenda universitetit, por edhe ndërmjet universiteteve mund të konsiderohet si një nga shtyllat kryesore të reformimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri.

BIBLIOGRAFIA

- BROUSSEAU, G. (1998). *Théorie des situations didactiques*, revista e shkencave të edukimit, Grenoble. Burimi : <https://www.erudit.org/fr/revues/rse/2000-v26-n2-rse367/000137ar.pdf>
- BUHALIS, D., & SINARTA, Y. (2019). "Tourism Management and the Business of Tourism: Innovation and Transformation." Routledge
- CHEVALLARD, Y. (1985). *La transposition didactique: du savoir savant au savoir enseigné*, La pensée sauvage. Grenoble. Burimi:
- COOK, V. (2016). *Second Language Learning and Language Teaching*. Routledge
- DUPIN, J, S. Jean-Jacques. (1993). *Initiation à la didactique des sciences et des mathématiques*, PUF:Paris. Burimi: https://www.persee.fr/doc/rfp_05567807_1994_num_109_1_2533_t1_0155_0000_2
- HARRIS, R. (2020). *Teaching Foreign Languages in the 21st Century: Innovative Approaches to Language Learning*. Springer
- Ministria e Arsimit (2021) *Draft strategjia për arsimin 2021-2026*. Burimi:<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>
- PAPATHEODOROU, A., & ARVANITIS, P. (2016). "Innovation and Technology in the Tourism Industry." Routledge.
- REBOUL, O. (2001). *Qu'est-ce qu'apprendre?* Paris. Botimet PUF.

ZHVILLIMI I AFTËSIVE KYÇE TË TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS NËPËRMJET MËSIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA

Prof. Asoc. Dr. Elona Toro

Departamenti i Gjuhës Frënge
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: elona.toro@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky artikull shqyrton ndikimin e mësimit të gjuhëve të huaja në zhvillimin e kompetencave kyçe të nxënësit gjatë gjithë jetës të synuara nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar në Shqipëri. Në këtë studim do të eksplorojmë se si përvetësimi i një gjuhe të huaj mund të luajë një rol vendimtar në përforcimin e aftësive kyçe si komunikimi, të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, aftësia digjitale etj. Kjo analizë lidhet me aspektet konjitive, gjuhësore dhe kulturore të nxënies së gjuhëve të huaja duke vënë theksin mbi zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve. Për më tepër, artikulli thekson rëndësinë e integritit të aftësive gjuhësore në kontekste reale, duke nxitur kështu zhvillimin e aftësive ndërkulturore dhe sociale. Mësimi i gjuhëve të huaja paraqitet si një mënyrë efektive për të zgjeruar horizontet e individëve, duke promovuar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Në këtë artikull do të analizojmë gjithashtu se si tekstet e gjuhës së huaj ndihmojnë në zhvillimin e aftësive kyçe dhe si kemi zhvilluar me studentët e masterit të Departamenti të gjuhës frënge në Universitetin e Tiranës, aktivitetet për zhvillimin e këtyre aftësive në kuadër të lëndës Burime të informacionit. Artikulli thekson se mësimi i gjuhëve të huaja nuk kufizohet vetëm në zotërimin e aftësive gjuhësore, por është gjithashtu një mjet i fuqishëm për zhvillimin holistik të aftësive kryesore. Nxënien e zgjeruar duhet të përfshijë në mënyrë praktike mësuesit, politikëbërësit dhe nxënësit, duke theksuar rëndësinë e integritit aktiv të mësimit të gjuhëve të huaja në programet arsimore për të promovuar zhvillimin e aftësive kyçe për nxënien gjatë gjithë jetës.

Fjalët çelës: gjuhë frënge si gjuhë e huaj, kompetencat kyçe, TIK.

ABSTRACT

This article aims to examine the impact of foreign language learning on the development of key competencies in students, identified in the pre-university curricular framework in Cyprus. Through a descriptive and explanatory analysis, the study explores how acquiring a foreign language can significantly contribute to strengthening essential skills such as communication, critical thinking, problem-solving, digital skills, etc. This analysis addresses the cognitive, linguistic, and cultural dimensions of foreign language learning, emphasizing its role in the overall development of students. Furthermore, the article emphasizes the importance of integrating language skills in real-life contexts, thereby fostering the development of intercultural and social skills. Foreign language

learning is presented as an effective means of broadening individual perspectives, promoting mutual understanding, and enhancing international cooperation. The article also analyzes how foreign language texts contribute to the development of key skills, drawing on activities developed with the master's students in the Department of French at the University of Tirana, specifically within the course "Sources of information". In conclusion, the article highlights that foreign language learning is not limited to language mastery but it is also a powerful tool for the holistic development of key skills. Effective implementation requires the practical involvement of teachers, policymakers and students, emphasizing the importance of actively integrating foreign language learning into curricula to support lifelong learning and competence development.

Keywords: French language, ICT, key competencies.

1. Hyrje

Në ditët e sotme komunikimi dhe marrëdhëniet tregtare po lehtësohen gjithmonë e më shumë në shkallë globale përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK), si interneti, rrjetet sociale dhe teknologjitë celulare. Ekonomitë, shoqëritë dhe kulturat janë gjithnjë e më shumë të varura nga njëra-tjetra. Udhëtimet ndërkombëtare dhe migrimi janë bërë më të lehta, duke i lejuar individët të lëvizin më lirshëm përtej kufijve për arsye turistike, arsimore, pune ose emigrimi. Aksesit në informacion është shumë më i thjeshtë falë internetit, duke mundësuar shkëmbim të shpejtë dhe të gjerë të njohurive dhe ideve në mbarë botën. Ndërveprimet ndërmjet kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme janë bërë më të shpeshta, duke çuar në një rritje të shkëmbimit të vlerave, traditave dhe praktikave kulturore. Sfidat tilla si ndryshimet klimatike, pandemitë, varfëria dhe konfliktet transnacionale kërkojnë zgjidhje dhe bashkëpunim në shkallë globale.

Për t'i bërë ballë këtij konteksti, çdo qytetar do të duhet të përvetësojë një gamë të gjerë aftësish kyçe për t'u përshtatur në një botë që ndryshon me shpejtësi dhe që karakterizohet nga kjo shkallë e lartë ndërlidhjeje. Rugët dhe mënyrat me të cilat njerëzit i qasen sot informacionit dhe shërbimeve ndryshojnë vazhdimisht. Për këtë arsye, të gjitha moshat kanë nevojë të pajisen me kompetenca të reja që i ndihmojnë të përshtaten në botën e sotme digjitale, jo vetëm nëpërmjet fitimit të njohurive dhe aftësive teknike, por edhe nëpërmjet të kuptuarit të thellë të mundësive, sfidave dhe çështjeve etike, ligjore dhe shoqërore që lindin

ose shoqërojnë zhvillimet e reja ekonomike, shoqërore dhe teknologjike. Këto ndryshime shtrojnë domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave që i aftësojnë individët të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja.

Kompetencat shpreh nën përmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit. Aftësitë kryesore janë ato të nevojshme për të gjithë individët për përmbushjen dhe zhvillimin personal, qytetarinë aktive, integrimin social dhe punësimin. Aftësitë kryesore konsiderohen të jenë po aq të rëndësishme sa njëra-tjetra, në masën që secila prej tyre mund të kontribuojë në suksesin e individit që jeton në një shoqëri të zhvillimit të dijes. (MAS, 2014)

Për të qenë të aftë për të mësuar, është thelbësore të zotërohen aftësitë bazë në gjuhë, shkrim dhe lexim, numërim dhe teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK), dhe për çdo aktivitet të të mësuarit, është thelbësore të mësojmë sesi të nxëmë. Këto aftësi ndahen në tetë aftësitë kryesore: të menduarit kritik, kreativiteti, iniciativa, zgjidhja e problemeve, vlerësimi i rrezikut, vendimmarrja dhe menaxhimi konstruktiv i ndjenjave. (MAS, 2014)

Zhvillimet e sipërpërmendura dhe nevojat për ndryshime arsimore e bëjnë të qartë domosdoshmërinë për të nxënë gjatë gjithë jetës. Qytetarëve të shoqërisë së dijes u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë. Procesi i arsimit do t'i mundësojë çdo nxënësi zotërimin e kompetencave kyçe, të nevojshme për jetën dhe punën.

Lënda e gjuhëve të huaja është një mundësi për zhvillimin e kompetencave kyçe të nxënësit gjatë gjithë jetës të synuara nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar në Shqipëri. (IZHA, 2018)

Në këtë studim do të eksplorojmë se si përvetësimi i një gjuhe të huaj mund të luajë një rol të rëndësishëm në përf forcimin e aftësive kyçe si komunikimi, të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, aftësia digjitale etj. Mësimi i gjuhëve të huaja paraqitet si një mënyrë efektive për të zgjeruar horizontet e individëve, duke promovuar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Në këtë artikull do të analizojmë, gjithashtu, se si tekstet e gjuhës së huaj ndihmojnë në zhvillimin e aftësive kyçe dhe si kemi zhvilluar me studentët e masterit të Departamenti të gjuhës frënge në Universitetin e Tiranës, aktivitetet për zhvillimin e këtyre aftësive në kuadër të lëndës *Burime të informacionit*.

2. Literatura

Aftësitë jo-teknike, të referuara shpesh me emra të ndryshëm si aftësitë sociale, aftësitë transversale, aftësitë gjenerike, aftësitë bazë ose aftësitë e jetës, quhen ndonjëherë edhe “aftësitë e shekullit të 21-të” në projekte të caktuara kërkimore ose nga institucionet ndërkombëtare. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), nga ana e saj, përdori termat “aftësi kyçe” në 2003, dhe së fundmi, “aftësi për përparimin social” në 2015.

Megjithatë, aftësitë e buta përfshijnë aspektet sociale dhe ndërpersonale, si dhe aftësitë metodologjike ose meta-aftësitë. Kjo nënkupton aftësinë për të punuar nëpërmjet këtyre kompetencave, për t’i përshtatur dhe zbatuar ato nga një fushë në tjetrën, apo edhe nga një kontekst informal në një kontekst formal të të mësuarit. Për më tepër, aftësitë e buta janë krijuar për t’u konsideruar gjithnjë e më gjerë, si aftësi që janë të transferueshme nga një fushë veprimtarie, punë ose sektor profesional në tjetrin.

Prandaj, kompetencat janë një shkrirje dinamike e njohurive, të të kuptuarit dhe aftësive të fituara.. Programet arsimore synojnë të nxisin zhvillimin e këtyre aftësive, të cilat mësohen përmes moduleve të ndryshme dhe vlerësohen në faza të ndryshme. Nëse koncepti i kompetencës i referohet aftësisë për t’iu përgjigjur kërkesave komplekse dhe përfshin veprime komplekse, termi aftësi i referohet kapacitetit për të përdorur njohuritë e dikujt për të kryer detyra relativisht të thjeshta me një lehtësi të caktuar. (Robles, 2012)

Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar në Shqipëri, në të gjithë kurrikulën e referencës, përcaktohen tetë aftësi kyçe: kompetenca e të shprehurit (në gjuhën amtare dhe gjuhët e huaja), kompetenca digjitale, kompetenca e të mësuarit për të mësuar, kompetenca sociale dhe qytetare, kompetenca e sipërmarrjes, kompetenca e të menduarit kritik dhe kompetenca personale.

Së pari, komunikimi në gjuhën amtare është aftësia për të shprehur dhe interpretuar konceptet, mendimet, ndjenjat, faktet dhe opinionet si me gojë ashtu edhe me shkrim (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit), dhe për të bashkëvepruar në të gjitha situatat shoqërore dhe kulturore; në arsim dhe trajnim, në punë, në shtëpi dhe në kohën e lirë. (Europe Direct, 2007)

Për sa i përket komunikimit në gjuhë të huaja, aftësitë bazë janë përgjithësisht të njëjta si për komunikimin në gjuhën amtare: ai bazohet në aftësinë për të kuptuar, shprehur dhe interpretuar koncepte, mendime, ndjenja, fakte dhe opinione, si me gojë ashtu edhe me shkrim (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) në situata të ndryshme të jetës shoqërore dhe kulturore (shkollimi dhe trajnimi, puna, shtëpia dhe koha e lirë) sipas dëshirave dhe nevojave të secilit. Komunikimi në gjuhë të huaj kërkon gjithashtu aftësi të tilla si ndërmjetësimi dhe të kuptuarit e kulturave të tjera. Shkalla e zotërimit do të ndryshojë sipas katër dimensioneve në fjalë (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) dhe sipas gjuhëve, si dhe sipas kontekstit social dhe kulturor, mjedisit dhe nevojave dhe/ose interesave të secilit. (Europe Direct, 2007)

Së treti, kompetenca digjitale përfshin përdorimin e sigurt dhe kritik të teknologjive të shoqërisë së informacionit (IST) në punë, në kohën e lirë dhe në komunikim. Parakusht është aftësia në TIK: përdorimi i kompjuterëve për të marrë, vlerësuar, ruajtur, prodhuar, paraqitur dhe shkëmbyer informacion, si dhe për të komunikuar dhe marrë pjesë nëpërmjet internetit në rrjetet bashkëpunuese. (Europe Direct, 2007)

Së katërti, aftësia e të mësuarit për të mësuar është aftësia për të ndërmarrë dhe vazhduar të mësuarit, për të organizuar mësimin e dikujt, duke përfshirë menaxhimin efektiv të kohës dhe informacionit, si individualisht ashtu edhe në grup. Kjo aftësi përfshin njohjen e metodave dhe nevojave personale të të mësuarit, ofertat e disponueshme dhe aftësinë për të kapërcyer pengesat në mënyrë që të përfundohet nxënia me sukses. Kjo aftësi përfshin marrjen, përpunimin dhe asimilimin e njohurive dhe aftësive të reja, si dhe kërkimin dhe përdorimin e këshillave. Të mësuarit për të mësuar i shtyn nxënësit të shfrytëzojnë përvojat e mëparshme të të mësuarit dhe jetës për të përdorur dhe zbatuar njohuritë dhe aftësitë e reja në një sërë kontekstesh: në shtëpi, në punë, në arsim dhe trajnim. Motivimi dhe besimi në aftësitë personale janë elemente themelore.

Aftësitë sociale dhe qytetare përfshijnë aftësitë personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore dhe mbulojnë të gjitha format e sjelljes që duhet të zotërohen nga një individ në mënyrë që të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe konstruktive në jetën shoqërore dhe profesionale, si dhe aftësia për të zgjidhur konfliktet e mundshme. Aftësitë qytetare i lejojnë individit të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare nëpërmjet njohjes së koncepteve dhe strukturave shoqërore dhe politike dhe

pjesëmarrjes aktive dhe demokratike qytetare. (Hantat, O., Rafiq, 2023)

Fryma e iniciativës dhe sipërmarrjes i referohet aftësisë së një individi për t'i kthyer idetë në veprim. Kjo aftësi kërkon kreativitet, inovacion dhe marrje në sy të rrezikut, si dhe aftësi për të planifikuar dhe menaxhuar projekte për të arritur objektivat. Kjo aftësi është gjithashtu një pasuri për çdo individ, jo vetëm në jetën e tij të përditshme, në shtëpi dhe në shoqëri, por edhe në vendin e punës, pasi ai është i vetëdijshëm për kontekstin në të cilin zhvillohet puna dhe është në gjendje të shfrytëzojë mundësitë. (Europe Direct, 2007)

Lënda «Gjuhë e huaj» ndihmon nxënësin të zhvillojë kompetencën kyç të komunikimit dhe të shprehurit si edhe synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar, i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale, kulturore dhe emocionale të nxënësit duke pasur për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në gjuhë të huaj. (MAS, 2014)

Kjo lëndë krijon hapësirë për nxënësin të zhvillojë jo vetëm kompetencat gjuhësore, por edhe ato kyç për dy arsye kryesore: së pari pasi të nxënit është i orientuar drejt përdorimit të gjuhës në jetën e përditshme sipas Kuadrit Europian (KPER); së dyti, nxënia e gjuhëve të huaja është e orientuar drejt të vepruarit ku nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d. m. th., anëtar i shoqërisë, që ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi.

Komunikimi realizohet nëpërmjet veprimtarive gjuhësore, të cilat janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që u jep atyre kuptim të plotë. Përqasja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive, që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror. Në bazë të kësaj përqasjeje, çdo formë përdorimi dhe nxënieje e një gjuhe mund të përkufizohet si më poshtë: “Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga nxënësi, i cili si individ dhe si aktor shoqëror zhvillon një numër kompetencash kyç dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. (IZHA, 2018)

Nxënësi vë në zbatim kompetencat që zotëron në kontekste dhe kushte të ndryshme (situatat e të nxënit) dhe kalon vështirësitë për t'u përfshirë në veprimtari gjuhësore. Këto veprimtari përfshijnë proceset gjuhësore, të cilat mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me

tema dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi, çon në përfundimin ose përmirësimin e kompetencave kyç.

Së dyti, tematikat që trajtohen në lëndën e gjuhës së huaj janë të larmishme dhe mbulojnë të gjitha fushat e jetës, si p. sh. jeta e përditshme (organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; etj.); bota e shkollës dhe e punës (organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme etj.); jeta personale dhe shoqërore (mundësi dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, etj.) ; bota rreth nesh (arti në shekuj; e ardhmja, flora dhe fauna; etj.); bota e komunikimit (bota e teknologjisë; rrjetet sociale etj.).

Realizimi i kompetencave kyç gjatë procesit të të nxënës kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyç me kompetencat specifike të lëndës. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënës. Kur nxënësi punon për të përmbushur kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyç. (IZHA, 2018)

3. Metodologjia

Duke përdorur një metodë të përzier, ky hulumtim ofron një kuptim gjithëpërfshirës se si mësimi i gjuhëve të huaja kontribuon në zhvillimin e aftësive kryesore dhe ofron njohuri praktike për aktorët në arsim.

Së pari, ne u bazuam në një rishikim të literaturës për mësimin e gjuhëve të huaja dhe ndikimin e saj në zhvillimin e aftësive kryesore, duke ofruar kështu një kornizë teorike për studimin.

Më pas, bëmë një analizë të politikave dhe programeve arsimore për të kuptuar shkallën në të cilën mësimi i gjuhëve të huaja është i integruar në programet dhe politikat arsimore dhe për të vlerësuar rëndësinë që i jep kurrikula zhvillimit të aftësive kryesore përmes iniciativave për të mësuar gjuhë të huaja.

Së treti, kryem një analizë tekstuale të tekstit shkollor për mësimin e gjuhës frënge më të përdorur në Shqipëri (Alter Ego +) për të identifikuar se si është parashikuar zhvillimi i kompetencave kyç në këtë libër. Ne

jemi fokusuar kryesisht në aspekte të tilla si mendimi kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi dhe aftësitë digjitale dhe kemi ofruar ilustrime të shembujve specifike të teksteve apo aktiviteteve që nxisin zhvillimin e këtyre aftësive.

Së fundi, në këtë studim do të paraqesim edhe disa punë praktike të zhvilluara me studentët e masterit të vitit të parë të Departamenti të gjuhës frënge në Universitetin e Tiranës të cilat kanë si qëllim zhvillimin e këtyre aftësive në kuadër të lëndës *Burime të informacionit*.

4. Rezultatet

- **Metoda e gjuhës frënge Alter Ego +**

Manuali Alter Ego + praktikon qasjen komunikative të mësimdhënies, duke e vënë nxënësin në një situatë për të inkurajuar shkëmbimin autonom, si në klasë ashtu edhe në kontekste frëngjishtfolëse. Ai promovon një qasje të orientuar drejt veprimit, duke e përfshirë vazhdimisht nxënësin në procesin e tij të të mësuarit.

I organizuar rreth dy boshteve, teorik dhe pragmatik, Alter Ego + vë në pah dimensionin kritik të gjuhës frënge dhe kontekstualizimin e saj në shoqërinë bashkëkohore franceze dhe frankofone. Ai ofron një shumëllojshmëri këndvështrimesh (sociologjike, filozofike, ekonomike, etj.) për të zgjeruar vizionin e nxënësve dhe për të ushtruar mendimin e tyre kritik.

Çdo dosje fillon me një përzgjedhje dokumentesh të shkurtra dhe të larmishme, të shkruara dhe gojore, duke prezantuar temën e trajtuar. Këto dokumente i lejojnë nxënësit të zbulojnë lëndët përmes formave të ndryshme të ligjëritimit (artikuj shtypi, tekste letrare, infografikë, etj.).

Pas shqyrtimit të temës në aspektet e saj universale, manuali e kontekstualizon atë në të tashmen, duke ofruar materiale bashkëkohore si faqe interneti, forume, njoftime, CV, transmetime radiofonike etj., për të dhënë parametrat e nevojshëm për aspektet sociokulturore. (Antier et al., 2015)

Kështu, njohuritë empirike të nxënësit i nënshtrohen analizës individuale dhe kolektive, duke nxitur përvetësimin e aftësive të reja mësimore. Aktivitetet dhe strategjitë specifike mbështesin nxënësin në riformulimin dhe zhvillimin e autonomisë së tyre.

“Duke parë...” përbën boshtin e dytë kryesor të librit, duke theksuar një qasje kritike ndaj qytetërimit. Materialet autentike, nga burime të tilla si shtypi, radioja dhe literatura, inkurajojnë nxënësin të dallojë dhe të përqafojë këndvështrime të ndryshme.

Së fundi, pedagogjia e projektit i lejon nxënësit të riinvestojë njohuritë e marra duke sintetizuar dhe prodhuar punë origjinale, ku forma dhe estetika luajnë një rol të rëndësishëm.

• **Lënda «Burime të Informacionit»**

Në masterin e mësuesisë së Departamentin e Gjuhës frënge në Universitetin e Tiranës, studentët e vitit të parë ndjekin një lëndë mbi përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie.

Objekti kryesor i lëndës është i trefishtë: së pari, njohja e nxënësve me mjetet digjitale të dobishme në orët e gjuhës; së dyti, reflektimi mbi përdorimin e mjeteve digjitale për të zhvilluar aftësitë e studentëve; së treti, zhvillimi i punës bashkëpunuese midis studentëve për të përfunduar disa detyra, projekte ose media, për të kuptuar më mirë rëndësinë e krijimit të aktiviteteve tërheqëse.

Për realizimin e aktiviteteve jemi frymëzuar nga trajnimi i rrjetit CANOPÉ. Ne u ofrojmë studentëve mundësinë për të realizuar 5 projekte bashkëpunuese duke përdorur mjete digjitale.

Në detyrën e parë u kërkohet studentëve të krijojnë një mur virtual bashkëpunues. Më pas u kërkohet nxënësve tanë të paraqesin shembuj të përdorimit të mureve virtuale mbi punë bashkëpunuese në klasë.

Për realizimin e kësaj detyre studentët përdorin mjetin Padlet i cili është një “mur virtual” në të cilin mund të shfaqni të gjitha llojet e dokumenteve për të transmetuar apo shkëmbyer tekste, imazhe, regjistrime audio, video, faqe interneti etj.

Në detyrën e dytë studentët duhet të shkruajnë një tekst bashkëpunues në internet. Objekti teknik është të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se si funksionon një redaktues teksti bashkëpunues. Pastaj ata duhet të mendojnë për krijimin e kushteve që nxënësit e tyre të ardhshëm të përfshihen në shkrimin e dokumenteve bashkëpunuese.

Mjeti që ata përdorin për realizimin e kësaj detyre është Google Docs, i cili u lejon krijimin dhe modifikimin e dokumenteve të përbashkëta me palët e treta. Përdorimi i këtyre dokumenteve është thelbësor për metodat e mësimdhënies si klasa e përmbysur ose mësimdhënia e bazuar

në projekte.

Detyra e tretë synon të krijojë një hartë mendore bashkëpunuese. Para së gjithash, studentët duhet të kuptojnë se si funksionon një hartë mendore bashkëpunuese, si dhe pse ta përdorin atë në klasë dhe më pas të mësojnë ta krijojnë përmes mjeteve digjitale si Framindmap etj. aplikacione që ju lejojnë të krijojnë dhe të shkëmbejnë hartat. Përdorimi i hartave mendore bën të mundur identifikimin dhe krijimin e lidhjeve midis elementeve duke stimuluar të kuptuarit dhe memorizimin.

Detyra e katërt u kërkon nxënësve të krijojnë një libër multimedial. Nëpërmjet këtij aktiviteti ata duhet të kuptojnë se si funksionon krijimi i një libri multimedial, si ta krijojnë një të tillë duke krijuar kushtet që studentët të përfshihen në shkrimin e një libri bashkëpunues multimedial. Më pas ata duhet të paraqesin edhe shembuj të librave bashkëpunues multimedial në klasë.

Për të përmbushur këtë detyrë, ne i inkurajojmë të përdorin Canva, një platformë e dizajnit grafik që lejon përdoruesit të krijojnë grafika, prezantime, postera, etj. vizuale në mediat sociale.

Aktiviteti i fundit konsiston në krijimin e një podcasti. Kjo detyrë synon t'u sigurojë nxënësve informacion mbi podcast-in, përdorimin e tij, tipologjinë e tij, udhërrëfyesin për krijimin e tij si dhe njohuri për mjetet digjitale për prodhimin e tij. Podcasti mund të krijohet me Audacity, një redaktues audio dhe regjistruar të lehtë për t'u përdorur, me burim të hapur, me shumë këngë.

6. Përfundime

Rishikimi i thellë i aftësive jo-teknike në kontekstin e mësimi të gjuhëve të huaja ka ofruar një kuptim të thelluar mbi ndikimin e mësimi të gjuhëve në zhvillimin e kompetencave kyçe. Siç tregojnë rezultatet e këtij hulumtimi, mësimi i gjuhëve të huaja përqendrohet në zhvillimin e një sërë aftësish, duke përfshirë komunikimin efektiv, aftësitë digjitale, aftësinë për të mësuar, aftësitë sociale dhe qytetare, si dhe frymën e sipërmarrjes.

Në këtë kontekst, programet arsimore duhet të përqendrohen në promovimin e këtyre aftësive dhe të ofrojnë një qasje të ndryshme për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e tyre. Përmes një qasjeje të përzgjedhur

të materialeve mësimore dhe përdorimit të teknologjisë, mësuesit mund të inkurajojnë nxënësit të jenë aktorë aktivë në mësim dhe të zhvillojnë një ndjenjë të vazhdueshme të përmirësimit dhe përsosjes.

Gjithashtu, këto rezultate theksojnë rëndësinë e përdorimit të metodave të diversifikuara të mësimdhënies dhe mjetet e teknologjisë për të përmirësuar angazhimin dhe performancën e nxënësve. Duke përdorur mjetet e përshtatshme të komunikimit dhe bashkëpunimit në një mjedis të mësimi, nxënësit janë në gjendje të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për suksesin e tyre të ardhshëm në shoqëri dhe në vendin e punës.

Në përgjithësi, hulumtimi sugjeron se mësimi i gjuhëve të huaja mund të jetë një mjet i fuqishëm për zhvillimin e kompetencave jo-teknike në nxënësit, duke i përgatitur ata për sfidat dhe mundësitë e jetës së tyre të ardhshme.

BIBLIOGRAFIA

- ANITER, M., BONENFANT, J., Chrot, G., Dollez, C., Gouilloux, M., Pons., S. (2015), *Alter Ego +, méthode de français*, Hachette FLE, Paris
- Europe Direct. (2007). *Les Compétences clés pour l'éducation et la formation tout au long de la vie – Un cadre de référence européen*, Communautés européennes, Luxembourg: https://competencescles.eu/sites/default/files/attachements/keycomp_fr.pdf
- HANTAT, O., RAFIQ, M. (2023). The development of soft skills in teaching practices (case study: teaching French as a foreign language), *Faits de langue et société*, volume n° 9: pp. 86-97: <https://revues.imist.ma/index.php/FLS/>
- IZHA, MASH. (2018). Udhëzues kurrikular lëndor për gjuhën e huaj. Material ndihmës për mësuesit e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të ulët, Tiranë: <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/01/Gjuh%C3%AB-e-huaj-2.pdf>
- MAS. (2014). *Kormiza Kurrikulare e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*, Tiranë : <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- ROBLES., M. (2012). *Executive Perceptions of the Top 10 Soft Skills Needed in Today's Workplace*, *Business communication Quarterly*.

INTEGRIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË MËSIMIN HIBRID TË GJUHËVE TË HUAJA: SFIDA DHE PËRMIRËSIME NË VLERËSIM

Doktorante Lorena Kapxhiu

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: lorena.kapxhiu.fgjhdr@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) në mësimdhënien dhe vlerësimin e gjuhëve të huaja në formate hibride mund të sjellë ndryshime thelbësore në mënyrën si organizohet dhe përcillet procesi mësimor. Gjatë pandemisë së COVID-19-ës, platformat online u bënë mjet kryesor për të siguruar vazhdimësinë e arsimit, duke mundësuar fleksibilitet për mësuesit dhe nxënësit. Megjithatë, përdorimi i IA-së në procesin e vlerësimit nxori në pah shqetësime në lidhje me besueshmërinë dhe vlefshmërinë e rezultateve. Ky studim përfshin një grup prej 30 studentësh të gjuhëve të huaja që për gjashtë muaj ndoqën mësim tërësisht online të mbështetur nga inteligjenca artificiale. Kërkimi kombinon metoda të ndryshme, si: vlerësime adaptive me IA, portofolë studentësh, pyetësorë, dhe rezultatet nga provimet e jashtme, për të krahasuar efektivitetin e vlerësimeve të automatizuara me ato tradicionale. Rezultatet tregojnë se sistemet e bazuara në IA janë të dobishme në ofrimin e komenteve të personalizuar dhe nxisin angazhim më të lartë të studentëve. Megjithatë, këto sisteme hasin vështirësi në vlerësimin e aftësive komplekse si të folurit apo të shkruarit. Kombinimi i vlerësimeve të automatizuara me ato të udhëhequra nga mësuesit rezultojnë në një qasje më të balancuar dhe të besueshme. Ky studim sugjeron nevojën për modele të integruara vlerësimi në arsimin gjuhësor, që bashkojnë teknologjinë dhe pedagogjinë tradicionale në funksion të një arsimi më të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Fjalët çelës: edukim hibrid, inteligjencë artificiale, provime online, të nxëniet i personalizuar, vlerësim gjuhësor, vlerësim i kombinuar.

ABSTRACT

Hybrid foreign language education might be radically transformed by using artificial intelligence (AI) in teaching and testing. Online platforms came to be central to learning during the COVID-19 pandemic as they allowed for flexible schedules for both teachers and students. Nevertheless, the use of AI in the assessment process has raised concerns about the reliability and validity of the results. Comparisons between performance in traditional exams and AI-driven evaluations revealed notable inconsistencies, raising concerns about the effectiveness of AI in high-stake

assessments. This study involved 30 foreign language students who transitioned from classroom instruction to six months of fully online AI-supported classes. The research combined various methods such as AI-based adaptive assessments, student portfolios, surveys and results from external examinations to compare the effectiveness of automated assessments with traditional ones.

The findings show that AI-based systems are useful in providing personalized feedback and promoting higher student engagement. However, these systems face difficulties in evaluating complex skills such as speaking or writing. Combining automated assessments with teacher-led evaluations results in a more balanced and reliable approach. This study suggests the need for integrated assessment models in language education that merge technology and traditional pedagogy in the interest of more equitable and inclusive education.

Keywords: artificial intelligence, combined assessment, hybrid education, language assessment, online exams, personalized learning.

Hyrje

Integrimi i Inteligjencës Artificiale në Vlerësimin e Gjuhëve të Huaja: Sfida dhe Mundësi

Rritja e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) në edukim, veçanërisht gjatë pandemisë COVID-19, ka transformuar praktikat tradicionale të mësimdhënies dhe vlerësimit. Mjediset hibride të nxënit, që kombinojnë instruksionet ballë për ballë me ato online, janë përmirësuar ndjeshëm nga aftësitë e IA-së për të ofruar përvoja të personalizuar të të nxënit. Megjithatë, shqetësimet mbi besueshmërinë dhe vlefshmërinë e vlerësimeve të asistuar nga IA vazhdojnë të mbeten të rëndësishme, veçanërisht në fushën e edukimit të gjuhëve të huaja. Këto shqetësime lidhen me aftësi komplekse si të folurit dhe të shkruarit, të cilat kërkojnë analiza më të hollësishme dhe të nuancuara.

Siç vë në dukje Luckin (2017), IA ka potencialin për të mbështetur mësuesit në ofrimin e ndërhyrjeve të synuara dhe automatizimin e detyrave rutinë, duke e bërë procesin e mësimdhënies më efikas. Megjithatë, përdorimi i IA-së në vlerësimet me rëndësi të lartë mbetet sfidues. Në të njëjtën linjë, Richardson dhe Clesham (2021) theksojnë se IA është e shkëlqyer në ofrimin e reagimeve adaptive dhe shpërndarjen e përmbajtjes, por ajo has vështirësi në vlerësimin e rezultateve autentike të të nxënit dhe në përshtatjen me standardet tradicionale.

Ky studim shqyrton këto sfida në një kontekst specifik: performancën e 30 nxënësve të gjuhës angleze si gjuhë e dytë (ESL) në Shkollën Ndërkombëtare të Abu Dhabit. IA u përdor për të vlerësuar aftësitë kryesore të leximit, shkrimit, dëgjimit dhe të folurit. Hulumtimi trajton mospërputhjet midis rezultateve të vlerësimeve të asistuar nga IA dhe standardeve tradicionale të vlerësimit, duke synuar të ofrojë njohuri mbi optimizimin e modeleve hibride të vlerësimit. Përfundimet e studimit nënvizojnë nevojën për zhvillimin e kornizave më të integruara dhe të balancuara që përfshijnë mësuesit dhe teknologjinë për të siguruar vlerësime më të sakta dhe gjithëpërfshirëse në edukimin e gjuhëve.

Ky studim synon t'u përgjigjet pyetjeve kryesore që lidhen me ndikimin e inteligjencës artificiale në përmirësimin e mësimdhënies dhe vlerësimit, besueshmërinë e saj në krahasim me metodat tradicionale dhe mënyrat për të kombinuar IA me vlerësimet e mësuesve për një model hibrid më gjithëpërfshirës.

1. Cili është ndikimi i inteligjencës artificiale (IA) në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit në mësimin hibrid të gjuhëve të huaja?
2. Sa të besueshme dhe të vlefshme janë vlerësimet e asistuar nga IA në krahasim me metodat tradicionale të vlerësimit, veçanërisht për aftësitë komplekse si të folurit dhe të shkruarit?
3. Si mund të kombinohen më mirë teknologjitë e IA-së dhe vlerësimet e udhëhequra nga mësuesit për të ofruar një model hibrid më gjithëpërfshirës dhe të drejtë në edukimin e gjuhëve të huaja?

Rishikim i literaturës

Studimet e mëparshme kanë identifikuar avantazhet dhe sfidat që lidhen me integrimin e inteligjencës artificiale (IA) në vlerësimin arsimor, veçanërisht në kontekstin e edukimit të gjuhëve të huaja. Sipas Bulut dhe Beiting-Parrish (2024), teknologjitë IA kanë revolucionarizuar metodat e vlerësimit duke ofruar mundësi për korrektim të shpejtë, testim adaptiv dhe udhëzime të personalizuar që adresojnë nevojat individuale të nxënësve. Këto specifika kanë transformuar procesin mësimor, duke e bërë atë më efikas dhe të qasshëm për një audiencë të gjerë. Megjithatë, këto avancime kanë ngritur gjithashtu shqetësime etike në lidhje me drejtësinë, vlefshmërinë dhe barazinë në procesin e vlerësimit.

Një shqetësim i rëndësishëm është përlllogaritja sipërfaqësore në algoritmet e IA-së. Milleretal. (2019) argumentojnë se, ndonëse IA mund të ofrojë rezultate të shpejta dhe objektive, ajo shpesh dështon në kapjen e kompleksitetit të të nxënit njerëzor, veçanërisht në fusha ku kërkohet një vlerësim më i detajuar dhe kompleks, si aftësitë gjuhësore. Për shembull, vlerësimi i aftësive gjuhësore si të folurit dhe të shkruarit kërkon një ndërthurje të njohurive gjuhësore, komunikimit verbal dhe kompetencave ndërkulturore, të cilat teknologjitë IA shpesh nuk arrijnë t'i vlerësojnë me saktësi.

Clark et al. (2021) theksojnë se IA mund të përmirësojë praktikatat tradicionale të vlerësimit duke lehtësuar procesin për mësuesit dhe duke ofruar analiza të të dhënave në kohë reale. Sidoqoftë, ata paralajmërojnë se teknologjitë IA nuk duhet të zëvendësojnë gjykimin njerëzor, veçanërisht në vlerësimin e aftësive të ndërlikuara si komunikimi verbal dhe kompetenca ndërkulturore, ku roli i mësuesit mbetet i pazëvendësueshëm. Në mënyrë të ngjashme, Swiecki et al. (2022) mbështesin përdorimin e modeleve hibride që kombinojnë teknologjitë IA me vlerësimet e udhëhequra nga mësuesit për të ofruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të drejtë. Modelet hibride jo vetëm që sigurojnë një vlerësim më të saktë, por gjithashtu ndihmojnë në adresimin e sfidave etike dhe teknike që lidhen me përdorimin ekskluziv të teknologjisë IA.

Këto studime theksojnë rëndësinë e një qasjeje të ekuilibruar në edukimin e gjuhëve të huaja, ku teknologjia IA përdoret si një mjet mbështetës për të përmirësuar procesin e vlerësimit, porjosi një zëvendësues i plotë i praktikave tradicionale. Në kontekstin e vlerësimit gjuhësor, përmbushja e standardeve të drejtësisë dhe gjithëpërfshirjes mbetet thelbësore për të siguruar që të gjitha aftësitë e studentëve të vlerësohen në mënyrë të barabartë. Përmirësimi i vazhdueshëm i teknologjive IA dhe integrimi i tyre i kujdesshëm me ndërhyrjet e drejtuara nga mësuesit do të jetë vendimtar për të përmbushur kërkesat e një sistemi edukimi gjithnjë e më të diversifikuar dhe të globalizuar.

Metodologjia

Vendosja dhe Pjesëmarrësit

Studimi u zhvillua në një Shkollë Ndërkombëtare në Abu Dhabi, duke përfshirë 30 nxënës të shkollës së mesme të gjuhës angleze si

gjuhë e dytë (ESL). Këta nxënës, të përbërë nga 14 vajza dhe 16 djem, përfaqësonin një gamë të larmishme kombësish, përfshirë 90% nga Emiratet e Bashkuara Arabe, 5% nga Jordania dhe 5% nga Siria.

Pjesëmarrësit ndoqën një program intensiv të gjuhës angleze, me 4 orë mësimi në javë, nga muaji shtator deri në maj. Ky program u përqendrua në përgatitjen e tyre për provimet ndërkombëtare IGCSE të administruara nga Cambridge Assessment, të cilat korrigjohen dhe vlerësohen në Mbretërinë e Bashkuar. Provimet përfshinin vlerësimin e aftësive kryesore në lexim, shkrim, dëgjim dhe të folur, duke testuar jo vetëm aftësitë gjuhësore, por edhe kompetencat analitike dhe krijuese të nxënësve.

Në fillim të muajit qershor, sezoni i provimeve zëvendëson mësimdhënien e zakonshme dhe nxënësit ndërpresim mësimin në klasë. Gjatë kësaj periudhe, ata angazhohen në studim vetjak në shtëpi ose në shkollë, duke iu përkushtuar plotësisht përgatitjes për provimet. Nuk zhvillohen më orë tradicionale mësimore, duke u fokusuar vetëm në përsëritjen dhe përf forcimin e njohurive përmes burimeve dhe udhëzimeve të pavarura.

Ky proces ofroi një qasje të strukturuar për përmirësimin e aftësive gjuhësore dhe përgatitjen për standardet ndërkombëtare. Studimi gjithashtu shqyrtoi rolin e inteligjencës artificiale (IA) në mbështetjen e mësimin gjatë vitit akademik dhe efektivitetin e saj në matjen e aftësive komplekse si të folurit dhe të shkruarit.

Materialet dhe Mjetet

Kërkimi përfshiu përdorimin e një kombinimi të mjeteve të drejtuara nga inteligjenca artificiale (IA) dhe metodave tradicionale për të mbështetur mësimdhënien, të nxënësve dhe vlerësimin e studentëve. Mjetet e përdorura përfshinin:

1. **Platforma Digjitale: Google Classroom, Class Dojo dhe Write and Improve**
- **Google Classroom** dhe aplikacionet që ofron shërbyen si një platformë qendrore për shpërndarjen e materialeve mësimore, detyrave dhe udhëzimeve të personalizuar. Studentët kishin akses në materiale interaktive dhe burime mbështetëse, duke mundësuar

mësim të pavarur dhe ndjekje të progresit nga mësuesit.

- **Class Dojo** u përdor për të monitoruar angazhimin e studentëve dhe për të dhënë reagime të menjëhershme mbi përparimin e tyre. Kjo platformë gjithashtu ndihmoi në krijimin e një komunikimi efektiv ndërmjet studentëve, mësuesve dhe prindërve.
- **Write and Improve**, një mjet i fuqizuar nga IA, u përdor për të vlerësuar shkrimet e studentëve duke dhënë reagime të automatizuara dhe të detajuara mbi gramatikën, strukturën dhe koherencën. Ky mjet rezultoi i dobishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive të të shkruarit, duke lejuar studentët të përmirësonin punën e tyre bazuar në sugjerime specifike.

2. Portofolët: / Dosjet Kopje Online dhe Fizike

- Dosjet online dhe fizike u përdorën për të dokumentuar progresin e studentëve në mënyrë të vazhdueshme. Ato përfshinin detyra të përfunduara, shkrime të korrigjuara dhe projekte që tregojnë aftësitë e zhvilluara gjatë vitit akademik.

Këto portofole shërbyen si një mjet për të vlerësuar zhvillimin e aftësive të studentëve dhe për të dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të përparimit të tyre.

3. Vlerësimet e të Folurit: Aktivitetet e Regjistruara

- Aktivitetet e folurit u regjistruan për të vlerësuar rrjedhshmërinë, shqiptimin dhe strukturën gjuhësore të studentëve. Regjistrimet u përdorën për analizë të mëtejshme nga mësuesit dhe për të ofruar reagime të personalizuar mbi përmirësimin e aftësive të të folurit. Këto vlerësime, gjithashtu, u shfrytëzuan për t'u siguruar studentëve një pasqyrë të qartë të zonave ku nevojitej përmirësim.

Duke kombinuar këto mjete dhe metoda, studimi arriti të krijojë një qasje të balancuar ndërmjet teknologjisë dhe ndërveprimit tradicional mësimor. Kjo jo vetëm që ndihmoi në personalizimin e procesit të të nxënit, por gjithashtu përmirësoi saktësinë dhe gjithëpërfshirjen e procesit të vlerësimit.

Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave për këtë studim u bazua në një qasje gjithëpërfshirëse për të siguruar rezultate të besueshme dhe të vlefshme.

Së pari, u përdorën *vlerësime adaptive të drejtuara nga IA*, të cilat u projektuan për të monitoruar progresin e studentëve dhe për të ofruar reagime të personalizuar bazuar në performancën e tyre individuale. Këto vlerësime u krijuan për të adresuar nevojat specifike të studentëve duke identifikuar fushat që kërkonin përmirësim. Për të mbështetur këtë proces, u zhvilluan anketime dhe pyetësorë të strukturuar, të cilët ushpërndanësi për studentët ashtu edhe për mësuesit. Këto mjete kishin për qëllim të kapnin perceptimet, përvojat dhe vlerësimet e pjesëmarrësve lidhur me përdorimin e teknologjive të asistuar nga IA në procesin mësimor dhe vlerësues.

Përveç kësaj, *provimet ndërkombëtare* luajtën një rol të rëndësishëm në vlerësimin e performancës së studentëve dhe krahasimin e rezultateve të vlerësimeve të asistuar nga IA me standardet globale. Këtu përfshiheshin vlerësime të njohura ndërkombëtarisht si *GLA ssesments*, të cilat matin aftësitë gjuhësore dhe njohuritë përmbajtësore, dhe *testet CAT4*, të cilat fokusohen në vlerësimin e aftësive njohëse dhe analitike të studentëve. Gjithashtu, rezultatet nga *provimet Cambridge* u përdorën për të matur performancën në gjuhën angleze, duke siguruar një bazë të fortë për krahasim me vlerësimet e asistuar nga IA.

Kjo qasje e kombinuar lejon një analizë më të plotë dhe gjithëpërfshirëse të ndikimit të teknologjive IA në mësim dhe vlerësim. Duke kombinuar vlerësimet e automatizuara me të dhënat nga burime tradicionale dhe perceptimet e përdoruesve, studimi siguron një perspektivë të balancuar mbi efektivitetin dhe sfidat e vlerësimeve të asistuar nga teknologjia.

Analiza e të dhënave

Të dhënat sasiore nga rezultatet e provimeve të jashtme u analizuan duke përdorur statistika përshkruese, ndërsa të dhënat cilësore nga anketimet u analizuan tematikisht. Rezultatet zbuluan mospërputhje midis vlerësimeve të drejtuara nga IA dhe standardeve tradicionale. Për shembull, performanca e studentëve në provimet online të asistuar nga IA shpesh tejkalonte performancën e tyre historike në ambiente ballë për ballë.

Tabela: **Krahasimi i performancës**

Tipi i Vlerësimit	Studenti A	Studenti B	Studenti C
Nota (Provimi Letër)	5	6	5
Nota Online (IA)	8	8	7
Standardet e Jashtme (Provimet Ndërkombëtare)	5	6	5

Implikimet e rezultateve

Ky studim thekson dobësitë dhe kufizimet e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) në vlerësimin e të nxënësve të gjuhëve të huaja në mjediset hibride. Mjetet e fuqizuara nga IA, si vlerësimet adaptive, kanë ofruar reagime të personalizuar dhe të përshtatshme, duke ndihmuar studentët të identifikojnë dobësitë dhe pikat e tyre të forta në kohë reale. Siç vë në dukje Luckin (2017), këto mjete mund të përmirësojnë të mësuarit e vetërregulluar, duke i bërë studentët më të angazhuar dhe më të përqendruar në përmirësimin e tyre. Për më tepër, IA ka treguar aftësi për të personalizuar përvojën mësimore duke siguruar udhëzime të individualizuara bazuar në performancën e studentëve (Richardson & Clesham, 2021).

Megjithatë, gjetjet e studimit tregojnë se vlerësimet e asistuar nga IA shpesh nuk përmbushin standardet e besueshmërisë dhe vlefshmërisë kur përdoren si mjete të pavarura për vlerësimin e rezultateve të të nxënësve. Për shembull, disa studentë që më parë kishin performuar në nivelin 5 u vlerësuan papritmas në nivelin 8 ose më të lartë. Këto mospërputhje ngritën shqetësime rreth vlefshmërisë së algoritmeve të IA-së, duke sugjeruar se faktorët mjedisorë, si qasja në burime të jashtme apo kushte më të rehatshme në shtëpi, mund të kenë ndikuar në performancë. Miller et al. (2019) thekson se mungesa e kushteve të standardizuara gjatë provimeve online mund të dëmtojë integritetin e rezultateve.

Gjithashtu, IA tregon kufizime të dukshme në vlerësimin e aftësive komplekse gjuhësore, si rrjedhshmëria në të folur, përshtatshmëria

pragmatike dhe kompetenca kulturore. Clark et al. (2021) argumentojnë se këto aftësi kërkojnë një gjykim vlerësues që vetëm një mësues i trajnuar mund ta ofrojë. Për shembull, njohja e të folurit nga IA shpesh dështon në identifikimin e nuancave të theksit, intonacionit dhe kontekstit, të cilat janë të domosdoshme për komunikimin efektiv në një gjuhë të huaj.

Në mungesë të provimeve të standardizuara online, shumë institucione, përfshirë Cambridge, iu kthyen notave të bazuara në vlerësimin e mësuesve dhe materialeve mbështetëse si portofolët dhe regjistrimet audio. Kjo qasje e kombinuar siguroi një spektrum më të gjerë të provave dhe siguroi drejtësi dhe saktësi më të madhe në vlerësime (Chang et al., 2020). Në mënyrë të ngjashme, Swiecki et al. (2022) thekson rëndësinë e modeleve hibride që kombinojnë teknologjitë IA me moderimin nga mësuesit për të ofruar një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të barabartë.

Për të ilustruar perceptimet e studentëve mbi vlerësimet e asistuar nga IA, më poshtë është paraqitur një tabelë me të dhënat kryesore të mbledhura nga pyetësorët:

Pyetjet Kryesore	Pozitive (%)	Negative (%)	Neutrale (%)
A ndihmon IA në përmirësimin e gjuhës?	78%	12%	10%
A konsideroni që vlerësimet e IA janë të sakta?	64%	26%	10%
A ndihmon IA në identifikimin e gabimeve?	82%	10%	8%

Rezultatet e tabelës tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv për përfitimet e IA të të nxënit, por gjithashtu ngre një pikëpyetje rreth besueshmërisë së përgjigjeve mbi saktësinë dhe drejtësinë e vlerësimeve. Sa të vërtetë ka në përgjigjet e nxënësve?

Në përfundim, ndërsa IA ka potencial për të transformuar vlerësimet dhe për të përmirësuar personalizimin e mësimdhënies, përdorimi i saj duhet të kufizohet brenda një qasjeje hibride që përfshin moderimin e mësuesve. Për të arritur rezultate të drejta dhe të sakta, IA duhet të plotësojë gjykimin njerëzor dhe jo ta zëvendësojë atë. Përmirësimi i teknologjive IA duhet të fokusohet në adresimin e këtyre kufizimeve për

të siguruar barazi dhe vlefshmëri në edukimin e gjuhëve të huaja.

Kufizimet

Ky studim paraqet disa kufizime të rëndësishme që duhet të merren parasysh gjatë analizimit të rezultateve. Një nga sfidat kryesore lidhet me numrin e nxënësve (30 nxënës) që u mor si studim. Edhe pse të dhënat e mbledhura ofrojnë njohuri të dobishme mbi përdorimin e inteligjencës artificiale (IA) në edukimin hibrid të gjuhëve të huaja, ky grup relativisht i kufizuar nuk mund të arrijë përfundime që mund të përgjithësohen në mënyrë domethënëse në kontekste më të gjera arsimore. Studimet e ardhshme duhet të *synojnë grupe më të mëdha* dhe më të larmishme, duke marrë parasysh rajone të ndryshme, grupe mosha dhe nivele të ndryshme të aftësive gjuhësore. Një qasje e tillë do të mundësojë një kuptim më gjithëpërfshirës të efektivitetit dhe kufizimeve të vlerësimeve të asistuar nga IA.

Për më tepër, ndërsa studimi shqyrtoi të katër aftësitë gjuhësore – leximi, dëgjimi, të folurit dhe të shkruarit – sfidat ishin më të dukshme në vlerësimin e aftësive komplekse si të folurit dhe të shkruarit. Vlerësimi i të folurit, për shembull, kërkon analizë të hollësishme të rrjedhshmërisë, intonacionit dhe përshtatshmërisë kulturore - dimensione që teknologjitë aktuale të IA-së nuk mund t'i kapin plotësisht. Në mënyrë të ngjashme, vlerësimi i të shkruarit përfshin elemente krijuese dhe koherencë konceptuale, të cilat algoritmet e IA-së mund t'i keqinterpretojnë për shkak të varësisë së tyre nga kritere të paracaktuara. Siç argumentojnë Clark et al. (2021), këto aftësi kërkojnë një gjykim të nuancuar që vetëm një mësues i trajnuar mund ta ofrojë, duke theksuar kështu rëndësinë e ndërthurjes së teknologjisë IA me përfshirjen njerëzore.

Një tjetër kufizim që doli në pah është potenciali për paragjykitime të futura në sistemet e IA-së. Algoritmet janë të paanshme vetëm aq sa janë të larmishme dhe të barabarta të dhënat e trajnimit mbi të cilat ato mbështeten. Nëse bazat e të dhënave të trajnimit nuk përfaqësojnë një gamë të gjerë të stileve gjuhësore ose kulturave, kjo mund të çojë në vlerësime të shtrembëruara. Për shembull, studentët me theks ose stile komunikimi jo standarde mund të mos përfitojnë në mënyrë të barabartë nga këto sisteme, duke u vendosur në disavantazh të pajustificuar gjatë vlerësimeve.

Një aspekt tjetër që duhet theksuar është ndikimi i *perceptimeve subjektive të studentëve*, të mbledhura përmes anketave. Ndërsa këto të dhëna ofrojnë një perspektivë të vlefshme mbi përvojën e nxënësve, ato mund të mos përputhen gjithmonë me performancën reale. Studentët, të ndikuar nga lehtësia e përdorimit ose fleksibiliteti i vlerësimeve online, mund të mbivlerësojnë progresin e tyre. Richardson dhe Clesham(2021) theksojnë se perceptimet subjektive shpesh nuk korrespondojnë me matjet objektive të performancës, veçanërisht në mjedise të ndërmjetësuar nga teknologjia. Kjo mospërputhje ishte e dukshme në këtë studim, ku studentët raportuan kënaqësi të lartë me vlerësimet e IA-së, por performanca e tyre në provimet ballë për ballëshpesh tregonte rezultate më të ulëta.

Faktorët e jashtëm, si mjediset e ndryshme të provimeve online, janë një tjetër kufizim që ndikon në vlefshmërinë e rezultateve. Studentët që japin provime në ambiente të qeta shtëpiake mund të përfitojnë nga nivele më të ulëta stresi, duke çuar në performancë më të mirë. Nga ana tjetër, studentët në mjedise më të shpërqendruara ose me burime të kufizuara mund të përballen me sfida që ndikojnë negativisht në rezultatet e tyre. Siç argumentojnë Bulut dhe Beiting-Parrish (2024), këto pabarazi mjedisore mund të theksojnë pabarazitë ekzistuese në sistemet e vlerësimit të drejtuara nga IA.

Për të adresuar këto kufizime, hulumtimet e ardhshme duhet të përfshijnë kampione më të larmishme, të zhvillojnë algoritme më të avancuara për vlerësimin e aftësive komplekse dhe të sigurojnë bazat e të dhënave të trajnimit që reflektojnë larmi kulturore dhe gjuhësore. Për më tepër, qasjet hibride që ndërthurin teknologjinë IA me vlerësimet e mbikëqyrura nga mësuesit duhet të mbeten thelbësore për të siguruar drejtësi, saktësi dhe gjithëpërfshirje në procesin e vlerësimit të gjuhëve të huaja.

BIBLIOGRAFIA

- ALQAHTANI, S. (2021). The Role of AI in Language Learning: Opportunities and Challenges. *Journal of Educational Technology*, 45 (3), f. 123-134.
- BULUT, A., & BEITING-PARRISH, S. (2024). Revolutionizing Educational Assessment with AI: Challenges and Opportunities. *Educational Measurement Quarterly*, 32 (1), f. 45-67.
- CHANG, C., et al. (2020). AI-Assisted Learning in Hybrid Classrooms. *Journal of Technology in Education*, 18 (4), f. 234-256.
- CLARK, K., et al. (2021). AI and Bias in Educational Assessments. *Journal of Educational Research*, 29 (3), f. 125-143.
- Educational Futures, 15 (2), f. 89-104.
- Educational Leadership Journal, 19 (3), f. 56-78.
- GRIGORYAN, A., & KING, A. (2022). AI in Language Assessments: Enhancing or Replacing Traditional Methods? *Language Learning & Technology*, 26 (1), f. 54-72.
- JOHNSON, R., et al. (2023). AI and Hybrid Models in Education: Redefining Assessment. *Language Learning & Technology*, 25 (1), f. 1-20.
- LUCKIN, R. (2017). *Enhancing Learning and Teaching with AI*. Routledge.
- MEYER, J., et al. (2020). Hybrid Learning in the Post-COVID Era. *Education Futures*, 14 (2), f. 67-81.
- MILLER, T., et al. (2019). Ethical Challenges in AI-Driven Assessments. *Computers & Education*, 132, f. 142-154.
- RICHARDSON, C., & CLESHAM, R. (2021). *The Role of AI in Language Education*.
- SWIECKI, D., et al. (2022). *Hybrid Assessment Models in Post-COVID Education*.

STRUKTURA SINTAKSORE DHE PËRZGJEDHJA LEKSIKORE E GJUHËS SË GAZETAVE

Dr. Elda Katorri

Departamenti i Gjuhës Italiane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: elda.katorri@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Gjuha është një mjet i plotfuqishëm ligjërimit, e cila i bën jehonë mendimeve apo këndvështrimeve tona. Ajo ka lindur nga nevoja për të komunikuar dhe u shërben qëllimeve tona të jetës së përditshme, pra për ligj karakterin qëllimor të komunikimit, synimin e tij përfundimtar. Gjuhën, veçanërisht atë të shkruar, e përdorim për të përcjellë në mënyrë të vullnetshme dhe të qartë një mesazh, për të krijuar apo formësuar opinionin publik dhe për të ushtruar ndikim tek masat. Në punimin tonë mëtojmë të analizojmë, me anë të shembujve të marra nga gazetave të përditshme, se si gjuha e gazetave, sipas synimit komunikues që ka, përzgjedh përmbajtje dhe forma të caktuara sintaksore apo leksikore për të përmbushur qëllimin e vet. Jemi ndalur te gjuha e gazetave, atyre italiane dhe shqiptare si forma më e përhapur e komunikimit masiv të shkruar. Nga analiza jonë do të rezultojë se gjuha e gazetave shpalos një ndërthurje regjistrash, strukturash sintaksore dhe burimesh leksikore për të mburjtur tek lexuesi kumtin dhe ndikimin e dëshiruar.

Fjalë çelës: burime leksikore, gjuha e gazetave, stil emëror, struktura sintaksore.

ABSTRACT

Language is a powerful literary tool that echoes our thoughts or perspectives. It originated from the need to communicate and serves the goals of everyday life, thereby affirming the purposeful character of communication. We use language - especially written language - to transmit messages clearly and intentionally, to shape public opinion and to influence the masses. In this paper, we aim to analyze, through examples taken from daily newspapers, how the language of newspapers, depending on its communicative purpose, selects specific syntactic or lexical forms to achieve its goal. As the most widespread form of written mass communication, newspapers - both Italian and Albanian - are the focus of our study. Our analysis will demonstrate that newspaper language combines various registers, syntactic structures, and lexical resources to construct a targeted message and impact the reader.

Keywords: Newspaper language, syntactic structure, lexical resources, nominal style.

Hyrje

Falë aftësisë së shenjave për t'u bashkuar në njësi më të mëdha me gjatësi të ndryshueshme siç janë fjalitë, është praktikisht i pafund numri i mesazheve që mundëson cilado gjuhë. Pra, për domethënie të reja, përdoruesit kanë kurdoherë në dispozicion mjetin për të prodhuar mesazhe të reja. Prej kësaj rrjedh tipari i gjuhës si strukturë¹, term me prejardhje latine që vjen nga folja *struere* që do të thotë *ndërtoj*, *vë njëri mbi tjetrin*. Të flasësh një gjuhë nuk do të thotë të radhitësh fjali apo paragrafë, por të kërkosht të zotërosh mekanizmat sintaksore dhe strukturore që e përbëjnë atë pasi “*një rrëfim nuk është thjesht një tërësi frazash dhe konceptesh, por parakupton një marrëdhënie që realizon një shndërrim të përmbytjeve*”.² Pikërisht ngjyrimi i këtyre përmbytjeve, tëshfaqura me formë sintaksore apo leksikore të caktuar, përligjet nga qëllimi që gazeta ka, nga këndvështrimi i saj.

Metodologjia

Ky punim synon të paraqesë, me anë të metodës përshkruese/krahasuese dhe të shembujve konkretë, se si gjuha e gazetave, sipas synimit komunikues që ka, përzgjedh përmbytje dhe forma të caktuara sintaksore apo leksikore për të përmbushur qëllimin e vet. Analiza jonë mëton të përshkruajë se gjuha e gazetave shpalos një ndërthurje të qëllimshme regjistrash, strukturash sintaksore dhe burimesh leksikore për të ushtruar tek lexuesi ndikimin e dëshiruar. Shembujt e përdorur për të realizuar këtë punim janë vjelë nga një korpus i larmishëm i shtypit të shkruar italian dhe atij shqiptar. Ndër gazetat e marra në shqyrtim mund të radhisim: “*Corriere della Sera*”, “*la Repubblica*” “*il Giornale*”, “*Il Messaggero*”, “*Gazeta Shqiptare*” “*Shqip*”, “*Shqiptarja.com*”, “*Dita*”, “*Tirana Observer*” etj. si në versionin e printuar, ashtu edhe në versionin on-line, në harkun kohor 2010-2015.

¹ <http://www.treccani.it/vocabolario/struttura/>

² GOUTHIER, D. Ioli, E. (2007), *Fjalët e Ajnshtajnit. Gjuha e shkencës midis përpikërisë dhe poezisë*, Dituria, Tiranë, f. 208.

Gjuha si mjet komunikimi dhe influence

Në fillim ishte fjala! – thuhet në Bibël.³

Gjuha ka lindur për të komunikuar, ajo është një “mjet komunikimi” që i shërben qëllimeve tona të jetës së përditshme. Pra, gjuha për ligj karakterin qëllimor të komunikimit, synimin e tij përfundimtar. Ajo përdoret për të përcjellë në mënyrë të vullnetshme dhe të qartë një mesazh.

Po t’u referohemi alkimistëve, roli i fjalës na shfaqet i ngjashëm me formulat magjike që magjistaret përdorin për të ndikuar mbi ngjarjet dhe për të ndryshuar realitetin, - në rastin e tyre, për të shndërruar metalet në ar.⁴ Kësisoj, ligjërimi rezulton të jetë një mjet me peshë, i cili jo vetëm që përdoret për të përshkruar dhe për të kuptuar dukuritë njerëzore, por edhe për t’i ndryshuar ato. Një shembull tipik është ligjërimi i mediave.

Mediat janë vitrina gjuhësore në të cilën reflektohen dhe shpalosen të gjitha ngjarjet njerëzore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Aty, jo vetëm që përcillet e transmetohet informacion, por komunikohen edhe influenza, qëndrime, rreshtime, interesa. Dhe sigurisht, po të vazhdojmë me krahasimin e vitrinës, do të na duhet të pohojmë se ato nuk janë krejt të tejdukshme, të pastra. Çdo media, në varësi të interesave dhe synimit të saj përfundimtar, do të na shpalosë një mozaik ngjarjesh ku kompozimi i imazhit është krejt në dorën e tyre. Informacioni, influenza dhe propaganda, bashkëjetojnë në të njëjtën faqe gazete, madje edhe në të njëjtin titull.

☞ **“Se falliamo a Mosca è guerra”. Hollande e Merkel, ultime carte.**

Chance finali per la pace, ma la Cancelliera tedesca parla di esito incerto. Putin: vogliamo collaborare. E Berlusconi: l’Italia tace sulla follia di uno scontro con la Russia.

“Nëse dështojmë në Moskë, nis lufta.” Hollande dhe Merkel, kartat e fundit.

Shansi i fundit për paqe, por kancelarja gjermane flet për një rezultat të pasigurt. Putini: Ne duam të bashkëpunojmë. Dhe Berlusconi: Italia hesht lidhur me marrëzinë e një përleshje me Rusinë.

(il Giornale. it, 10. 2. 2015)

“Il Giornale”, gazetë e djathtë, mbështetëse e politikës së Berluskonit,

³ *Dhjata e Re*, (Gjoni 1:1-3)

⁴ GOUTHIER, D. Ioli, E., *vep. e cit.*, f. 18.

nuk ka si të mos e shprehë dhe qëndrimin e këtij të fundit. Berluskoni, një udhëheqës në opozitë, i dënuar për evazion fiskal, sjelljen e të cilit Evropa jo vetëm që e përbuzi, por edhe e kritikoi, nuk rreshtohet krah saj. Duke shprehur qëndrimin e tij, *Il Giornale* na kujton (mjaft kronika do të dëshmonin për këtë) miqësinë që lidh ish-kryeministrin italian me presidentin rus. Pra, përpos raportimit të qortimit të Berluskonit ndaj Italisë, si thënie që mbart informacion, shpaloset në mendjen e lexuesve edhe “imazhi” i raportit të influencave që orienton marrëdhëniet në kontekstin ndërkombëtar.

Informacioni se në krye të negociatave evropiane qëndron Merkel, nuk mund ta lërë indiferent lexuesin dhe ky të mos e kuptojë se sa e rëndësishme është Gjermania dhe se sa e pushtetshme është kancelarja e saj. Pra, nga njëra anë kemi boshtin Evropë - SHBA, ndërsa nga ana tjetër boshtin Rusi - të tjerë, satelitë të vegjël që i udhëheq orbita e interesave të veta, si Greqi, Serbi, etj., të cilët nuk do të ngurronin të gdhiheshin në njërën anë të aleancës e të ngryseshin në tjetrën.

Pra, të kuptuarit është një “sistem marrëdhëniesh” që nënkupton si përcjelljen e informacioneve, ashtu edhe atë të influencave. Se si janë këto raporte, varet krejtësisht nga gazeta, interesat e saj, përkatësia politike, kombëtare, etj. Në gjithë këtë proces gazetat luajnë një rol vendimtar duke e shumëfishuar dhe shpërndarë kontekstin e ngjarjeve dhe atë të thënieve në një rend të caktuar sintaksor, leksikor e stilistikor. Ajo që na mbetet ne në dorë, është të *përzgjedhim* se cilën apo cilat gazeta të lexojmë, për ta zgjeruar spektrin e informacionit dhe mbrujtjen semantike të realitetit rreth të cilit ato na bëjnë të mendojmë.

Sintaksa në artikujt e gazetave

*Fjalja është fragmenti i ligjërit i përbërë zakonisht prej dy a më shumë fjalësh kuptimplota të bashkuara sipas raportesh të caktuara, në bazë të ligjeve të një gjuhe, në një tërësi të vetme kuptimore, gramatikore e intonacionore*⁵ ndërsa sintaksa përcakton rendin e fjalëve brenda saj.

Ajo shquhet kryesisht për një stil emëror pasi radhitja e fjalëve në një artikull diktohet nga një sërë elementesh, siç janë: hapësira e kufizuar

⁵ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1997), *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, f. 60.

brenda faqes së gazetës si dhe dëshira për të lënë mbresat për të ndikuar tek lexuesi. Aty haset një përdorim i dendur i shenjave të pikësimit dhe i ligjëratës së drejtë. Sintaksa bashkë me tekstualitetin janë fushat ku evolucioni i shkrimit gazetaresk është qartësisht i dallueshëm. Leksiku gjithashtu, si elementi më elastik dhe i ndryshueshëm i gjuhës, kohët e fundit, me prurjet e neologjizmave dhe fjalëve të huaja po shfaq ndryshime të thella. Në përgjithësi, ligjërimi gazetaresk parapëlqen periudhat e shkurtra që shpesh përkojnë me një fjalë të vetme, të thjeshtë, njëkryegjymtyrëshe. Ky aspekt, përpos ndikimit që ushtron ligjërimi i folur dhe televizioni, lidhet edhe me nevojën që ka vetë ligjërimi gazetaresk për të qenë sa më i saktë e i kuptueshëm, me qëllim që ta përçojë informacionin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të thjeshtë.

Sintaksa e periudhës: bashkërenditja

Ndonëse një titull i mirë mund t'ia dalë të shesë një lajm të keq, edhe ky i fundit do shkruar mirë. Kjo gjë nënkupton faktin se krahas ligjërimin me fjalë të thjeshta, një tipar tjetër i gjuhës së gazetave është ligjërimi me periudha të bashkërenditura apo të nënrenditura, sidomos në tekstet argumentuese, ku filli logjik i argumenteve mbështetet në një rend kronologjik (i shprehur me lidhëza kohore), duke pasqyruar shkaqet dhe pasojat (të paraprirë nga lidhëzat *pse* dhe *sepse*) e ngjarjes apo tematikës së diskutuar. Nevojën e një ligjërimi të artikuluar, pra me periudha, e ndiejnë edhe sektorë të tjerë që trajtojnë çështje të ekonomisë apo teknologjisë për shembull. *Periudha është njësi e tërësishme e lidhur kuptimore, strukturore e intonacionore, e përbërë prej dy a më shumë njësisish kallëzuesore në formë fjali, në raporte të caktuara midis tyre.*⁶ *Kur këto janë raporte janë të vendosura midis dy a më shumë fjalish homogjene, të bashkuara me anë të lidhëzave bashkërenditëse, atëherë edhe periudha quhet periudhë me bashkërenditje.*⁷

Me anë të shembujve të mëposhtëm, do të shohim se bashkërenditja, në përputhje me thjeshtimin e përgjithshëm dhe me ndikimin që luan gjuha e folur, e cila *parapëlqen pranëvënien ose ndajshkrimin* në vend të pasqyrimin në rend logjik, ka një peshë të madhe në strukturimin e

⁶ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1997), *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Tiranë, f. 61.

⁷ Po aty, f. 463.

periudhës. Rastet më tipike të bashkërenditjes janë ato që formohen me anë të lidhëzave, semantike (këpujoret, *e, dhe*; kundërshtorja *por*; etj.) apo sintaksore qofshin ato. Në mungesë të lidhëzave, “lidhja” bashkërenditëse u besohet elementëve të tjerë gjuhësorë siç janë shenjat e pikësimit (lidhje asindetike), ku peshën kryesore e luan ndarja me *presje*. Kjo e fundit i përshtatet shumë mirë enumeracionit të formave të pashtjelluara të foljeve siç është pjesorja apo përcjellorja⁸, të cilat përpos afrisë me foljen shfaqin përkatësisht tipare të mbiemrit dhe të ndajfoljes.

☞ *Tokyo – Alle 23. 32 di ieri sera (le 16. 32 in Italia) una scossa di magnitudo 7. 4 della scala Richter ha riportato indietro l’orologio a quel pomeriggio di un mese fa e la parte orientale del paese è ripiombata nella paura. Epicentro a 40 chilometri di profondità nell’Oceano Pacifico, al largo delle coste già rase al suolo di Sendai, Minamisoma, Ofunato, Kesennuma, Fukushima, Onagawa. [...] Nessuno ieri si è sentito al sicuro nella fascia est del Paese fra Mito (poco più a nord di Tokyo) e Hachinohe (a sud di Aomori) nemmeno dopo che l’allarme tsunami è cessato.*

Tokio - Në orën 23:32 ditës së djeshme (ora 16:32 në Itali) një tërmet të magnitudë 7. 4 të shkallës Rihter e ktheu orën prapa në atë pasdite të një muaji më parë dhe pjesën lindore të vendit e kaploi sërish frika. Epiqendra 40 kilometra në thellësi të Oqeanit Paqësor, në brigjet tashmë të rrafshuara të Sendait, Minamisomas, Ofunatos, Kesenumas, Fukushimaes, Onagauës. [...] Askush nuk është ndjerë dje i sigurt në bregun lindor të Vendit në mes të Mitos (pak më tutje se në veri të Tokios) dhe Hachinohes (në jug të Aomorit), edhe pasi gjendja e alarmit kishte mbaruar. (“Corriere della Sera”, 8. 4. 2011, f. 21.)

☞ Vjedhja

Pronari i pikës së basteve sportive kishte bërë denoncim në policinë e Elbasanit për vjedhjen me thyerje të subjektit të tij. Sipas tij, dy personat u kishin vjedhur kompjuter, televizorë, printer e objekte të tjera dhe sipas tyre mosmarrja e masave nga policia, ka bërë që ata të kalojnë në vetëgjyqësi.

[...] Ato janë mbajtur me forcë për orë të tëra, duke i rrahur, goditur,

⁸ Shih: ÇELIKU, M. (2006), *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Shblu, Tiranë.

çarë. [...]Menjëherë policia ka nisur hetimet, por pa mundur të gjejë autorët.

☞ *Në fakt ngjarja është paksa e çuditshme dhe përfaqësuesi i Akuzës nuk ka pasur asnjë mundësi ta parandalojë. (“Shqiptarja. com”, 14. 3. 2013, f. 20)*

☞ *Konkretisht pronari i ri i Shtëpisë së Ushtrisë do të jetë ministri i brendshëm, Flamur Noka.*

☞ *Burim Jusufi, shqiptari i cili ka lindur në Zvicër e që po ndërton karrierë si balerin në SHBA, ka treguar ndjesinë e të kërcyerit me këngëtareshen e famshme Rihanna.*

☞ *Ylli shqiptar me famë botërore, Rita Ora ka shprehur preferencën e saj sa i përket basketbollit kosovar. (“Gazeta Shqiptare”, 21. 8. 2013, f. 16)*

☞ Qetsori dhe Anjeza, duke diskutuar për bindjet e tyre politike, kujtojnë Eltonin. (“Shqip”, 5. 5. 2009, f. 27)

Siç mund ta vini re në shembujt e mësipërm, një tjetër element i rëndësishëm sintaksor janë fjalitë e ndërkallura⁹, të futura mes kllapash apo të vëna mes presjesh a vizash. Me anë të këtyre fjalive, gazetari ka mundësi të shtojë edhe disa të dhëna të tjera apo vëzhgime sqaruese për ngjarjen apo ndodhitë e sapopërshekruara, të cilat, paçka se nuk konsiderohen thelbësore, shërbejnë për ta plotësuar dhe saktësuar më tej informacionin e ofruar dhe për ta lehtësuar disa vargun sintaksor.

Sintaksa e periudhës: nënrenditja

Që një artikull të jetë shterues sa i përket dhënies së informacionit, gjatë shtjellimit të vet ai duhet t’u përgjigjet pesë pyetjeve që qëndrojnë në themel të aksiomës së gazetarisë.¹⁰ Ato janë:

- ▶ *Kush? (Autorët e përfshirë në ngjarje)*
- ▶ *Çfarë? (Ndodhia, ngjarja në vetvete)*
- ▶ *Kur? (Kohën kur ajo ka ngjarë apo po zhvillohet)*
- ▶ *Ku? (Vendin e ndodhjes së ngjarjes)*
- ▶ *Pse? (Arsyet apo shkaqet që nxitën apo shkaktuan ngjarjen)*

⁹ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1997), *Gramatika e gjuhës shqipe, II*, Tiranë, f. 651-658.

¹⁰ *Kjo është aksioma e mirënjohur e gazetarisë anglosaksone e quajtur aksioma e 5 W-ve: Who? What? When? Where? Why?*

Vetë raportet sintaksore që vendosin elementet gjuhësore me të cilat është e mbryjtur semantikisht përgjigjja, janë raporte varësie që mund të shprehin kohë, vend ose shkak, madje shpeshherë ato janë të gërshetuara. Megjithatë mund të ketë bashkërenditje edhe midis fjalive të nënrenditura që varen nga e njëjta fjali kryesore. Ligjërata e zhdrejtë, e cila zë pjesën më të madhe të teksteve, atyre argumentuese, përshkruese, por jo vetëm, nënkupton një frazë më të gjatë, më të artikuluar. Zakonisht këtë gjë e mundëson periudha me nënrenditje. Ajo shfaq larmi më të madhe raportesh sintaksore.

*Periudha me nënrenditje është tërësia sintaksore e ndërlidhur organikisht për nga ana kuptimore e gramatikore, e përbërë së paku prej dy njësisish kallëzuesore në formë fjalie, me raporte nënrenditjeje vartësie, midis tyre. Njësia që shërben si bazë organizuese e periudhës quhet fjali kryesore, ndërsa ajo që e plotëson, e sqaron atë, që është e varur gramatikisht prej saj, quhet fjali e nënrenditur ose fjali e varur.*¹¹

Analiza e llojit të fjalive të nënrenditura shfaq tipare të përbashkëta me gjuhën e sotme të shkruar të zhanreve të ndryshme, ku vihet re një përdorim i madh i fjalive të nënrenditura lidhëzore¹², që ndiqen nga fjalitë kundrinore, kohore, shkakore dhe qëllimore. Më të rralla fjalitë e nënrenditura kryefjalore, kushtore, krahasuese, lejore dhe mënyrore.

Për të sqaruar atë çka thamë më sipër le të ndalemi në disa shembuj ku marrëdhëniet e varësisë që fjalitë e nënrenditura shënojnë me fjalinë kryesore paraprihen kryesisht nga lidhëzat: *che/që*, *se*¹³, *perché/pse*, *sepse*, *siccome/duke qenë se*, *affinché/me qëllim që*, *da/sa*, *saqë*, *tuttavia/gjithsesi*, *pavarësisht*, *a cusa di/ për shkak se*, *per il fatto che/për faktin se etj.* duke na dhënë:

► *fjali të nënrenditura me funksion kryefjalor*

☞ *Con chiarezza, però, si riconosce che «il nuovo contributo non è certamente in grado di far fronte alla situazione critica».* (“Corriere della Sera”, 1. 9. 2012, f. 29)

¹¹ Shih: Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1997), *Gramatika e gjuhës shqipe, II*, Tiranë, f. 479.

¹² BONOMI, I. (2002), *L'italiano giornalistico. Dall'inizio del '900 ai quotidiani on line*, Cesati, Firenze, f. 148.

¹³ Lidhëzat ftilluese **që/se** janë lidhëzat më me shumë funksione të shqipes dhe shërbejnë për të lidhur fjalinë drejtuese me fjalitë e nënrenditura kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore apo përcaktore.

- ☞ [...] nuk është e nevojshme që të hapen dosjet e Enverit[...]. Për këtë masë, hartuesit mësohet se do t'i propozojnë Kuvendit që për këtë kategori, karriera e tyre duhet të mbyllet në përfundim të mandatit të tyre institucional, ku këta persona propozohet që të mos kenë më të drejtë rikandidimi. (“Shqip”, 27. 11. 2014, f. 4)
- ☞ Duket se zhvillimet ekonomike në zonën Euro po marrin një drejtim pozitiv. (“Dita”, 19. 8. 2013, f. 17)
- ▶ fjali të nënrenditura me funksion kundrinor
- ☞ C’era il sacerdote, don Pasquale Tiriolo, che nell’omelia ha ricordato che «Federico aveva una personalità di grande umanità». (“La Gazzetta del Mezzogiorno”, 3. 3. 2015, f. 19)
- ☞ Por, pak orë më vonë, sërish në “Facebook” do të shtonte gjithashtu se ai është pro edhe hapjes së dosjeve të komunizmit, teksa akuzoi Ramën se gjithë këtë zhurmë po e bën për të mbuluar skandalet e korrupsionit të qeverisë së tij. [...] Sa i përket lustracionit, hartuesit e projektligjit theksojnë se dosjet kanë një procedurë të caktuar [...] ka theksuar se, rritja e Eurozonës do të udhëhiqet kryesisht nga zgjerimi i kërkesës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe nga ekonomitë në zhvillim. (“Shqip”, 27. 11. 2014, f. 4)
- ☞ Mendoj se përfshirja shpirtërore duhet mbrojtur e ruajtur nga kushdo. (“Tirana Observer”, 12. 10. 2012, f. 9)
- ▶ fjali të nënrenditura me funksion përcaktor
- ☞ [...] s’era schiantato sull’autostrada che conosceva meglio [...].
- ☞ Con Bisceglia c’era una donna che è rimasta ferita ed è stata ricoverata nell’ospedale di Cosenza.
- ☞ [...] ha ormai creato uno “Stato” alternativo che vede tra gli introiti più remunerativi proprio la gestione dei rifiuti [...]. (“La Gazzetta del Mezzogiorno”, 3. 3. 2015, f. 19)
- ☞ Dhe i vetmi ndëshkim që do të ndërmerret, ka të bëjë me ndërprerjen e karrierës të të gjithë atyre që kanë kontribuar në sigurimin e shtetit në kohën e diktaturës[...]. (“Shqip”, 27. 11. 2014, f. 4)
- ☞ Pse nuk i venë flakën vetes këto “Pul’itikanët” e kësaj Shqipërie, trimat e moralit që u vjen era parfum “Channell” e “Armani” të blerë me lekët e këtyre të gJORËVE, [...] rrjepacakëve që dinë se çfarë është

“ideali”. (“*Tirana Observer*”, 12. 10. 2012, f. 9)

► *ffjali të nënrenditura me funksion shkakor*

↪ *Perché quei due proiettili non sono uno scherzo, sono una promessa: «Non ci dimenticheremo di voi» (“il Giornale”, 25. 2. 2015, f. 3)*

↪ *E lui si è sbizzarrito: «Salvini non può guidare il centro destra perché la Lega ha una vocazione minoritaria, quella maggioritaria come la voglio io non esiste»[...] (“il Giornale”, 25. 2. 2015, f. 3)*

↪ *Diversi agenti sono stati mobilitati per cercare di identificare i «piloti dei piccoli velivoli a terra, dato che per il tipo di apparecchio non potevano essere troppo lontani, ma invano. (“il Giornale”, 25. 2. 2015, f. 19)*

↪ *[...] soldati di Salò erano colpevoli di tradimento per aver collaborato in armi «con il tedesco invasore». (“il Giornale”, 25. 2. 2015, f. 28)*

↪ *[...] ieri a Milano gli assessori Daniele Stival e Marino Finozzi l’hanno difeso strenuamente – dal momento che il segretario non è più in grado di garantire candidature e quant’altro. (“Il Gazzettino”, 3. 3. 2015, f. 4)*

☞ *[...] Je nuk u afrohen, se u vjen era “Sterrc” këtyre rrjepacakëve[...]]. (“Tirana Observer”, 12. 10. 2012, f. 9)*

☞ *Kjo ditëlindje është përshëndetur nga Kryeministri Sali Berisha përmes një videoje, për shkak se ai dje gjendej në Strasburg. (“Gazeta Shqiptare”, 9. 10. 2012, f. 19)*

☞ *Ata u zunë në befasi për faktin se BK i themeluar 3-4 javë më parë në mes të muajit nëntor 1942 nuk kishte shkrehur asnjë pushkë kundër okupatorit fashist italian. (“Gazeta Shqiptare”, 9. 10. 2012, f. 16)*

☞ *Unë besoj se për shkak të kërcënimit në rritje nga jashtë, kemi nevojë për ndihmën e Shërbimit Informativ Federal. (“Dita”, 26. 8. 2014, 5)*

► *ffjali të nënrenditura me funksion qëllimor*

↪ *Va detto che l’Europa da molti anni martella l’Italia perché faccia di più a favore dei Rom. (“il Giornale”, 25. 2. 2015, f. 2)*

↪ *[...] dalle indagini sono emersi elementi nuovi e importanti sui presunti pagamenti delle ragazze da parte dell’ex premier affinchè tacessero sulle serate hard ad Arcore, e la modella è la persona in grado di chiudere il cerchio. (“Il Messaggero”, 3. 3. 2015, f. 11)*

☞ *Aleksej Navalnyj, non ha ottenuto il permesso per uscire di carcere per poche ore al fine di dire addio al compagno di tante battaglie. (“Il Messaggero”, 3. 3. 2015, f. 13)*

☞ *[...] ecco, questa secondo me è la cosa più importante da fare. (“Il Messaggero”, 3. 3. 2015, f. 8)*

☞ *Kemi votuar demokracinë natyrisht edhe për t’u shpërblyer financiarisht të përsekuatuarit [...]. Po luftornë për të marrë lekët. (“Tirana Observer”, 12. 10. 2012, f. 9)*

☞ *Me qëllim që Karta të marrë atributet e një dokumenti të respektueshëm nga palët, ato angazhohen të llobojnë për adaptimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë.*

☞ *Majko ftoi të gjithë të pranishmit, shoqërinë civile që të bëheshin pjesë e kësaj nisme. (“Sot”, 23. 10. 2014, f. 5)*

☞ *Ministri u bëri thirrje të gjithë ish të burgosurve politik që jetojnë, të paraqesin pranë Ministrisë së Financave certifikatën e lindjes dhe një llogari bankare aktive, në mënyrë që fondi prej 15 milion dollarësh i caktuar për ta sipas ligjit të ri, të shlyhet brenda këtij viti. (“Sot”, 23. 10. 2014, f. 12)*

► *fjali të nënrenditura me funksion leJOR*

☞ *Tuttavia, la spietatezza con cui era avvenuto l’omicidio riecheggiava tragicamente i delitti della banda della Magliana. (“Corriere della Sera”, 4. 4. 2011, f. 19)*

☞ *Benché diversi, questi eventi ebbero l’effetto di aumentare considerevolmente l’intervento statale nella vita economica. (“Corriere della Sera”, 9. 4. 2011, f. 17)*

☞ *[...] yield-i i bonove të thesarit me afat maturimi 12 mujor vijoi uljen, pavarësisht se bankat vijojnë të kërkojnë interesa më të larta. (“Sot”, 16. 11. 2013, f. 11)*

☞ *Edhe pse luan në kampionatin shqiptar, kjo nuk e pengon portierin Orges Shehi të ftohet në Kombëtare e madje të krijojë besim që të aktivizohet për një 45 minutësh në ndeshjet e kuqezinjve. (“Sot”, 16. 11. 2013, f. 22)*

► *fjali të nënrenditura me funksion rrjedhimor*

☞ *Una lunga lotta contro i «veleni» della camorra e una morte tanto*

- «strana» da far storcere il naso a più d'uno[...]. (‘‘La Gazzetta del Mezzogiorno’’, 3. 3. 2015, f. 19)
- ↪ Allora dove si nasconde il peccato di Nemtsov, talmente grave da doverlo scontare con la morte? (‘‘Il Messaggero’’, 3. 3. 2015, f. 22)
- ☞ Debati ishte aq i ndezur sa që deputeti i PD-së, Luan Skuqi u shpreh se ‘‘kështu unë dua të votoj kandidatët në kundërshtim me ligjin’’. (‘‘Shqip’’, 2. 10. 2012, f. 4)
- ☞ Por, largësia e brendshme mendore e shpirtërore ishte e tillë sa që çoi në krijimin e paradoksit që përmendët ju. (‘‘Shqip’’, 2. 10. 2012, f. 18)
- ▶ fjalë të nënrenditura me funksion kohor
- ↪ E in passato si era fatto anche riprendere dalle telecamere mentre sottoponeva un candidato alle domande più strane, [...] Mentre, inevitabilmente, avanza Internet: quasi tutte le imprese accettano domande via web. (‘‘Corriere della Sera’’, 10. 7. 2011, f. 20)
- ☞ Policia e Vlores bllokoi 38 klandestinë afrikanë, të cilët kishin hyrë nga Greqia në Shqipëri dhe po tentonin Malin e Zi. Kapja e tyre u bë në aksin nacional në afërsi të Vlorës, ndërkohë që u vërejt se shumë nga ata ishin të sëmurë. Sakaq, policia shoqëroi si të dyshuar për trafikimin e personave, M. S., 61 vjeç dhe L. B., 43 vjeç, si dhe janë sekuestruar 2 automjete tip furgona me targa [...]. (‘‘Sot’’, 13. 8. 2014, f. 12)
- ▶ fjalë të nënrenditura me funksion kushtor
- ↪ Quando il futuro di un patto di governo diventa incerto, i freni inibitori dei soci tendono ad allentarsi. (‘‘Corriere della Sera’’, 10. 7. 2011, f. 1)
- ↪ Se fosse davvero liberista avrebbe lasciato al mercato il compito di decidere chi debba essere domani il proprietario di Parmalat. (‘‘Corriere della Sera’’, 9. 4. 2011, f. 17)
- ☞ [...] çdo njeri mund të kërkojë të shikojë vetëm dosjen e tij, nëse ai ka një të tillë [...]. Sa u përket dosjeve të personave publikë, ato do të kenë një tjetër qasje në rast se miratohet ky projektligj. (‘‘Shqip’’, 27. 11. 2014, f. 4)

Siç vihet re në shembujt e mësipërm, në ligjërimin e gazetave, qofshin ato italiane apo shqiptare, ndër format e shtjelluara të foljes kryeson

mënyra dëftore dhe lidhore. Nuk mungon as mënyra kushtore apo ajo habitore ku kjo e fundit haset më shpesh në pyetjet retorike që i bëjnë jehonë tonit ironik të fjalisë. Lidhëzat *që* dhe *se* i paraprijnë më së shumti *të tashmes, të kryerës, të pakryerës dhe të ardhmes së dëftores dhe të tashmes e të shkuarës së lidhores*. Lidhëzat qëllimore *me qëllim që, për arsye se, që*, i paraprijnë të tashmes së lidhores. Megjithatë, fjalitë e nënrenditura qëllimore shpesh parapëlqejnë ndërtime sintaksore të përfutuara nga format e pashtjelluara të foljes si *pjesorja* apo *përcjellorja*. Fjalitë e nënrenditura kohore, parapëlqejnë *kohën e pakryer të dëftores*; fjalitë e nënrenditura rrjedhimore rrjedhin nga formimet paraafjalore të *formës së pashtjelluar paskajore*; fjalitë e nënrenditura kushtore në hipoteza të realizueshme parapëlqejnë të tashmen apo të ardhmen e dëftores ndërsa për hipotezat e perealizueshme u lipset gërshetimi i kushtores me lidhoren; fjalitë e nënrenditura lejore i lejojnë si ndërtimet me dëftore ashtu edhe ato me lidhore.

Leksiku

Përsa i përket leksikut që përdor gjuha e gazetave është vënë re se ai tenton t'i ngjajë më shumë gjuhës së përditshme ku jo vetëm janë reduktuar termat letrare dhe burokratike, por është rritur edhe numri i fjalëve të ligjërimin joformal, atij të përditshëm. Ky lloj ligjërimi në njërin anë i përgjigjet dëshirës për t'u afruar më tepër me lexuesin, duke imituar gjuhën e përditshme, joformale, nga ana tjetër i jep ngjyrimet konotative artikullit. Këtë regjistër e hasim më shpesh në artikujt që lidhen me politikën, me kronikën e përditshme, aktualitetin, sportin etj., jo vetëm në përdorimin e ligjëratës së drejtë, por edhe në rrëfimin në vetë të tretë që bën vetë gazetari. Kjo kategori përfshin fjalë, emra, mbiemra, folje, shprehje dhe fraza të gjuhës së folur dhe të folurës vulgare, si: *fuori dai piedi (hiqmu sysh), balla (broçkull) stronzo (t.. p), incazzarsi (të nxehesh), merda (m. t)etj.*

✍ *C'e' scritto "cari Bersani ed elettori del Pd, vi volevo salutare e dire a tutti di andare a vaffa... piduisti.... falliti".*

(Është shkruar "të dashur Bersani dhe zgjedhës të Pd-së, desha t'ju përshëndes dhe t'ju thoja p... pëdëistë... të dështuar") ("Corriere della Sera", 2. 9. 2012, f. 1)

☞ *Kushti dhe pushti* (“Dita”, 23. 12. 2014, f. 1-2)

☞ *Të dhjerë por krenarë!* (“Dita”, 30. 6. 2013, f. 1)

Mbetet domethënëse kategoria e *neologjizmave*, të cilat jo vetëm që reflektojnë tematikat dhe përmbajtjet e reja që përcjellin faqet e gazetave, por janë edhe tregues për llojin e fjalëformimeve më produktive.

Në italisht, në kuadër të fjalëformimit me parashtesim më tipike janë parashtesat: *anti-*(antiscafista, anticonformista / antifashist, antikonformist), *co-*(cofinanziamento / bashkëfinancim), *contro-*(controindagine / kundërhetim), *de-/dis* (deburokratizzazione, dissalazione / çburokratizim/çkripëzim), *mega-* (meganegozio/ megadyqan), *mini-* (minibomba / minibombë), *tele-* (teledivo / telediv, telecomando / telekomandë), *super-* (superpagato/i superpaguar), *iper-* (ipermercato / hipermerkatë), *ultra* (ultramoderno / ultramodern).

Sa i përket prapashtesimit mund të përmendim emrat që mbarojnë me: *-ismo* (europessimismo / europesimizëm), (frazionismo / fraksionizëm), *-ista* (idealista/idealist, giuslavorista / ekspert i së drejtës së punës), *-istica* (effettistica / efektist¹⁴), *-izzazione* (ottimizzazione/optimizim), foljet që mbarojnë me: *-are* (stoppare / stopoj), *-izzare* (ottimizzare / optimizoj); mbiemrat me: *-ale* (digitale / dixhital), *-ano* (morettiano/moretian), *-ese* (benignese / beninjist), *-abile* (scannerizzabile/i skanueshëm), *-ico* (massmediatico /masmediatik).

Të shpeshta janë edhe kompozitat, si: *teatronovela* (teatro-novelë), *ripara-cellule* (riparues qelizash), etj.

Për t’u përmendur janë edhe neologjizmat e ligjërimit politik: *girotondini*/(rretheqarkas, protestues që rrethojnë institucionet për të kërkuar të drejtat e veta), *scudo fiscale* (mburojë fiskale) etj.

Edhe në shqip, ashtu si në italisht, veprojnë po ato mekanizma fjalëformues. Ndajshitesat fjalëformuese, parashtesat dhe prapashtesat, në varësi të krijimtarisë individuale dhe krejt rastësore (sipas ngjarjes së ndodhur) ngjizin fjalë të reja, të papërdorura më parë. Disa nga këto neologjizmat kanë jetë të gjatë në ligjërimin gazetaresk, ndërsa të tjerë janë jetëshkurtër ose dalin jashtë përdorimit me t’u zhdukur fenomeni që i ka gjeneruar, p.sh.: *nanoist* (reduktuar bashkë me praninë e Nanos në jetën politike të vendit) dhe “*anti-Rilindje*” (“*Shqip*”, 8. 5. 2015. f. 1), *berishizmi* (“Dita”, 26. 6. 2013, f. 1) *çilizmi* (“Dita”, 16. 6. 2013, f. 1) etj.

¹⁴ I referohet atij që merret me efektet zanore të tingujve të kitarës.

Fjalët përcaktuese të rrymave ideopolitike, që përbëjnë edhe bërthamën dalluese të tyre, si:

► Leksiku i strukturës dhe i rendeve shoqërore ekonomike.

☞ **CEZ refuzohet të investojë 100 mln euro**

ERE rrëzon planin e çekëve për të marrë kredi nga IFC dhe BERZH. Pritet vendimi për licencën (“Shqip”, 17. 10. 2012, f. 10)

☞ **Huaja për KESH, borxhi publik arrin 60, 5% të PBB** (“Shqip”, 17. 10. 2012, f. 10)

► Leksiku i fushatave elektorale dhe i jetës politike parlamentare.

☞ **Shulz: zgjedhjet 2013, janë kusht për statusin**

“Situata politike është përmirësuar” (“Gazeta Shqiptare”, 09. 10. 2018, f. 5)

☞ **Ambasadori i BE apel politikës: Realizoni reformat**

Përgjigjja për statusin, Sequi: Të mos përdoret për fushatë (“Gazeta Shqiptare”, 09. 10. 2018, f. 5)

☞ **Berisha bojkoton votimin, premton betejë** (“Shekulli”, 16. 09. 2013, f. 11)

► Fjalët për luftën shoqërore e politike.

☞ *“Mbërritja e Enver Hoxhës në sallën e Konferencës [...] “inkursioni” i Enverit [...] që atakonin drejtpërdrejt rolin e Partisë e të udhëheqjes, kreu I regjimit është paraqitur në “sheshin e betejës” me një strategji të mirëmennduar [...] “gangsterëve që tronditën Komitetin Qendror [...]”* (“Panorama”, 09. 09. 2013, f. 18)

► Leksiku për dukuritë shoqërore-politike.

☞ **Berishizmi** (“Dita”, 21. 06. 2013, f. 1)

☞ **Pluralizmi, “shkrirja me turmën” [...]** (“Dita”, 26. 11. 2014, f. 1)

□ Leksiku nga fushat e tjera që futen në përdorim politik.

☞ **Kushti dhe pushti**

Shumica nuk mund t’i përdorë 84 votat në Kuvend, pa pëlqimin e PD-së... (!)

[...] Ndërsa PD është në kaos dhe deputetët kërcënojnë Bashën me dalje nga rreshti, për Berishën rrëmuja është gjendja e tij ideale: Dhe kërkon pushtetin në tavolinë. Çfarë do të ndodhë sot në PD? Çfarë do të bëjnë nesër deputetët? (“Dita”, 23. 12. 2014, f. 1)

Edhe fjalët e huaja kanë qenë gjithmonë një kategori e privilegjuar e leksikut të gazetave, duke pushtuar çdo sektor të saj kryesisht në artikujt e kronikës së politikës së brendshme (*convention* - konventë, *bipartisan* - dypartiake) dhe asaj të jashtme (*intelligence* - inteligjencë, *peace enforcing* - të zbatimit të paqes), ekonomisë (*deficit*), spektaklit (*audience*, /*audiencë*) dhe aktualitetit. Përsa i përket burimit të tyre, sot në gjuhën italiane kryesojnë angloamerikanizmat që i hasim kryesisht në terminologjinë politike dhe në fushën teknike, ndërsa francezizmat janë të përhapura kryesisht në sektorin që lidhen me shfaqjet dhe spektaklin. Në gjuhën shqipe, përpos anglicizmave që kanë “pushtuar” leksikun ndërkombëtar, italianizmat janë burimi tjetër kryesor i huazimeve.

Përfundime

Gjuha është mjeti kryesor që na mundëson komunikimin, i cili nuk është kurrë një shfaqje neutrale, por nënkupton një tejçim domethëniesh të mbrytura fort kulturalisht, çka ndikon edhe në aspektin e identitetit të vetë njeriut. Ajo përcakton vizionin që një shoqëri ka për botën dhe pozicionin e subjekteve gjuhësore ndryshon në varësi të gjuhës së përdorur pasi ajo është njëherësh mjet komunikimi dhe influence. Nga ana tjetër gazeta është një kronikë e pareshtur e veprimtarisë njerëzore, një vitrinë e ligjërimit të shkruar ku flitet për sektorë të ndryshëm, si: ekonomia, shkenca, politika, sporti, mjekësia, rendi etj. që i drejtohet një publiku masiv të cilin e informon, e edukon dhe e ndikon me anë të gjuhës, me anë të përzgjedhjes së strukturave sintaksore, fushave leksikore apo stileve ligjërimore. Në ligjërimin e gazetave, qofshin ato italiane apo shqiptare, ndër format e shtjelluara të foljes kryeson mënyra dëftore dhe lidhore. Nuk mungon as mënyra kushtore apo ajo habitore ku kjo e fundit haset më shpesh në pyetjet retorike që i bëjnë jehonë tonit ironik të fjalisë. Spikat stili emëror i titujve. Sa i përket leksikut të saj, ai i ngjason më tepër atij të gjuhës së përditshme, ligjërimit joformal, i cili i përgjigjet dëshirës për t’u afruar më tepër me lexuesin. Këtë regjistër e hasim më shpesh në artikujt që lidhen me politikën, me kronikën e përditshme, aktualitetin, sportin etj., jo vetëm në përdorimin e ligjëratës së drejtë, por edhe në rrëfimin në vetë të tretë që bën vetë gazetari.

BIBLIOGRAFIA DHE SITOGRAFIA

Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1997), *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Tiranë.

ÇELIKU, M. (2006), *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Shblu, Tiranë.

CIRILLO, S. Neri, G. (2009), *Dal nostro inviato. 50 anni di giornalismo italiano*, Bulzoni editore, Roma.

D'ACHILLE, P. (1990), *Sintassi del parlato e tradizione scritta della lingua italiana. Analisi di testi dalle Origini al secolo XVIII*, Roma, Bonacci.

D'ACHILLE, P. (2003), *L'italiano contemporaneo*, Il Mulino, Bologna.

DARDANO, M. (1973), *Il linguaggio dei giornali italiani*, Laterza, Roma-Bari.

DARDANO, M. (2002), *La lingua dei media*, in Valerio Castronovo e Nicola Tranfaglia, *La stampa italiana nell'età della TV. Dagli anni settanta ad oggi*, Laterza, Roma-Bari, fq. 245-285.

DIBRA, K. VARFI, N. (2005), *Gjuhësi teksti*, Shblu, Tiranë, f. 31.

GOUTHIER, D. IOLI, E., GOUTHIER, D. IOLI, E. (2007), *Fjalët e Ajnshtajnit. Gjuha e shkencës midis përpikërisë dhe poezisë*, Dituria, Tiranë.

<http://shqiptarja.com/home.php>

<http://www.gazetadita.al/>

<http://www.panorama.com.al/>

<http://www.panorama.com.al/>

<http://gazeta-shqip.com/lajme/>

<https://www.tiranaobserver.al/>

<http://www.corriere.it/>

<http://www.repubblica.it/>

<http://www.ilgiornale.it/>

<http://www.ilmessaggero.it/>

<http://www.lastampa.it/>

“KRIM DHE NDËSHKIM” NËN DRITËHIJET E SKICAVE DHE SHËNIMEVE NË DORËSHKRIMET E DOSTOJEVSKIT

Doktorante Elvira Xhamani

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike

Dega e Gjuhës Ruse

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: elvira.xhamani@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE:

Artikulli i kushtohet analizës së skicave dhe shënimeve kaligrafike në dorëshkrimet e F. M. Dostojevskit, gjatë periudhës së krijimit të romanit “Krim dhe Ndëshkim”. Këtu do të trajtojmë vizatimet dhe shënimet origjinale të Dostojevskit nga ditarët dhe draftet e tij: skica, portrete, fjalë dhe shkronja të dedukuara veçmas. Shënimet kaligrafike, të bëra nga shkrimtari gjatë punës me veprën, regjistrojnë emra, koncepte dhe ngjarje të reja që mungojnë në tekstet e shtypura të Dostojevskit dhe janë burime të rëndësishme informacioni për historinë e krijimit të veprave të tij. Në dorëshkrime do të vërejmë se nuk është rastësi që ilustrimet, skicat dhe shënimet kaligrafike bashkëjetojnë me veprat letrare. Çdo detaj flet për shkrimin e veçantë të autorit, jo vetëm si shkrimtar, por edhe si artist. Grafika e shtyn atë në reflektime të gjera mbi personazhet, krijimtarinë, jetën dhe vdekjen e tij. Të gjitha, sa më sipër, na lejojnë të konkludojmë se grafika (skicimi) për F. M. Dostojevskin është një mjet ndihmës dhe, ndonjëherë, kryesor për realizimin e imazhit. Ndërsa shënimet specifike të përdorura prej tij luajnë një rol të rëndësishëm, për të kuptuar sa më drejtë natyrën e personazheve dhe gjendjen e përgjithshme të veprës. Për këtë arsye, botuesit dhe përkthyesit e teksteve të Dostojevskit në gjuhën shqipe, duhet t’u kushtojnë vëmendje shënimeve të tij ideografike që gjenden në dorëshkrimet për romanin “Krim dhe Ndëshkim”.

Fjalët çelës: F. M. Dostojevski, “Krim dhe Ndëshkim”, skicat, kaligrafia, funksioni

ABSTRACT

The article analyzes the sketches and calligraphic notes found in the manuscripts of F. M. Dostoevsky, during the creation of the novel “Crime and Punishment”. It examines Dostoevsky’s original drawings and annotations from his diaries and drafts - sketches, portraits, isolated words and individual letters. The calligraphic notes, made by the author while working on the novel, record new names, concepts and events that are absent in the printed texts and serve as valuable sources of information for the history of his works. In the manuscripts we will notice that the coexistence of illustrations, sketches and calligraphic elements within the manuscripts is not accidental. Every detail reflects Dostoevsky’s distinctive style, not only as a writer, but also as an artist.

Graphics inspire broad reflections on his characters, creativity, life and death. All this leads to the conclusion that for F. M. Dostoevsky, graphic sketching served as both a supplementary and, sometimes, as a central tool for the realization of the image. While his specific notes play an important role in understanding the nature of the characters and the broader context of the novel as accurately as possible. For this reason, publishers and translators of Dostoevsky's texts in the Albanian language should pay attention to his ideographic elements found in the "Crime and Punishment" manuscripts.

Keywords: F. M. Dostoevsky "Crime and Punishment", sketches, calligraphy, function

Hyrje

Fjodor Mihailloviç Dostojevski fliste rrallë për vizatimet e tij dhe nuk na la asnjë provë të drejtpërdrejtë me shkrim të ekzistencës së tyre. Shkrimtarit nuk i pëlqente të diskutonte sekretet e laboratorit të tij krijues me të huajt. "Librat e shënimeve", që përmbanin shumicën e skicave, u mbajtën larg syve kureshtarë dhe u ruajtën si një thesar nga gruaja e tij, Anna Grigorjevna.

Vizatimet në dorëshkrimet e Dostojevskit nuk janë vetëm ilustrime të tekstit. Shumë prej tyre përmbajnë çelësat e imazheve të heronjve të tij e shumë prej tyre tregojnë se çfarë mendonte në momentet e shkrimit të një vepre. Ashtu si shumë prej nesh, Fjodor Dostojevskit i pëlqente të vizatonte diçka mekanikisht kur ishte i mërzhitur ose i shqetësuar. Grafikat apo shënimet kaligrafike nuk ishin thjesht një "hobi". Përmbajtja e skicave dhe shkrimet e ndryshme pasqyronin gjendjen e tij emocionale. Nuk është rastësi që ilustrimet, skicat dhe shënimet kaligrafike bashkëjetojnë me veprat letrare dhe shënimet e autorit. Për një shkrimtar, grafika është një model krijues; kjo është një mënyrë për të kuptuar më mirë personalitetin, motivet dhe karakterin e heroit të tij. Shfaqja e imazheve grafike në dorëshkrime mund të quhet një fenomen i vërtetuar biografikisht. Në të ndikoi përvoja artistike dhe piktoreske. Ai u diplomua në Shkollën Kryesore të Inxhinierisë. Kështu, në "Ditarët e Shkrimtarit" për vitin 1877, ai kujtonte:

"Në të gjashtë klasat e shkollës duhej të bënim plane të ndryshme fortifikuese, ndërtimore dhe ushtarako-arkitektonike. Aftësia për të vizatuar mirë, me duart tona, kërkohej rreptësisht nga ne, kështu që edhe ata që nuk kishin dëshirë të vizatonin në mënyrë të pavullnetshme, duhej të përpiqeshin me çdo kusht për të arritur një sukses të caktuar në këtë art".

Në dorëshkrimet e tij janë gjetur skica, që paraqesin fytyra ekspresive dhe elemente arkitekturore të vizatuara me kujdes. Skica të tilla nuk ishin vetëm një mënyrë që shkrimtari të shpërqendrohej dhe të pushonte disi, por edhe pjesë e stilit të tij letrar. Sipas studiuesit Konstantin Barsht, shumë nga vizatimet e portreteve që gjejmë në dorëshkrime na kujtojnë dikë. Në disa raste ato janë prototipe, mbi bazën e të cilëve ai kërkonte “fytyrën e idesë” që i nevojitej për kompozimin e veprës së ardhshme. Për më tepër, vetë thelbi i krijimtarisë letrare është i lidhur në mënyrë të pandashme me krijimtarinë artistike dhe vizuale, pasi që të dy kanë një qëllim të vetëm: “të përshkruajnë”. Fjala dhe imazhi, të kombinuara në mënyrë organike, e ndihmojnë shkrimtarin në kuptimin filozofik dhe mishërimin artistik të botës së perceptuar: kjo shpreh vetë thelbin e individualitetit krijues të tij.

Duke nisur një roman të ri, ai i drejtohej vetes me thirrjen: “shikoni në librat e vjetër”. Nuk ka asgjë të parëndësishme në të gjithë procesin e unifikuar të krijimit të një vepre të madhe arti, fillimi i së cilës janë grafikë ose, më mirë të themi, shënime ideografike të romancierit. Se sa domethënëse ishte grafika për vetë Dostojevskin, vërtetohet edhe nga fakti se shkrimtari ndryshoi, për më tepër, shumë ashpër dhe në mënyrë karakteristike, vetë mënyrën e hartimit të shënimeve të tij në periodha të ndryshme të punës. Për shembull, materialet e dorëshkrimit për “Krim dhe Ndëshkim” ndryshojnë shumë jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formën e jashtme nga materialet për romanin “Idioti”, “Demonët” e vepra të tjera. Duke qenë në ballë të luftës për formën e kërkuar artistike, grafikët na sjellin të dhëna për ndryshime të rëndësishme në metodat dhe stilin e veprës së romancierit, çka sollën me vete vitet e pjekurisë së tij krijuese.

Në koleksionin e plotë të Dostojevskit (1972-1990), dorëshkrimet u ndanë në mënyrë analitike sipas parimit kronologjik, brenda të cilit një grup i caktuar tekstesh të zgjedhura të “Librave të shënimeve” iu bashkëngjit secilës prej veprave të tij. Ndërsa ideografia, përfshirë kaligrafinë, mbeti jashtë botimit. Aktualisht, ky parim është duke u rimenduar, bazuar në faktin se skicat e bëra gjatë punës së tij krijuese nuk janë aspak një “degë anësore e krijimtarisë”, por elemente të rëndësishme që pasqyrojnë rrugën e përpunimit të formës artistike nga shkrimtari. Në botimet e reja të veprave të plota të autorit, që po punohen në shtëpinë muze të “Pushkinit”, po merren parasysh dhe po komentohen si skicat,

ashtu dhe kaligrafia e tij.

Grafika për Dostojevskin shërben si një mjet për të paraqitur një imazh, duke kërkuar tipare të personalitetit që nuk mund të shprehen me fjalë, por që mund të gjenden në një imazh njerëzor dhe më vonë, pasi të rimendohet, përpiket ta kthejë atë në një përshkrim verbal. Si rezultat, në grafikën e shkrimtarit mund të dallohen dy komponentë: portretet dhe kaligrafia, të cilat janë mjete të përshkrimit të figurës dhe ideve në veprat e tij. Sipas studiuesit të veprës së shkrimtarit, Konstantin Barsht, Dostojevski nuk u kufizua vetëm në shënime gjatë procesit krijues. Në veprën e tij kuptimi dhe rëndësia e fjalëve ndërveprojnë me kuptime të tjera të shprehura përmes paraqitjes vizuale. Barsht-i pohon gjithashtu se ky stil është karakteristik ekskluzivisht për Dostojevskin. Arsenali kaligrafik përfshin jo vetëm një shumëllojshmëri shkrimesh, shpesh ngjitur në të njëjtën faqe, brenda të njëjtit tekst, të ekzekutuar edhe në të njëjtën kohë. Madje, mendohet se kishte shkrimin e tij të veçantë për çdo mendim që shprehte. Dorëshkrimet e autorit nuk janë thjesht një normë e shkruar me dorë apo kopje të thjeshta librash, por një botë e tërë imazhesh artistike, në pasurinë e tyre mjaft të krahasueshme me botën e veprës së shkrimtarit. Ndaj, mund të themi se shenjat ideografike në dorëshkrime janë po aq integrale dhe thelbësore, sa edhe tekstet verbale. Kriteri kryesor që ndihmon në përcaktimin e modelit të një grafike ishte dhe mbetet logjika e procesit krijues të Dostojevskit, në të cilin morën pjesë një rreth personash, fakte historike dhe letrare, karakteristike për një periudhë të caktuar të jetës së tij.

Le të shohim se çfarë shprehin mbishkrimet dhe skicat në dorëshkrimet e romanit “Krim dhe Ndëshkim”. Dostojevski vizatonte me plumb, ndonjëherë me bojë. Krijimet e para në dorëshkrimet e tij u shfaqën në margjinat e shënimeve nga “Shtëpia e të Vdekurve”, por shpenzoi pjesën më të madhe të energjisë së tij për shkrimin e romanit “Krim dhe Ndëshkim”. Ai skicoi Rodion Raskolnikovin, Arkadi Svidrigaillovin, Sonja Marmeladovën, Porfiri Petrovin dhe heronj të tjerë të romanit. Imazhet e heronjve nuk morën formë menjëherë. Në draftet e romanit, krahas përshkrimeve të Raskolnikovit, motrës dhe nënës së tij, kishte dhe portrete të vetë autorit, nënës dhe motrës së tij. (fig. 1)



Fig. 1

Për shembull, në 27 nga 268 faqet e dorëshkrimit që daton me periudhën e shkrimit të romanit, mund të gjenden imazhe të fytyrave të meshkujve dhe femrave. Elementët grafikë i gjejmë mesatarisht në çdo 34 faqe: fytyrat në çdo 47 faqe, gjethet e lisit (kryqore) në 132 faqe, kaligrafia në çdo 12 faqe, gotikja në çdo 22 faqe. (fig. 2)



Fig. 2

Imazhi i “personit prej dylli” të Pjetrit të Madh, i bërë nga skulptori Rastreli, realizuar gjatë punës së shkrimtarit për romanin në vitin, 1865. (fig. 3)



Fig. 3

Problemi i mishërimit të një personazhi njerëzor në një portret e shqetësoi Dostojevskin jo më pak se një piktor. Në faqet e dorëshkrimeve për romanin “Krim dhe Ndëshkim” mund të vërehet zhvillimi grafik i fytyrës së Raskolnikovit, nënës dhe motrave të tij. Në këtë ilustrim shohim imazhin e Raskolnikovit (djathtas), nënës së tij (majtas) dhe motrës (më poshtë). Në portretet e Pulçeria Aleksandrovnës dhe Dunjës, studiuesit panë një ngjashmëri të jashtme me nënën e shkrimtarit, Maria Fjodorovnën, dhe motrës së tij, Varvara Mihaillovnës. (fig. 4)



Fig. 4

Shënimet “Ot” dhe “Otto”, mendohet se i referohen Baronit Otto Reinhold Ludvig von Ungern-Sternberg (1744-1811). Një aristokrat i rafinuar i Revalit, i angazhuar në mënyrë aktive në pirateri, në Gjirin e Finlandës, për të cilin u arrestua dhe u internua në Siberi. Këta lloj personazhesh “të dhunshëm” ishin me interes të veçantë për shkrimtarin gjatë krijimit të romanit. (fig. 5)




Fig. 5

Këtu shohim imazhin e Raskolnikovit, në kohën e vrasjes së Lizavetës. Ajo që të habit, është se personazhi ka një ngjashmëri të qartë me autorin. Është i njohur fakti që Dostojevski gërshetoi disa fakte të biografisë së tij në historinë e Raskolnikovit: le të kujtojmë të paktën robërinë penale, nëpër të cilën kaloi dhe në të cilën bie heroi i tij. Këtu tregon se sa fort, jo vetëm në detaje biografike, por në gjithçka, deri në pamje, Dostojevski mund ta lidhte veten me Raskolnikovin. Ai kishte shumë të përbashkëta me personazhin kryesor, kur filloi ta shkruante për herë të parë në vitin 1865. Shkrimtari humbi pothuajse të gjithë pasurinë e tij në kumar dhe ishte në një situatë të vështirë financiare. (fig. 6)



Fig. 6

Në këtë ilustrim shohim imazhin e një burri që ngjan me Napoleonin. Kjo është një nga figurat kryesore për idenë dhe heroin e romanit, Rodion Raskolnikov. Shumë kohë më parë na është thënë se autori dënonte teorinë e përkufizimit të njerëzve të mëdhenj dhe të parëndësishëm, mishërimi i gjallë i të cilit ishte perandori francez. Në vizatim, perandori duket më shumë si një hero tragjik: një fytyrë asimetrike dhe me një shikim të kthyer, si të thuash, nga brenda. Duke gjykuar nga ky portret, Dostojevskit duket sikur i vjen keq për fatin e tij tragjik, ndonëse nuk e konsideron të duhur rrugën e tij. Shënimi “Поруч. Достоевский”, ka një karakter autobiografik. Në moshën 23-vjeçare, në moshën e Rodion Raskolnikovit, shkrimtari i ardhshëm kishte gradën e togerit inxhinier dhe, pasi u lirua nga detyra më 19 tetor 1844, mori gradën tjetër, toger inxhinier “në lirim”. Shënimi lidhet me çështjen e zhvillimit të mëtejshëm të përmbajtjes së romanit, në të cilin një rol të rëndësishëm luan debutimi letrar i Raskolnikovit, në të cilin vërteton protestën e tij kundër rolit shoqëror që i ofrohet nga shoqëria. Duke na kujtuar episodin e njëjtë të shkrimtarit, kur iu refuzua shërbimi publik. (fig. 7)



Fig. 7

Shënimi “Malebranche” tregon mendimet e Dostojevskit mbi filozofinë e Nikola Malebranshit (Nicolas Malebranche, 1638-1715), një filozof i shquar francez, një student i R. Descartes, themelues i racionalizmit. Vepra e tij monumentale “Kërkimi i së vërtetës” (N. Malebranche, De la recherche de la verite, 1674-1675) ishte një komponent thelbësor i jetës filozofike evropiane përgjatë shekujve XVIII dhe XIX dhe pati një ndikim të rëndësishëm në letërsinë ruse. Kështu, në këtë seri vizatimesh, Dostojevski po kërkonte një shprehje të përshtatshme të “fytyrës së idesë” të protagonistit në romanit të tij të ri; një filozof me një shpirt pasionant dhe rebel, që nuk njihet nga të tjerët, jeta e të cilit është e ngopur me mendime dhe ndjenja. Një kërkim i rëndësishëm për “Krim dhe Ndëshkim”, mbi të cilin autori po punonte në kohën e krijimit të kësaj galerie portretesh, dhe për romanin “Idioti”, i konceptuar në të njëjtën periudhë. Shkrimtari i njihte këta mendimtarë dhe i përdori në mënyrë aktive idetë e tyre në kërkimet e tij artistike. (fig. 8)



Fig. 8

“La Routine”: shkronjat kursive dhe të zbukuruara kanë të bëjnë me mendimet e shkrimtarit për pikën kryesore të doktrinës së Raskolnikovit në lidhje me ekzistencën e dy llojeve njerëzish, njëri prej të cilëve duhet të ndjekë në mënyrë rigorozë rregullat e vendosura dhe personifikon “rutinën” në formën e mundësisë për t’u bërë “familjar, baba, bashkëshort, qytetar i mirë etj., ndërsa i dyti ka të drejtën e zgjedhjes së lirë në zbatimin e synimeve të tij. Shënimet në faqet ngjitur tregojnë se faktori “rutinë” interpretohet si rreziku kryesor për heroin e tij filozof, i cili identifikon “rutinën” dhe “turmën” dhe e komenton këtë kombinim me fjalën “poshtërsi”. Ndërsa imazhet e shkronjave të zbukuruara “R” dhe “N” të përfshira në fjalën «Routine». «PARTIE» - një fjalë e përbërë nga shkronja të mëdha, ndoshta lidhet me idenë e përballjes midis këtyre dy grupeve, të cilat, sipas konceptit të Raskolnikovit, kanë mundësi të ndryshme në ushtrimin e të drejtave të tyre. (fig. 9)



Fig. 9

Shënimi «Простите» “Më falni”, «Прости<тутка>» “Prostitutka” sipër vizatimit të portretit të Sonja Marmeladovës u bënë pas përfundimit të shkrimit të skenës në roman, lidhur me “fyerjen” e Sonjës nga Pulçeria Aleksandrovna Raskolnikova, e cila dyshonte për një bashkëpunim të saj në krim. (fig. 10)



Fig. 10

“Nero” - perandori romak Neron (Claudius Caesar Nero; 37-68 pas Krishtit), tiparet e tij të karakterit u përdorën nga Dostojevski, për ndërtimin e imazhit të një personazhi të zotëruar nga “impulse pasionante dhe të stuhishme”.

“Ariman” (persishtja e lashtë Ahriya manyus) në fenë e Zoroastrianizmit tregonte forcat e errësirës dhe të së keqes; katastrofat, dështimet e të korrave, fatkeqësitë natyrore, sëmundjet dhe vdekja lidhen me imazhin e tij.

Shënimi “Arius” ka të ngjarë të lidhet me një ligjëratë të dëgjuar në rrethin “Petrashovski”, për origjinën e fesë, ku përfshihej modeli Arian i Krishtërit. “Arius” doli me idenë e Jezu Krishtit tokësor, sipas ideve të tij, vetëm Zoti është i përjetshëm. Shkrimet e Ariusit u shkatërruan nga breza luftëtarësh kundër koncepteve të tij dhe ai vetë u shkishërua.

Duke konceptuar një roman për një “person të bukur” të ngjashëm me Krishtin, që i afrohet idealit të Krishtit, Dostojevski mund të merrte parasysh idetë e Arianizmit, veçanërisht pasi ishte i njohur mirë me veprat e teologut Gregori.

“Roveredo” - ndoshta shënimi lidhet me fitoren ndaj trupave austriake gjatë kapjes së Roveredos, të fituar nga Napoleoni në 1796.

“Bousiris” - Busiris, një tiran mitologjik, mbret i Egjiptit, i cili sakrifikoi të huajt dhe kërcënoi Herkulin me vdekje. (fig. 11)




Fig. 11

Produktiviteti i shkrimit ideografik bazohet në faktin se si rezultat i marrëdhënieve aktive midis gjuhëve dhe teksteve të ndryshme brenda dy kanaleve të komunikimit, autokomunikimit dhe komunikimit, në dorëshkrimet e Dostojevskit krijohen kuptime të reja. Siç vëren Ju. M. Lotman, në këtë lloj situatë komunikative lind fenomeni i “lëkundjes” së strukturave: “... tekstet e krijuara në sistemin “Unë–Ai” funksionojnë si autokomunikime dhe anasjelltas: tekstet bëhen kode, kodet bëhen mesazhe.”

Ndaj mund të themi se njohja e shënimeve kaligrafike dhe skicave të autorit, gjatë punës së tij për krijimin e kësaj vepre, janë një domosdoshmëri për përkthyesit dhe lexuesin. Për të njohur dhe perceptuar sa më mirë botën e tij krijuese, faktet historike dhe jetësore që ndikuan në të. Për shkak të sintezës të portreteve dhe kaligrafisë, lind një imazh i vetëm, i veçantë i personazhit. Falë “komponentit arkitekturor” të grafikës dhe veçorive kompozicionale të tekstit dhe ilustrimeve, F. M. Dostojevski mishëron plotësisht frymën e veprës, mendimet dhe idetë që e emocionojnë, e cila në fund krijon një stil unik të autorit: verbal, artistik dhe vizual, ku pasqyrohet botëkuptimi origjinal i tij.

BIBLIOGRAFIA

- BARSHI, K. A., (2000), *Gjuhët e dorëshkrimit krijues të F. M. Dostojevskit*, në: Gjuhët e dorëshkrimeve: Kol. artikuj, Shën Petersburg, f. 122-147.
- BARSHI, K. A., (2015), *Emri dhe filozofia e Nikolai Malebranche në shënimet dhe veprat e të Dostojevskit*, “Çështje të filozofisë”, nr. 2, f. 94-105.
- BARSHI, K. A., (2018), *Shënimet kaligrafike të F. M. Dostojevskit në dorëshkrimet për romanin “Krim dhe Ndëshkim”*, Napis,
- DOSTOEVSKI F. M. (2005), *Ditari. Artikuj. Dorëshkrimet. Vëllimi 2. Tekste 1875-1877*. Zakharov, Moskë.. f. 37
- LOTMAN J. M. (2000), *Brenda botëve të të menduarit*. Në: Lotman Ju. M. Semiosfera [Lotman Yu. M. Semiosferë]. St. Petersburg, Iskustvo–SPB Publ., , f. 175
- Numri arkivor: RGALI. 212. 1, do të thotë: Arkivi Shtetëror Rus i Letërsisë dhe Artit, koleksioni 212, inventari 1.

<https://www.culture.ru/materials/149006/figury-na-polyakh-risunki-dostoevskogo-k-ego-rukopisyam>

<https://www.rsl.ru/ru/all-news/dostoevskiy-pearls>

<https://cultureru.com/portrait-sketches/>

<http://dostoevskiy-lit.ru/dostoevskiy/bio/risunki-fedora-dostoevskogo.htm>

<https://foma.ru/zagadki-risunkov-dostoevskogo-chto-skryvaetsja-za-nabroskami-v-rukopisjah-genija.html>

KARAKTERISTIKA TË TERMINOLOGJISË MJEKËSORE SHQIPE

Prof. Asoc. Dr. Mirela Papa

Departamenti i Gjuhës Italiane

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: mirela.papa@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Gjuha e mjekësisë bën pjesë në ligjërimin e specializuar dhe përdoret në fushën e mjekësisë për të komunikuar koncepte dhe informacione specifike. Karakteristikë e këtij ligjërimi është leksiku teknik terminologjik, i cili nuk mund të kuptohet nga ata që nuk janë specialistë të fushës. Në këtë artikull do të marrim në analizë terminologjinë mjekësore shqipe, duke evidentuar karakteristikat e saj kryesore. Leksiku mjekësor në gjuhën shqipe gjatë historikut të zhvillimit të tij ka pësuar ndikimin e gjuhëve të ndryshme. Ky leksik është pasuruar kryesisht me huazime nga gjuha italiane falë kontakteve kulturore dhe historike me Italinë. Në dhjetëvjeçarët e fundit vërehet një rritje e huazimeve nga gjuha angleze e lidhur kjo me globalizimin dhe përhapjen e terminologjisë shkencore ndërkombëtare. Prania e akronimeve dhe eponimeve është një tjetër aspekt i rëndësishëm i terminologjisë mjekësore ku akronimet shkurtojnë terma të ndërlikuar, duke lehtësuar përdorimin e tyre klinik, ndërsa eponimet i atribuojnë sëmundjeve emrat e njerëzve që i kanë zbuluar ato. Në gjuhën mjekësore vihet re gjithashtu edhe prezenca e sinonimeve, që vjen nga bashkëjetesa e termave tekniko-shkencor dhe termave shkencorë-popullorë, duke krijuar në këtë mënyrë nivele të ndryshme aktualizimi të gjuhës.

Fjalët çelës: akronime, eponime, huazime, gjuha mjekësore, gjuhë specialiteti, sinonime.

ABSTRACT

Medical language is a specialized discourse used in the field of medicine to convey specific concepts and information. A key characteristic of this discourse is its technical and terminological lexicon, which is often inaccessible to non-experts. In this article, we will analyze Albanian medical terminology, highlighting its main features. The medical lexicon in the Albanian language has been shaped by various linguistic influences over time. It has been predominantly enriched through borrowings from Italian, due to historical and cultural ties with Italy. In recent years, there has been a notable increase in borrowings from English, driven by globalization and the widespread adoption of international scientific terminology. Another important feature of medical terminology is the use of acronyms and eponyms. Acronyms serve to simplify complex terms for easier clinical use, while eponyms assign the names of individuals who discovered or first described certain diseases or procedures. Furthermore, the presence of synonyms reflects the coexistence of technical-scientific terms and scientific-popular language, leading to varying levels of language usage and accessibility within medical communication.

Keywords: acronyms, borrowings, eponyms, medical language, specialized language, synonyms.

Hyrje

Gjuha e mjekësisë bën pjesë në ligjërimin e specializuar apo gjuhët e quajtura ndryshe “*gjuhët sektoriale*”, “*gjuhët e specialitetit*” apo “*nënkodet e gjuhës*”. Ligjërimi i specializuar, në një kuptim më të gjerë mund të shihet si objekt më vete jashtë stilistikës gjuhësore në kundërvënie me ligjërimin e përgjithshëm.¹ Ai është një variacion i gjuhës i karakterizuar nga këto veçanësi: reflekton përgjithësisht një dije të veçantë, që ndahet mes një pakice ekspertësh dhe ka si synim të favorizojë dhe të lehtësojë komunikimin në këtë grup; përdor karakteristika të gjuhës, duke i ndërthurur këto karakteristika përsa i përket leksikut dhe formimit të fjalëve; ka prirjen, në ndryshim nga ligjërimi i përgjithshëm – polisemantik nga natyra – të vendosë një raport të saktë dhe të qëndrueshëm mes fjalëve dhe koncepteve.

Disa nga ligjërimet e specializuara kanë një *shkallë teknikizmi të ulët* (gjuha e së drejtës dhe e ekonomisë)²; disa kanë një *shkallë teknikizmi të lartë*³; (gjuha e matematikës, e mjekësisë, e fizikës, e kimisë, e botanikës, e zoologjisë dhe e disiplinave të tjera tekniko-shkencore). Në disa raste të tjera nuk kemi një ligjërim homogjen, por shumën e elementëve të nxjerra nga fusha të ndryshme dijesh (p.sh. gjuha e gazetarisë në të cilën bashkëjetojnë komponentë të gjuhës juridiko-administrative, ekonomike, sportive etj.)

Gjuha e mjekësisë, ashtu si të gjithë ligjërimet e specializuara dallohet dhe nga karakteristikat e saj tekstuale⁴ si: organizimi retorik i ligjërimit; aspektet morfosintaksore (fjalitë emërore, thjeshtimi i strukturës së fjalisë, format pësore dhe pavetore, mënyrat dhe kohët e foljeve), por në këtë punim do të ndalemi tek aspekti terminologjik.

Kur flasim për aspektin terminologjik, një diferencim i parë i përgjithshëm duhet bërë midis “termi” dhe “fjalës” bazuar në natyrën

¹Shiko: Xh. Lloshi (2001), “Stilistika funksionale” te *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, SHBLU.

²M. Dardano e P.Trifone (1997), *La nuova grammatica della lingua italiana*, Zanichelli, Bologna, f. 567.

³M. Dardano e P.Trifone (1997), *La nuova grammatica della lingua italiana*, Zanichelli, Bologna, f. 568.

⁴ Shiko: F. Scarpa (2012), *La traduzione specializzata. Un approccio didattico professionale*, (botimi i dytë), Hoepli Editore, Milano f. 32 – 48.

e referentit, i cili tek termi është i specializuar brenda një disipline të caktuar, ndërsa tek fjala është i përgjithshëm në një sërë tematikash⁵. Termi gjithashtu ka karakterin e një njësie leksikore thjesht denotative, domethënë e lirë nga konotacionet kulturore dhe individuale të fjalës.⁶

Termat mund të përbëhen nga një njësi leksikore (e cila mund të jetë edhe një shkronjë, një simbol grafik, një shkurtim, një akronim etj.) ose nga formulime pak a shumë të ngulitura që përdoren me një frekuencë të caktuar dhe që quhen frazeologjizma të specializuara ose teknikizma ndihmës.⁷

Në lidhje me terminologjinë e gjuhës mjekësore mund të flitet (për gjuhët perëndimore) për një uniformitet terminologjik. Kjo pasi pothuajse e gjithë terminologjia mjekësore bazohet në leksikun greko-latin⁸, madje edhe formimi i fjalëve të reja sot bëhet me përdorimin e parashtesave dhe prapashtesave me origjinë greko-latine duke shmangur përdorimin e fjalëve të përdorura nga publiku në jetën e përditshme. Kjo zgjedhje shërben për t'i dhënë një identitet të veçantë komunitetit gjuhësor të sektorit mjekësor.⁹

Në gjuhën e mjekësisë si një “*nënkod gjuhësor*” mund të gjejmë edhe disa “*nën-nënkode*” në varësi të tri fushave në të cilat ndahen degët e mjekësisë¹⁰: *shërbimet mjekësore* (mjekësia e brendshme, kardiologjia, neurologjia, endokrinologjia, gastroenterologjia, pneumologjia, nefrologjia, hematologjia, reumatologjia etj.); *shërbimet kirurgjikale* (kirurgjia e përgjithshme, kirurgjia vaskolare, neurokirurgjia, ortopedia,

⁵ F. Scarpa (2012), *La traduzione specializzata. Un approccio didattico professionale*, (botimi i dytë), Hoepli Editore, Milano f. 52.

⁶ P. Balboni (2000), *Le microlingue scientifico-professionali*, UTET, Torino.

⁷ F. Scarpa (2012), *La traduzione specializzata. Un approccio didattico professionale*, (botimi i dytë), Hoepli Editore, Milano f. 52.

⁸ Tekstet më të vjetra mjekësore u shkruan në greqisht, me *CorpusIppocratum*, që daton në shekujt V dhe IV para Krishtit, i cili përmban 53 vepra që i atribuohen Hipokratit, megjithëse, ndoshta jo të gjitha janë vepra të tij. Gjatë sundimit romak, shumë mjekë grekë sollën njohuritë e tyre në Romë, duke i përkthyer tekstet në latinisht dhe, më vonë, në arabisht, falë zhvillimit të shkollave të Bagdadit dhe Damaskut, ku u ruajtën dhe u përkthyen vepra nga autorë grekë dhe arabë. <https://www.yumpu.com/it/document/view/15836106/olja-arsic-tesi-specialistica-con-glossario-di-medicinapdf>

⁹ Mina Atef Naguib Kenz, *La neologia combinatoria nella scienza medica: prefissazione, suffissazione e composizione*, https://fjhj.journals.ekb.eg/article_168981_326e55c318f45fb78a4c46f1beab0803.pdf

¹⁰ <https://blog.edises.it/elenco-specializzazioni-medicina-60958>

otorinolaringoiatria, ekulistika, urologjia, gjinekologjia etj.) dhe *shërbimet klinike* (mikrobiologjia, fiziatria, virologjia, anestezia, mjekësia ligjore etj.).

Në këtë studim do të trajtojmë disa nga karakteristikat e terminologjisë mjekësore në gjuhën shqipe duke u ndalur te huazimet, akronimet, eponimet si dhe te përdorimi i sinonimeve.

Huazimet

Karakteristikë kryesore e terminologjisë mjekësore shqipe është prania e konsiderueshme e huazimeve. Huazimet verifikohen kur gjuha përvetëson një tipar gjuhësor që nuk ekziston tek ajo, por tek një gjuhë tjetër. Ky proces “përvetësimi” dhe tipari gjuhësor i “përvetësuar” në këtë mënyrë tregohen me të njëjtin term *huazim*¹¹. Në të gjitha gjuhët e botës, zhvillimi i përgjithshëm tekniko-shkencor dhe marrëdhëniet me botën, sjellin me vete edhe prurje të reja gjuhësore.¹²

Huazimet janë një pjesë e rëndësishme e terminologjisë mjekësore të të gjitha gjuhëve, jo vetëm e gjuhës shqipe.

Sipas M. Dardano dhe P. Trifone, huazimet ndahen në: 1) *huazime “të integruara”* apo “*strukture*” dhe 2) *huazime “të paintegruara”* ose “*të plota*”.

1.1 Huazimet nga gjuha angleze

Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit të 20-të, si rrjedhojë e prestigjit të arritur nga Shtetete Bashkuara, anglishtja bëhet gjuha kryesore e pothuajse të gjitha shkencave. Mund të themi se, sot, anglishtja përfaqëson gjuhën kryesore të komunikimit mjekësor. Kjo dëshmohet edhe nga fakti se, tashmë, në shumë vende të Evropës (me përjashtim të Francës) dhe Azisë, revistat botohen në anglisht edhe kur ato janë të destinuara për përdorim nga publiku vendas.¹³ Anglishtja është gjuha referuese e literaturës shkencore mjekësore ndërkombëtare.

¹¹ M. Dardano e P. Trifone, *La nuova grammatica della lingua italiana*, Zanichelli, Bologna, 1997.

¹² E. Katorri (2024), *Huazimet nga italishtja në gjuhën e gazetave: leksiku dhe sintaksa*, në FGJH, Nr. 9, Tiranë, f. 69.

¹³ Olja Arsic, *Tesi specialistica con glossario di medicina*, www.yumpu.com/it/document/view/15836106/olja-arsic-tesi-specialistica-con-glossario-di-medicinapdf

Huazimet gjuhësore nga anglishtja (domethënë *anglicizmat*) janë numerikisht të konsiderueshëm në shqipe si edhe në çdo gjuhë tjetër. Do të konsiderohen *anglicizma* edhe termat të cilët, pavarësisht se kanë një etimologji latine apo greke, kanë hyrë në shqipe nëpërmjet gjuhës angleze.

1.1.1 Huazime të integruara

Huazime “të integruara” apo “strukture”¹⁴ (“të përshtatura”), kur fjalët e huazuara u nënshtrohen rregullave të fonetikës dhe të morfologjisë së gjuhës shqipe. Ndryshojnë disa fonema, shtohet ndonjë mbaresë dhe hyjnë në kategoritë e ndryshme leksiko-gramatikore të gjuhës shqipe.¹⁵ Më poshtë kemi sjellë disa shembuj ilustrues:

► adictology	adiktologji
► imaging	imazheri
► addict	adikt
► splachnology	splanchnologjia
► subclavian artery	arteriet subklave
► reabsorption	rezorbimi
► buffer solution	solucione buferike
► hemopoiesis (ose hematopoiesis)	hemopoeza (ose hematopoeza)
► thymus	timusi
► cancer	kancer
► pancreas	pankreas
► sedentary lifestyle	jetë sedentare

Vihet re lehtësisht se si termat e mësipërm i janë përshtatur rregullave gramatikore të gjuhës shqipe. Të ndalemi te disa prej tyre.

Në rastin e *arterieve subklave* dhe *solucioneve buferike* kemi të bëjmë me rastet e *kalkeve-përkthim*, të cilat janë fjalë të formuara me brumin e shqipes, në to i huaj është vetëm ndërtimi i fjalës apo i sintagmës që

¹⁴ M. Dardano e P.Trifone, *La nuova grammatica della lingua italiana*, Zanichelli, Bologna, 1997, f. 566

¹⁵ Majlinda Ismaili Mahmudi (2021), *Anglicizmat, vendi dhe përdorimi i tyre në shqipen e shqiptarëve të Maqedonisë (së Veriut)*, disertacion, https://uniel.edu.al/images/kerkimi_shkencor/Disertacioni-Majlinda_Ismaili_Mahmudi_protected.pdf, f. 62.

shënon një koncept të vetëm në fushën e studimit¹⁶.

Një tjetër konsideratë mund të bëhet edhe në lidhje me prejardhjen e këtyre termave në gjuhën angleze. Në fakt janë pothuajse të gjithë me prejardhje latine apo greke, por që në gjuhën shqipe janë futur nga gjuha angleze. Kështu “subclavian artery” vjen nga termi latinisht “subclavia”, një fjalë e përbërë nga “sub” (poshtë) dhe “clavis” (klavikul), duke iu referuar në këtë mënyrë pozicionit anatomik poshtë klavikulës.¹⁷ Prania e bashkëtingëllores “b” në termin shqip “arteriet subklave” të çon në përfundimin se termi është huazuar nga gjuha angleze duke qenë se në gjuhën italiane (arteria succlavia) kjo bashkëtingëllore është zëvendësuar nga bashkëtingëllorja “c”.

I njëjti arsyetim mund të bëhet edhe për termin *hemopoiesis* (ose *hematopoiesis*), i cili është me prejardhje nga greqishtja e vjetër (haima = gjak dhe poiesis = krijoj). Në termin shqip *hemopoeza* (ose *hematopoeza*) vihet re prania e bashkëtingëllores “h”, gjë që dëshmon për huazimin e këtij termi nga gjuha angleze, ndërkohë që në gjuhën italiane termi *emopoiesi* (ose *ematopoiesi*) duket se është huazuar nga greqishtja ndoshta nëpërmjet latinishtes.

Termi *thymus*, i cili i referohet një gjëndre endokrine dhe ka një etimologji jo të përcaktuar mirë, mund të ketë prejardhje nga latinishtja¹⁸ ose nga greqishtja. Termi shqip duket se është huazuar dhe përshtatur nga gjuha angleze, e cila ka ruajtur origjinalin e huazuar nga latinishtja *thymus*, ndërsa në gjuhën italiane termi është përshtatur me termin *timo*.

Termi shqip *kancer* duhet të jetë huazuar nga gjuha angleze e cila nga ana e saj e ka huazuar nga latinishtja *cancer*¹⁹ term i cili është edhe ai vetë një huazim nga gjuha greke *karkinos*. Të dy termat edhe ai latin edhe ai grek kanë kuptimin “gaforre”. Hipokrati, i konsideruar si babai i mjekësisë, e përdori termin grek për t’iu referuar tumoreve malinje, ndoshta për shkak të ngjashmërisë midis degëzimeve të disa llojeve të kancerit dhe kthetrave të një gaforreje.

Në shembullin e fundit, termi *jetë sedentare* është një kalk-përkthim nga gjuha angleze, pavarësisht se *sedentary* rrjedh nga termi latin *sedentarius* që do të thotë *qëndrojnë ulur*. Nuk është tamam një term

¹⁶ J. Thomai (2002), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, f. 229.

¹⁷ [https://www.treccani.it/vocabolario/ricerca/SUCCLAVIA_\(anatomia\)/](https://www.treccani.it/vocabolario/ricerca/SUCCLAVIA_(anatomia)/)

¹⁸ <https://www.treccani.it/vocabolario/ricerca/Thymus-vulgaris/>

¹⁹ <https://www.treccani.it/vocabolario/cancro/>

mjekësor, por më tepër një proces që çon në sëmundje, të cilin e dëgjojmë gjithnjë e më shpesh të përmendet nga mjekët.

1.1.2 Huazime të paintegruara

Huazime “të paintegruara” ose “të plota”²⁰ (“të papërshtatura”), do të quhen huazimet që përftohen nga futja në përdorim e fjalës së huajnë formën e saj origjinale. Ndër këto huazime mund të përmendim:

▶ shunt	shunt
▶ by-pass	by-pass
▶ hepar	hepar
▶ superior vena cava	vena cava superior
▶ inferiore vena cava	vena cava inferior
▶ lien	lien
▶ vena azygos	vena azygos
▶ sputum	sputum

Në rastin e termit *hepar* (mëlçi) duhet të themi se bëhet fjalë për një term i cili ka prejardhje greke dhe latine. Ky term përdoret në gjuhën angleze krahas termit anglisht *liver*. Edhe gjuha italiane e ka zëvendësuar termin me fjalë të brumit të italishtes *fegato*, por ruhet rrënja greko-latine për formimin e mbiemrave që kanë lidhje me mëlçinë si p.sh.: epatico, duke krijuar fenomenin e supletivizmit sipas të cilit brenda së njëjtës familje fjalësh kemi përdorimin e temave të ndryshme fjalëformuese.²¹

Në rastin e *vena cava superior*, termi është me prejardhje latine dhe në gjuhën angleze është një huazim i painteguar, prandaj shkruhet dhe shqiptohet si në latinisht. Ky term është huazuar nga latinishtja edhe në gjuhën italiane, por në italisht është përshtatur dhe mbiemri superior ka marrë mbaresën “e” *superiore*. Në gjuhën shqipe termi është futur nga gjuha angleze dhe shkruhet dhe shqiptohet si në gjuhën latine.

Për termin *lien* (tëmthi), mund të pohojmë se përsëri kemi përdorimin e termit latin në gjuhën shqipe, ndonëse është futur si një huazim nga gjuha angleze, e cila ka në fjalorin e saj mjekësor edhe termin *spleen*, ashtu si edhe gjuha italiane termin *milza*. Natyrisht që edhe gjuha shqipe ka një

²⁰ M. Dardano e P.Trifone (1997), *La nuova grammatica della lingua italiana*, Zanichelli, Bologna, f. 566.

²¹ L. Serianni (2012), *Italiani scritti*, Bologna, Il Mulino f. 92.

term të brumit të saj *tëmth*, por përdoret në nivelin shkencor-popullor, ndërsa specialistët preferojnë të përdorin termin *lien* në relacionet e tyre mjekësore drejtuar profesionistëve të fushës.

Termi *vena azygos* tregon një venë të rëndësishme në trupin e njeriut, e vendosur në zgavrën e krahavorit dhe të barkut, e cila luan një rol vendimtar në drenazhin e gjakut venoz nga pjesa e pasme e krahavorit dhe e sipërme e barkut. *Azygos* është një term i cili vjen nga greqishtja, por që në gjuhën shqipe është futur si huazim nga gjuha angleze ku termi është ruajtur në formën e tij origjinale pa u përshtatur. Termi nuk i është përshtatur as rregullit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe sipas të cilit fjalët me burim prej greqishtes së vjetër që në këtë gjuhë kanë y (ipsilon) shkruhen me “i”.²²

Sputum është një tjetër term me prejardhje nga latinishtja, por që në gjuhën shqipe ka hyrë nga anglishtja duke qenë se pikërisht në anglisht termi vijon të përdoret si në formën e tij origjinale latine, ndërkohë që në gjuhën italiane është zëvendësuar me termin e krijuar nga brumi i gjuhës italiane *sputo*, *espettorato*, *catarro*. Termi i referohet sekrecioneve që nga rrugët e frymëmarrjes, si bronket dhe trakea dalin jashtë përmes kollës.

1.2 Huazimet nga gjuha italiane

Gjuha shqipe ka përvetësuar shumë terma mjekësorë edhe nga gjuha italiane, falë afërsisë gjeografike mes vendeve tona dhe natyrisht edhe si rrjedhojë e formimit të mjekëve shqiptarë në shumë Universitete Italiane²³ duke filluar nga shekulli XIX deri në ditët e sotme. Termat e huazuara nga gjuha italiane nuk janë vetëm emërtime sëmundjesh, por edhe terma që shënjojnë pjesë të ndryshme në organizmin e njeriut, instrumente dhe shërbime diagnostikimi etj.

1.2.1 Huazime të integruara

- | | |
|-------------------------------|---------------------------|
| ► insufficienza cardiaca | insuficiensë kardiake |
| ► sindrome del tunnel carpale | sindromi i tunelit karpal |

²² Akademia e Shkencave e RP së Shqipërisë, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973, III. 36, ç.

²³Në shek. XVIII dhe XIX filluan të diplomoheshin mjekët e parë shqiptarë në universitetet e Evropës. Në fillim të shek. XIX Ali Pashë Tepelena dërgoi dy studentë shqiptarë për të studiuar mjekesi në universitetin e Napolit dhe të Vjenës. <https://www.zemrashqiptare.net/news/1945/rp-0/act-print/rf-1/printo.html>

▶ malattie cardiovascolari	sëmundjet kardiovaskulare
▶ trombosi venosa profunda	trombozë venoze e thellë
▶ cisti dermoidi	kistet dermoide
▶ artrite reumatoide	artrit reumatoid

Në shembujt e mësipërm kemi të bëjmë jo me fjalë, por me sintagma të huazuara që nga ana e tyre shprehin një koncept të caktuar mjekësor. Në këto sintagma fjala *malattie* është e përkthyer *sëmundje* dhe fjala që i përket ligjërimit të përgjithshëm *profonda* është dhënë me gjegjësen e saj shqipe *e thellë*, ndërsa termat e tjerë i janë përshtatur drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

▶ nutrigenetica	nutrigjenetika
-----------------	----------------

Në këtë shembull kemi të bëjmë me një huazim të një prej shkencave të zhvilluara së fundmi dhe që merret me ushqimet dhe me gjenetikën dhe është një risi në sektorin e mjekësisë.

▶ afasia	afazia
▶ diagnosi	diagnozë
▶ disinfettare	dezinfektoj

Në rastet e mësipërme kemi të bëjmë me huazime të përshtatura në gjuhën shqipe sipas rregullave të drejtshkrimit²⁴ ku për fjalët që burojnë nga gjuhët romane tek të cilat ato kanë një “s” ndërzanore, shkruhen në gjuhën shqipe me z.

▶ strabismo	strabizëm
▶ ambliopia	ambliopia
▶ diplopia	diplopia
▶ pericarditeacuta	perikardit akut
▶ pericarditeserosa	perikardit seroz

▶ pericardite fibrinosa	perikardit fibrinoz
▶ pericardite purulenta	perikardit purulent
▶ pericardite emorragica	perikardit hemorragjik

²⁴ Akademia e Shkencave e RP së Shqipërisë (1973), *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, kap.III, §36 n. f. 101.

► silicosi	silikoza
► antracosi	antrakoza
► asbestosi	azbestoza
► berilliosi	berilioza
► cistite emorragica	cistit hemorragjik
► cistite supurativa	cistit supurativ
► cistite ulcerosa	cistit ulceroz
► cistite membranosa	cistit membranoz
► cistite gangrenosa	cistit gangrenoz

Të gjithë shembujt e mësipërm janë emra patologjish të ndryshme, termat emërtuese të të cilave janë huazuar dhe janë përshtatur në gjuhën shqipe. Edhe në rastet kur emri i patologjisë është i përbërë nga një togfjalësh kemi të bëjmë me një huazim dhe përshtatje ortografike të togfjalëshit në gjuhën shqipe. Në rastet e sëmundjeve *silicosi*, *antracosi*, *asbestosi*, *berilliosi* përshtatja në gjuhën shqipe (*silikoza*, *antrakoza*, *azbestoza*, *berilioza*) është bërë duke i shtuar termave të huazuar mbaresën –a dhe duke i futurkështu në kategorinë e gjinisë femërore. Kjo vjen edhe nga fakti se këto emra në gjuhën italiane janë të gjinisë femërore. Në rastin e llojeve të ndryshme të cistitit, edhe pse në gjuhën italiane termi cistite i përket gjinisë femërore, në gjuhën shqipe termi ka kaluar në gjininë mashkullore *cistit*.

► plesso brachiale	pleksi brakial
► parenchima polmonare	parenkima pulmonare

Siç e thamë edhe më lart termat e huazuar nga gjuha italiane nuk janë vetëm emërtime sëmundjesh, por edhe terma që shënjojnë pjesë të ndryshme në organizmin e njeriut. Në shembujt e mësipërm kemi sjellë disa raste të tilla. Kështu plesso brachiale²⁵ i përshtatur në gjuhën shqipe pleksi brakial është një nga gjashtë plekset nervore që i përkasin sistemit nervor periferik, i përbërë nga degët e përparme të nervave kurrizorë. *Parenchima polmonare*²⁶ e përshtatur në gjuhën shqipe me *parenkima pulmonare* është indi specifik që përbën pjesën funksionale të mushkërive, përgjegjës për shkëmbimin e gazrave.

25 [https://www.treccani.it/enciclopedia/brachiale_\(Enciclopedia-Italiana\)/](https://www.treccani.it/enciclopedia/brachiale_(Enciclopedia-Italiana)/)

26 [https://www.treccani.it/enciclopedia/parenchima_\(Dizionario-di-Medicina\)/](https://www.treccani.it/enciclopedia/parenchima_(Dizionario-di-Medicina)/)

- | | |
|-----------------------------|----------------------------|
| ► tomografia computerizzata | tomografi e kompjuterizuar |
| ► auscultazione | auskultacioni |

Në shembujt e mësipërm kemi të bëjmë me terma të cilët tregojnë i pari një instrument për diagnostikimin e sëmundjeve dhe i dyti një ekzaminim diagnostikues. Në të dy rastet kemi përshtatje të huazimeve. Në rastin e parë kemi kalk-përkthim ku mbiemri *computerizzata* ka ruajtur kategorinë e mbiemrit në gjuhën shqipe, por është futur te grupi i mbiemrave të nyjshëm.

1.2.2 Huazime të paintegruara:

- | | |
|--------------|------------|
| ► pleura | pleura |
| ► angiologia | angiologia |
| ► uretere | uretere |
| ► parietale | parietale |
| ► granuloma | granuloma |

Disa tumore të zemrës:

- | | |
|-----------------|---------------|
| ► mixoma | mixoma |
| ► fibroelastoma | fibroelastoma |
| ► rabdomioma | rabdomioma |

Në shembujt e sjella më sipër vihet re se këto huazime nuk u janë përshtatur rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe. Në pjesën më të madhe të shembujve drejtshkrimi dhe shqiptimi përkojnë, prandaj janë lehtësisht të transferueshme në gjuhën shqipe pa kërkuar përshtatje të formës. Në rastin e termave *mixoma* dhe *angiologia* nuk kemi në gjuhën italiane një përputhje mes drejtshkrimit dhe shqiptimit, prandaj edhe mund të ishin bërë përshtatje drejtshkimore për të respektuar parimin fonologjik të depërtimit të huazimeve në gjuhën shqipe.

1.3 Ndërkombëtarizma

Ndërkombëtarizmat janë fjalë të cilat kanë formë (grafi dhe shqiptim) dhe kuptim të njëjtë në shumë gjuhë, shpesh kanë prejardhje nga

latinishtja dhe greqishtja dhe mund të identifikohen lehtësisht në një gjuhë të huaj. Në gjuhën e mjekësisë gjejmë shpesh terma ndërkombëtarë. Terma si: *erysipelothrix rhusiopathiae*; *corynebacterium*; *haemophilus*; *campylobacter*; *helicobacter pylori*; *chlamydophila* me prejardhje nga greqishtja përdoren në të njëjtën formë në italisht, anglisht, frëngjisht, shqip dhe gjuhë të tjera. Edhe termat paramyxovirus; lichenplanus me prejardhje nga latinishtja dhe greqishtja gjithashtu mund t'i gjesh në po këtë formë në gjuhën italiane, angleze, frënge, shqipe etj.

2. Akronimet

Akronimet janë fjalë të formuara me inicialet apo rrokjet initiale të një fjalie apo të një grupi fjalësh. Akronimet shpesh përdoren për të shkurtuar terma të gjatë dhe të ndërlikuar duke e bërë komunikimin më të zhdërvjellët dhe më të efektshëm.²⁷

Anglishtja është sigurisht gjuha mbizotëruese në këtë aspekt të gjuhës mjekësore. Në gjuhën shqipe, si edhe në gjuhë të tjera, shumica e akronimeve janë huazuar nga anglishtja dhe për këtë arsye ruhen në gjuhën e tyre origjinale. Megjithatë në gjuhën mjekësore shqiptare, nuk mungojnë edhe akronime nga gjuha italiane dhe madje edhe disa të krijuara nga inicialet në shqip të fjalive apo grupeve të fjalëve të përkthyer.

2.1 Akronime nga gjuha angleze

Ashtu si edhe për huazimet, edhe akronimet nga gjuha angleze janë të shumta. Më poshtë kemi sjellë disa shembuj. Këto akronime përdoren gjerësisht nga specialistët e fushës së mjekësisë në kontekste të ndryshme të profesionit të tyre.

- ▶ ECG o EKG (Electrocardiography)
- ▶ LC (lung cancer)
- ▶ PET-CT (Positron Emission Tomography/Computed Tomography)
- ▶ MRI (Magnetic resonance imaging)
- ▶ VATS (Video-assisted thoracoscopic surgery)
- ▶ CAP (Community-acquired pneumonia)

²⁷ L. Serianni (2012), *Italiani scritti*, Bologna, Il Mulino f. 93.

► HAP	(Hospital-acquired pneumonia)
► AIDS	(Acquired Immunodeficiency Syndrome)
► VAP	(Ventilator associated pneumonia)
► TBLB	(Transbronchial Lung Biopsy)
► TB	(Tuberculosis)
► OSA	(Obstructive Sleep Apnea)
► CSA	(Central Sleep Apnea)
► MAC	(Mycobacterium avium complex)
► GVHD	(Graft Versus Host Disease)
► ATLS	(Advanced Trauma Life Support)
► MCV	(Mean Corpuscular Volume)
► MCH	(Mean Corpuscular Hemoglobin)
► GPT	(Glutamyl Pyruvic Transaminase)
► MCHC	(Mean Corpuscular Hemoglobin Concentration)
► MPV	(Mean Platelet Volume)
► RDW	(Red Corpuscular Width)
► RBC	(Red Blood Cell)
► HDL	(High Density Lipoprotein)
► LDL	(Low Density Lipoprotein)

Në shembullin e parë kemi të bëjmë me një rast homonimie të akronimit në gjuhën shqipe. Në fakt *elektrokardiograma* edhe në gjuhën shqipe do të kishte të njëjtin akronim EKG. Ky akronim është lehtësisht i memorizueshëm edhe nga ata që nuk janë specialistë të fushës, por të cilët kanë pasur eksperiencë të këtij testi. Shembujt e fundit (MCV, MCH, GPT, MCHC, MPV, RDW, RBC, HDL, LDL) janë akronime që mund t'i gjesh në fletët e analizave të çdo laboratorit në Shqipëri, pasi në fletët e testeve laboratorike përdoren gjerësisht akronimet nga gjuha angleze.

2.2 Akronime nga gjuha italiane

Akroneimet nga gjuha italiane janë të pranishme në gjuhën mjekësore shqiptare, por jo në të njëjtën masë me akronimet nga gjuha angleze. Kështu mund të përmendim:

► NTA	(Necrosi tubolare acuta)
► FBS	(Fibrobroncoscopia)
► TAC	(Tomografia Assiale Computerizzata)
► VFANS	(Farmaci Antiinfiammatori Non Steroidei)
► SIDA	(Sindrome da Immunodeficienza Acquisita)

Në shembullin e fundit, vëmë re se për të njëjtën patologji në gjuhën shqipe përdoren dy akronime AIDS nga gjuha angleze dhe SIDA nga gjuha italiane. Fillimisht është përdorur akronimi i huazuar nga gjuha italiane, i cili është edhe i njohur nga një masë njerëzish. Më vonë me ekspansionin e gjuhës angleze është futur në gjuhën shqipe edhe akronimi AIDS.

2.3 Akronime të gjuhës shqipe

► TT	tumoret e toraksit
► SPOK	sëmundje pulmonare obstruktive kronike

Në shembullin e parë mund të themi që kemi rastin kur akronimi i huazuar dhe ai i gjuhës shqipe përkojnë me njëri-tjetrin. Në shembullin e dytë duhet të themi se, krahas akronimit në gjuhën shqipe, ekziston dhe përdoret shpesh nga mjekët edhe akronimi i huazuar nga gjuha angleze COPD - Chronic obstructive pulmonary disease.

3. Eponimet

Gjuha mjekësore përdor edhe eponime të shumta, domethënë emra për organe, patologji dhe instrumente kirurgjikale, të cilat i referohen emrave të shkencëtarëve që i kanë studiuar apo i kanë zbuluar ato. Për shembull, *tubat e Fallopit* (që e morën emrin nga Gabriele Falloppio, 1523-1562)²⁸, *sëmundja e Parkinsonit* (nga James Parkinson, 1755-1824), etj. Nga kjo karakteristikë nuk bën përjashtim as gjuha mjekësore shqipe. Në fakt vihet re edhe në gjuhën mjekësore shqipe prania e eponimeve të cilat, ashtu si edhe huazimet apo akronimet, ndahen në eponime të integruara dhe eponime të paintegruara.

²⁸ L. Serianni (2012), *Italiani scritti*, Bologna, Il Mulino f. 93.

3.1 Eponime të integruara

Eponimet e integruara, ashtu si dhe fjalë të tjera me prejardhje të huaj duhet të kenë hyrë në gjuhën shqipe kryesisht pas Shpalljes së Pavarësisë²⁹ dhe të cilat pas Kongresit të Drejtshkrimit iu nënshtruan rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Më poshtë kemi sjellë disa shembuj:

► l'equazione di Bernoulli	ekuacioni i Bernulit
► la legge di Poiseuille	ligji Puazej
► la formula di Laplace	formula e Laplasit
► la legge di Coulomb	ligji i Kulonit
► l'effetto Joule	efekti Xhaul
► la legge di Kirchhoff	ligji i Kirkofit
► la legge Biot-Savart	ligji i Bio Savarit
► il ponte di Wheatstone	ura e Uitsonit
► il principio Le Châtelier	parimi le Shatelite

Siç mund ta shohim dhe nga shembujt, bëhet fjalë për eponime nga fushat e fizikës, biologjisë dhe kimisë, por ato përdoren gjithashtu edhe në gjuhën e mjekësisë.

Në përgjithësi, eponimet nuk shkaktojnë probleme në përkthim, pasi shumica e tyre janë të njohura në nivel ndërkombëtar. Megjithatë, problemet lindin kur nevojiten të përkthehen në gjuhë të huaj eponime të integruara në gjuhën tonë, domethënë të përshtatura me rregullat e drejtshkrimit dhe të shqiptimit të gjuhës shqipe. Nëse përkthyesi nuk është i informuar, atëherë bëhet e vështirë identifikimi i eponimit origjinal. Si në rastet e mëposhtme:

► la legge di Poiseuille	ligji Puazej
► la formula di Laplace	formula e Laplasit
► la legge di Coulomb	ligji i Kulonit
► l'effetto Joule	efekti Xhaul

²⁹ Akademia e Shkencave e RP së Shqipërisë (1973), *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 90.

3.2 Eponime të paintegruara

Në rastin e eponimeve të paintegruara duhet thënë se i përftojme kur emri i përveçëm që përbën eponimin futet në gjuhën shqipe pa u shoqëruar me ndryshimet e duhura fonomorfologjike, por shkruhet në të njëjtën mënyrë siç shkruhet edhe në gjuhën nga e cila është huazuar. Këto eponime mund të jenë futur në gjuhën shqipe pas viteve '90 të shekullit të kaluar, duke qenë se nuk i janë përshtatur rregullave të shkrimit të emrave të përveçëm të vendosur në Kongresin e Drejtshkrimit 1972, ku³⁰ thuhet: Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. Më poshtë kemi sjellë disa shembuj eponimesh të paintegruara në gjuhën shqipe.

► la tetralogia di Fallot	tetrada Fallot (tetralogjia Fallot)
► ductus Botalli	duktus Botalli
► la malattia di Crohn	sëmundja Crohn
► la malattia di Wilson	sëmundja Wilson
► Vsindrome di Sjörger	sindroma Sjorgen
► tumore di Warthin	tumori Warthin
► sindrome di Cushing	sindroma Cushing
► la malattia di Kawasaki	sëmundja Kawasaki
► morbus Legg-Calvé-Perthes	morbus Legg-Calvé-Perthes
► Henoch-Schönlein purpura	purpura Henoch-Schönlein
► Bunyamwera virus	virus Bunyamwera

Një tjetër vërejtje që mund të bëhet tek eponimet e paintegruara është se në eponimet me prejardhje nga gjuha italiane si: *la tetralogia di Fallot*; *la malattia di Crohn*; *la malattia di Wilson*; *sindrome di Sjörger*; *tumore di Warthin*; *sindrome di Cushing*; *la malattia di Kawasaki* etj. ku, nëpërmjet përdorimit të parafjalës “di” përcaktohet lidhja mes fjalës së parë dhe të dytë të togfjalëshit, në gjuhën shqipe marrëdhënia përcaktore nuk rikrijohet me përdorimin e nyjes së rasës gjinore. Ky fenomen që nuk vihet re tek eponimet e integruara mund të vijë nga fakti që përdorimi i rasës gjinore të emrave të përveçëm do të kërkonte zbatimin e parimit

³⁰ Akademia e Shkencave e RP së Shqipërisë (1973), *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, §37.

morfologjik të drejtshkrimit dhe si rrjedhim lakimin e emrit të përveçëm dhe përdorimin e mbaresave sipas rasës, gjë e cila do të ndërlikonte edhe më shumë drejtshkrimin e termit të huaj. Në tri rastet e fundit, mund të kuptojmë se bëhet fjalë për eponime të ardhura nga gjuha angleze (*morbus, purpura, virus* përdoren në gjuhën angleze) dhe duket se edhe në gjuhën angleze në këto eponime kemi të njëjtin mungesë të rikrijimit të marrëdhënies përcaktore mes fjalëve.

Eponimet nuk vijnë vetëm nga emra njerëzish, termi i fundit e ka origjinën nga qyteti Bonyamwera i Ugandës, vend ku virusi *Bunyamwera* u izolua për herë të parë.

4. Prania e sinonimeve

Mjekësia është një nga shkencat që ka në zotërim numrin më të madh të kanaleve të përhapjes në publikun e gjerë.³¹ Kjo për faktin se shëndeti është pasuria më e çmuar që kemi dhe se të gjithë kanë të drejtën legjitime të informohen mbi shëndetin e tyre. Për rrjedhojë aktiviteti shëndetësor e kapërcen rrethine specialistëve përmes komunikimeve shkencore që i drejtohen publikut të gjerë, si: udhëzues ilaçesh, artikuj mjekësorë divulgativë të transmetuar në kanale të ndryshme televizive apo të shkruar në rubrikate shëndetit të pranishme në çdo gazetë apo revistë. Ndonëse zakonisht gjuhët e specialitetit e përdorin me kursim sinoniminë³², gjuha e mjekësisë pikërisht për shkak të shtresëzimit të madh³³ përdor mjaft sinonime. Kështu kemi sinonime që krijohen nga ekzistenca e termave që u përkasin niveleve të ndryshme të aktualizimit³⁴ dhe më konkretisht *nivelit të mirëfilltë shkencor* (ose sektorial) dhe atij *shkencor-popullor* (ose përdormi i zakonshëm). Por, duhet thënë se të dyja format janë të pranuar apo të ligjëruara. Më poshtë po sjellim disa shembuj ilustrues.

³¹ M.A. Cortelazzo (1990), *Lingue speciali*, Padova, Unipress, f. 36.

³² M.A. Cortelazzo (1990), *vep. e cituar*, f. 10; A.A. Sobrero, "Lingue speciali" në *Introduzione all'italiano contemporaneo*, vëllimi II, *La variazione e gli usi*, nën kujdesin e A. A. Sobrero, Bari, Laterza, f. 246.

³³ M. Dardano (1994), "I linguaggi scientifici", në *Storia della lingua italiana*, vëllimi II, *Scritto e parlato*, nën kujdesin e L. Serianni e P. Trifone, Torino, Einaudi, f. 541.

³⁴ A. Duro (1997), "Terminologjia në ligjërimin e specializuar", në *Studime Filologjike*, Tiranë, Nr. 1-4, f. 77.

Niveli shkencor i mirëfilltë

- ▶ eritrocitet
- ▶ leukocitet
- ▶ ciroza
- ▶ pertusis
- ▶ hepatiti
- ▶ epilepsia
- ▶ diabeti
- ▶ A(H1N1)
- ▶ ambliopia
- ▶ hepar
- ▶ frakturë
- ▶ antikorpet
- ▶ pes equinovarus

Niveli shkencor-popullor

- rruazat e kuqe
- rruazat e bardha
- tumori i mëlçisë
- kolla e mire, kolla e bardhë
- verdhëza
- sëmundja e tokës
- sëmundja e sheqerit
- gripi i derrit
- syri dembel
- mëlçi
- thyerje
- antitruapat
- këmba e shtrembër

Përfundime

Në përfundim të këtij studimi duhet të pranojmë fillimisht që shkenca mjekësore, ashtu si edhe fushat e tjera të jetës, janë në zhvillim të vazhdueshëm. Prandaj duhen konsideruar të përkohshme rezultatet në të cilat mund të arrijë një studim i gjuhës së tyre. Nga analiza që i kemi bërë terminologjisë së gjuhës mjekësore shqipe mund të pohojmë me siguri se pjesa më e madhe e termave të pranishëm janë huazime nga gjuhët e tjera. Huazimet kryesore janë futur në gjuhën shqipe nga gjuha angleze dhe ajo italiane, pavarësisht se prejardhja e tyre është kryesisht nga greqishtja apo latinishtja. Huazimet e gjuhës së mjekësisë ndjekin rregullin e të gjithë huazimeve të tjera: disa prej tyre i përshtaten rregullave të drejtshkrimit të gjuhës dhe futen të bëjnë pjesë në fondin e leksikut të saj, disa të tjera ruajnë formën e tyre origjinale duke u identifikuar lehtësisht si fjalë të huaja. Një tjetër karakteristikë e gjuhës mjekësore shqipe është prania e akronimeve, të cilat janë lehtësisht të kuptueshme nga ana e specialistëve, por jo nga ana e publikut të gjerë. Pjesa më e madhe e akronimeve vijnë nga gjuha angleze, gjuha italiane dhe mbeten të paintegruara, pra shkruhen në formën e tyre origjinale, por kemi edhe shembuj të akronimeve të përshtatura në gjuhën shqipe. Një tjetër përbërës i gjuhës mjekësore janë edhe eponimet, të cilat në gjuhën

shqipe, ashtu si edhe huazimet, i gjejmë në disa raste të përshtatura sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës dhe në disa raste të përdorura në formën e tyre origjinale. Në rastet kur eponimet përshtaten në gjuhën shqipe vështirësia lind për përkthyesin, i cili duke të identifikojë saktë eponimin origjinal. Së fundmi mund të themi se gjuha e mjekësisë, ndonëse shquhet për teknikizmin e saj të lartë, karakterizohet nga prezenca e sinonimeve, terma që u përkasin niveleve të ndryshme të aktualizimit për të ndihmuar në këtë mënyrë komunikimin mes mjekëve dhe pacientëve.

BIBLIOGRAFIA

AKADEMIA E SHKENCAVE E RP SË SHQIPËRISË (1973), *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë.

BALBONI P.E., (2000), *Le microlingue scientifico-professionali*, UTET, Torino.

CORTELAZZO, M.A. (1990), *Lingue speciali*, Padova, Unipress.

DARDANO, M.(1994), «I linguaggi scientifici», në *Storia della lingua italiana*, vëllimi II, *Scritto e parlato*, nën kujdesin e L. Serianni e P. Trifone, Torino, Einaudi.

DARDANO, M. & TRIFONE, P. (1997), *La nuova grammatica della lingua italiana*, Zanichelli, Bologna.

KATORRI, E. (2024), *Huazimet nga italishtja në gjuhën e gazetave: leksiku dhe sintaksa*, në FGJH, Nr. 9, Tiranë, f. 64-73.

LLOSHI, XH. (2001), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, SHBLU.

MAHMUDI ISMAILI, M. (2021), *Anglicizmat, vendi dhe përdorimi i tyre në shqipen e shqiptarëve të Maqedonisë (së Veriut)*, disertacion për gradën Doktor i Shkencave.

PAPA, M. (2011), *Tipologjia e huazimeve në ligjërimin e specializuar me shkallë të ulët teknikizmi*, në Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, fq.71-86, Prishtinë, Kosovë.

DURO, A. (1997), «Terminologjia në ligjërimin e specializuar», në *Studime Filologjike*, Tiranë, Nr. 1-4.

SCARPA, F. (2012), *La traduzione specializzata, Un approccio didattico professionale*. (botimi i dytë), Hoepli Editore, Milano.

SERIANNI, L. (2012), *Italiani scritti*, Bologna, Il Mulino.

SOBRERO, A.A.(1993), «Lingue speciali» në *Introduzione all'italiano contemporaneo*, vëllimi II, *La variazione e gli usi*, nën kujdesin e A. A. Sobrero, Bari, Laterza f. 237-277.

THOMAI, J. (2002), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë.

SITOGRAFIA

<https://www.yumpu.com/it/document/view/15836106/olja-arsic-tesi-specialistica-con-glossario-di-medicinapdf>
<https://www.openstarts.units.it/bitstream/10077/7924/1/Viezzi.pdf>
<http://www.centrumlatinitatis.org/wp-content/uploads/2015/11/2.11.-Luca-Villanova.-Il-Latino-nel-lessico-medico-scientifico.pdf>
<https://soniamaggi2014.files.wordpress.com/2014/11/il-mediatore-linguistico-in-ambito-medico-sanitario.pdf>
<https://www.treccani.it/vocabolario/ricerca>
<https://www.zemrashqiptare.net/news/1945/rp-0/act-print/rf-1/printo.html>
https://fjhj.journals.ekb.eg/article_168981_326e55c318f45fb78a4c46f1beab0803.pdf
www.yumpu.com/it/document/view/15836106/olja-arsic-tesi-specialistica-con-glossario-di-medicinapdf
<https://soniamaggi2014.files.wordpress.com/2014/11/il-mediatore-linguistico-in-ambito-medico-sanitario.pdf>

Botimi përfundimtar i Projektit:

Interpretimi/Përkthimi në realitetin virtual

Financuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Titulli i Projektit

Interpretimi/Përkthimi në Realitetin Virtual – Zhvillimi i

Aplikacioneve të Përkthimit Online dhe Trajnimi i Stafit dhe

Studentëve me Teknologjinë e Re

Ekipi i Projektit

- **Prof. dr. Ema Kristo**
- **Prof. as. dr. Jonida Bushi**
- **Prof. as. dr. Marsela Likaj**
- **Dr. Erta Spaho**
- **Dr. Migena Sejдини**
- **MA. Ilda Themeli**

Në një botë gjithnjë e më të lidhur globalisht, nevoja për përkthim dhe interpretim të shpejtë dhe të saktë është rritur ndjeshëm. Përkthimi është bërë një mjet thelbësor në komunikimin ndërkombëtar, qoftë në kontekste diplomatike, akademike, tregtare apo ligjore. Teknologjitë e reja po revolucionarizojnë mënyrën se si realizohet përkthimi, duke e zhvendosur atë gjithnjë e më shumë në hapësira virtuale.

Projekti **“Interpretimi/Përkthimi në Realitetin Virtual”**, i mbështetur nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, kishte synim të eksploronte potencialin e realitetit virtual si një mjet inovativ për përmirësimin e proceseve të përkthimit dhe interpretimit. Kjo iniciativë adreson sfidat teknologjike, metodologjike dhe pedagogjike të përkthimit online, duke synuar trajnimin e studentëve për të përdorur këto teknologji në mënyrë të suksesshme.



Në këtë botim, paraqiten studime dhe përvoja praktike nga ekipi i projektit, të cilat pasqyrojnë përdorimin e teknologjisë së realitetit virtual në fushën e përkthimit, si dhe ndikimin e saj në zhvillimin e kompetencave profesionale të përkthyesve të rinj.

Ky botim përmban një përmbledhje të gjetjeve kryesore të projektit, të ndara në disa seksione kryesore:

1. Sfidat teknologjike dhe metodologjike në përkthimin virtual

Në këtë seksion trajtohen pyetje të rëndësishme si:

- Si mund të sigurohet që përkthimi automatik është i saktë dhe ruan nuancat kulturore?
- Cilat janë sfidat kryesore në krijimin e platformave të përkthimit virtual?
- Si ndikon përdorimi i teknologjisë së re në cilësinë e përkthimit?

2. Strategjitë pedagogjike për trajnimin e studentëve në teknologjitë e përkthimit

Ky seksion ofron një analizë të mënyrave më efektive për të trajnuar studentët në përdorimin e teknologjive të reja të përkthimit, duke përfshirë:

- Përdorimin e realitetit virtual për simulime të interpretimit
- Metodën e vlerësimit të kompetencave të reja të përkthyesve

3. Analiza e efikasitetit të teknologjisë së realitetit virtual në përkthim

Në këtë pjesë, përfshihet një studim empirik mbi ndikimin e teknologjisë së realitetit virtual në cilësinë e përkthimit, përvojën e studentëve dhe perspektivat e tyre për përdorimin e kësaj teknologjie në të ardhmen.

4. Rekomandime dhe perspektiva për të ardhmen

Ky seksion përfshin sugjerime për përmirësimin e përdorimit të përkthimit automatik dhe interpretimit në realitetin virtual, si dhe rekomandime për hapat e ardhshëm në kërkimet shkencore dhe në përmirësimin e materialeve didaktike për përkthimin online.

ARTIKUJT KRYESORË TË BOTIMIT

Marsela Likaj

“Ndërthurja e Artit dhe Teknologjisë: Përkthimi Letrar dhe Potenciali i Përkthimit Automatik në Letërsi”

Ky artikull shqyrton sfidat dhe mundësitë që ofron intelijenca artificiale në përkthimin e veprave letrare, duke analizuar ndërthurjen e teknikave tradicionale të përkthimit me teknologjitë e reja.

Migena Sejdini & Jonida Bushi

“Interpretimi përmes Platformës Zoom”

Ky studim eksploron efektivitetin e përdorimit të platformës **Zoom** për interpretimin në distancë, duke analizuar përfitimet dhe kufizimet e kësaj teknologjie në kontekste profesionale.

Ema Kristo & Jonida Bushi

“Përkthimi Automatik: Sfida dhe Potenciali i tij në kontekstin profesional”

Autorët ofrojnë një analizë të hollësishme mbi përkthimin automatik, duke vlerësuar saktësinë dhe përshtatshmërinë e tij në sektorë të ndryshëm.

Erta Spaho

“Përkthimi njerëzor përballë përkthimit automatik”

Ky artikull analizon zhvillimin e aplikacioneve për përkthimin dhe interpretimin online, duke paraqitur një përmbledhje të përvojave praktike të përfshira në projekt. Tema të tjera të trajtuara në këtë artikull janë: Integrimi i përkthimit njerëzor dhe automatik në një proces të unifikuar, Shembuj praktikë nga puna me studentët e përfshirë në projekt, Përkthimi automatik në kontekstin e teksteve teknike dhe letrare

Përfundime

Ky botim synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi ndikimin e teknologjive të reja në fushën e përkthimit dhe interpretimit, duke demonstruar mënyrat se si realiteti virtual mund të përdoret për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e përkthimit online. Rezultatet e këtij projekti tregojnë se integrimi i teknologjisë në proceset e përkthimit jo vetëm që rrit efikasitetin, por gjithashtu ndihmon në trajnimin e përkthyesve të ardhshëm duke i pajisur ata me kompetenca të reja të kërkuara në tregun global të punës.

Ky botim përbën një kontribut të rëndësishëm në fushën e përkthimit dhe interpretimit, duke shërbyer si një burim i vlefshëm për studiuesit, pedagogët dhe studentët e përkthimit dhe teknologjisë gjuhësore. Ai hap rrugën për kërkime të mëtejshme dhe për zbatimin e modeleve të reja të mësimdhënies dhe praktikës profesionale në këtë fushë.



19 Shtator, 2024

DEPARTAMENTI GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE

1 korrik 2024 Shkolla Verore e Gjuhës Bullgare e cila u zhvillohet në auditorët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në periudhën 1-25 korrik 2024.

Kjo shkollë verore, e para dhe e vetmja e këtij lloji në vendin tonë, organizohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllave-Ballkanike dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në kuadër të marrëveshjes ndërinstitucionale të Programit Erasmus + KA171 që Universiteti i Tiranës ka me Universitetin VelikoTërnovo “St. Shën Kirili dhe Metodi” të Bullgarisë.

Seanca plenare u mbyll me fjalimin e Shefit të Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike të FGJH-së, Prof. As. Dr. Adriatik Derjaj i cili vuri theksin tek angazhimi që departamenti tregon në tërësi për eventet e kurrikulare dhe për mbështetjen që i ka dhënë gjuhës dhe kulturës bullgare si pjesë integrale e departamentit, vuri theksin tek mbështetja e vazhdueshme që Dekanati i FGJH-së i ka dhënë veprimtarive didaktike të departamentit, falënderoi kolegët e ftuar nga Bullgaria dhe shprehu mirënjohjen kundrejt Ambasadës Bullgare në Shqipëri.



The poster features a background image of a wide, paved road with a white arrow pointing forward, leading towards a large, historic stone building with multiple arches. Several cars are visible on the road. The text is overlaid on this image.

  **UNIVERSITY OF TIRANA**
FACULTY OF FOREIGN LANGUAGES
BALKAN AND SLAVIC DEPARTMENT
TURKISH LANGUAGE BRANCH

 **University of Cyprus**
Department of Turkish and
Middle Eastern Studies

**“TURKISH LANGUAGE AS A BALKANIC AND
MEDITERRANEAN COMMUNICATION BRIDGE”**
INTERNATIONAL CONGRESS

8-9 NOVEMBER   **TIRANË, ALBANIA**

FACULTY OF FOREIGN LANGUAGES AUDITORIUM
PLENARY SESSION – 10.00 EUROPE HALL

Coordinators:
Assoc. Prof. Dr. Adriatik DERJAJ
Asst. Prof. Dr. Ahmet YIKIK

DEGA E GJUHËS TURKE ORGANIZON KONGRES NDËRKOMBËTAR

Në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Turke dhe Studimeve Mesdhetare të Universitetit të Qipros, Departamenti i Gjuhës Turke pranë fakultetit tonë, organizoi Kongresin Ndërkombëtar “Gjuha turke si një urë komunikimi ballkanike dhe mesdhetare”, në një bashkërendim detyrash dhe punësh me universitete analoge të rajonit dhe më gjerë.

Pjesëmarrësit kontribuan me referimet e tyre si nga fusha e letërsisë dhe filologjisë por edhe nga fusha të tjera humane si sociologjia, psikologjia, historia, gjeografia sociale, studime ballkanike dhe rajonale etj.

Studiuesit u fokusuan më së shumti në zhvillimet bashkëkohore të gjuhës dhe kulturës turke në Ballkan dhe në rajonin e Mesdheut si dhe në fusha të ndryshme nga e kaluara e deri më sot. Kongresi synoi të nxisë shkëmbimin e ideve për studime të ardhshme në këtë fushë dhe të hidhem bazat për projekte të mundshme ndërkombëtare.



DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE,
KONFERENCË NDËRKOMBËTARE

Në datën **17 tetor 2024**, Departamenti i Gjuhës Italiane, organizoi në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës Konferencën e 16-të Ndërkombëtare të Studimeve Italianistike. Konferenca, e organizuar në kuadër të edicionit të XXIV të Javës së Gjuhës Italiane në Botë, i kushtohet përkthimit dhe receptimit të letërsisë italiane në Shqipëri. Në konferencë morën pjesë me ligjëratat e tyre pedagogë të Departamentit të Gjuhës Italiane, studiues të ndryshëm, si edhe profesorë nga universitete italiane.

Konferenca u ndoq nga studentë, pedagogë, studiues, përkthyes të interesuar për fushën e Studimeve Italianistike.

Konferenca u zhvillua në prezencë, salla Europa, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, por u mundësua të ndiqej edhe online.





Universidad de Toluca
Facultad de Lenguas Extranjeras



CARLOS ERNESTO GARCÍA
(EL SALVADOR)

0000

Presentación del libro



MODERADORAS: PROF. ASOC. DR. FLAVIA KABA
DR. DRITA ISUFAJ (UNIVERSIDAD ALEKSANDËR MOISIU)

 26 de Noviembre de 2024, 11:00 A.M

 Sala 215



DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE

(1) **Tetor 2024.** Departamenti i Gjuhës Spanjolle në bashkëpunim me Universitetin e Castilla - La Mancha, me Universiteti Internacional de Cataluña, me Universitetin e Ankarasë, Universitetin e Stambollit organizuan në datat 7-8 tetor 2024 “Simpoziumin e VI Ndërkombëtar mbi Letërsinë dhe Kulturën Hispanike”

(2) **26 Nëntor 2024**

Departamenti i Gjuhës Spanjolle, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Dr. Drita Isufaj (Universiteti Aleksandër Moisiu) organizoi prezantimin e antologjisë poetike të poetit nga El Salvador, Carlos Ernesto Garcia.

Në videokonferencë poeti u prezantoi studentëve të departamentit të gjuhës spanjolle dhe nxënësve të shkollës së mesme “Asim Vokshi” antologjinë e titulluar “Poemas de amor, locura y muerte”. Gjatë prezantimit studentët lexuan disa nga poezitë e kësaj antologjie dhe i drejtuan poetit disa pyetje mbi veprën e tij.



DEPARTAMENTI GJUHËS ANGLEZE

21 Nëntor 2024

Departamenti i Gjuhës Angleze organizoi me sukses Konferencën e 14-të Ndërkombëtare. Prezantimet e dy profesorëve të ftuar, Dr. -Ing. Besim Kabashi lektor në Universitetin “Friedrich Alexander të Erlangen Nuremberg” dhe Kërkues shkencor në Katedrën për Korpuset dhe Gjuhësinë Kompjuterike, dhe Lina Abraitienë, lektore në Kauno Kolegija, kërkuese shkencore në fushën e përkthimit audio-vizual, titrimet, dhe përdorimit të Inteligjencës Artificiale në përkthim u ndoqën me interes nga pjesëmarrësit. Prof. Asoc. Dr. Daniela Hasa në cilësinë e Përgjegjës të Departamentit hapi konferencën dhe theksoi rëndësinë e organizimit të kësaj konference, rezultatet e të cilës lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies. Konferenca u përshëndet nga Prof. Dr. Esmeralda Kromidha, Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, e cila nënvizoi rëndësinë e përfshirjes së elementeve të teknologjisë, veçanërisht zhvillimin e korpuseve gjuhësore dhe gjuhësinë kompjuterike në punimet shkencore dhe në zhvillimet e programeve të reja të studimit, me qëllim që FGJH-ja të jetë sa më pranë risive dhe prurjeve më të fundi të shkencave gjuhësore. Kjo konferencë u përshëndet dhe nga Ieva Brazauskaitė-Zubavičienė, Përgjegjëse e Departamentit të Gjuhëve, Kauno Kolegija, e cila prezantoi dhe bashkëpunimin e ri që është ngritur midis Institucionit të saj dhe Departamentit të Gjuhës Angleze për hapjen e një profili të ri në studimet e ciklit të parë, Bachelor, Gjuhë angleze - Marrëdhënie me Publikun.

Një moment i veçantë ju kushtua dhe profesorëve të këtij departamenti, të cilët kanë dalë në pension, duke ju dhënë një certifikatë mirënjohjeje në emër të gjithë Departamentit të Gjuhës Angleze.

Gjatë konferencës u prezantuan dhe u diskutuan mbi 30 punime shkencore nga kërkues të rinj, doktorantë të regjistruar pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja por edhe pedagogë të ftuar nga Lituania dhe Kosova të cilët sollën për diskutim çështje me interes në fushat gjuhësore, përkthimore, letrare, kulturore dhe reflektime mbi problemet e mësimdhënies së gjuhës angleze në shkollat shqiptare.

Ky aktivitet është tregues i punës kërkimore shkencore të pedagogëve të Departamentit të Gjuhës Angleze.



DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

05 Dhjetor 2024

“Me rastin e 30 vjetorit të Agjencisë Universitare të Frankofonisë në Evropën Qendrore dhe Lindore, **Departamenti i Gjuhës Frënge** i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në partneritet me AUF ECO, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Frënge i Universitetit “Hasan Prishtina” të Prishtinës, Shoqata e Mësuesve të Gjuhës Frënge të Shqipërisë (APFA) dhe Ambasada Franceze në Shqipëri, organizuan konferencën“ Frankofonia dhe promovimi i Shqipërisë: tradita, moderniteti dhe urat kulturore”.

